

BERZH PIRANJANI



GRAMATIKA  
E  
GJUHËS ARMENE



PERËNDIMORE DHE LINDORE





BERZH PIRANJANI

GRAMATIKA  
E  
GJUHËS ARMENE

PERËNDIMORE DHE LINDORE



Tiranë, 2017

Art grafik: Orest Muça  
Përgatiti për botim: Sokol Duma  
© Autori

Mundësoi botimin:  
BERZH dhe VARUZHAN PIRANJANI

ISBN: 978-9928-05-243-8

Shtëpia Botuese “albPaper”, Tiranë, 2017  
Rruga: “Shemsi Haka”, ish-Poligrafiku, Tiranë  
Tel.: +355 42 35 89 37

# Përmbajtja e Lëndës

Parathënie .....	5
Gramatika e Gjuhës Armene Perëndimore .....	7
Gramatika e Gjuhës Armene Lindore.....	151
Literatura e përdorur.....	447



# Parathënie

Kur i hyra kësaj pune, nuk e mendova se do të më mundonte kaq shumë. Fatmirësisht e përfundova. Mund të ishte bërë më shumë; mund të ishte bërë më mirë.

Besoj se dikujt do t'i hyjë në punë; besoj se dikush do të ketë vërejtje që do të jenë gjithnjë të mirëpritura dhe do t'i shërbejnë përmirësimit dhe plotësimit të këtij materiali.

Besoj se gjuha Shqipe do ta mirëpresë këtë të afërm të largët.

Besoj se mundimi ia vlejti.

Dhe tani një falenderim mirënjohjeje për të gjithë ata, që në mënyra të ndryshme kanë pjesën e tyre të kontributit në realizimin e kësaj pune, të cilën unë gjatë gjithë kohës e kam konsideruar detyrim ndaj atyre që kam dashur e më duan.

Një falenderim të veçantë i detyrohem Z. Xovasar Çakmakxhian, kushëririt dhe mikut tim të mirë, i cili, me flakën e shpirtit të tij optimist e pasionant, ndezi thëngjijtë e shpirtit tim të fjetur duke më dhënë gjithë energjinë e nevojshme për të çuar përpara e për ta përfunduar këtë detyrim: Ndaj të parëve tanë dhe brezave të ardhshëm.

Një falenderim modest edhe për Z. Kyd Zacharian, i cili pati mirësinë të më ndihmonte me sugjerimet e tij në përzgjedhjen e materialit të nevojshëm për këtë punim.

I falenderoj nga zemra miqtë e mi, Eno Zeneli dhe Sokol Duma, që nuk ma kursyen ndihmën e tyre në zgjidhjen e çfarëdo problemi teknik që pata gjatë përpunimit të këtij materiali.

Një falenderim i madh dhe një mirënjohje e thellë për, pa dyshim, njeriun e aftë dhe bashkëpunutorin tim më të afërt, të pakursyerin Orest Muça, vullneti, përvoja dhe fantazia e të cilit gjenden të mishëruara në çdo faqe të këtij libri.

Dhe në fund, mendoj se një falenderim apo shprehje mirënjohjeje do të ishin asgjë ose mohim i asaj që i detyrohem bashkëudhëtarit tim në këtë udhëtim, pa praninë dhe kontributin e të cilit ky libër dhe të tjerë botuar para tij, mbase nuk do të ishin ata që janë.

E kam fjalën për tim vëlla, Varuzhan.

Dhe së fundi për ta mbyllur:

Jam i lumtur të mendoj se dikur dikujt kjo punë do t'i shërbejë dhe do të kuptojë që dikush ka menduar edhe për ta... një kontribut modest, por i rëndësishëm ky në ruajtjen e identitetit!

Berzh Piranjani

Tiranë 12 Korrik 2017

GRAMATIKA  
E GJUHËS  
ARMENE PERËNDIMORE



# Përmbajtja e Lëndës

## **KREU I - Hyrje**

1. Hyrje në gjuhën Shqipe .....	13
2. Alfabeti i gjuhës Shqipe .....	13
3. Njohuri të përgjithshme për pjesët e ligjëratës .....	14
4. Hyrje në gjuhën Armene Perëndimore .....	15
5. Gjuha Armene .....	15
6. Alfabeti Armen Perëndimor .....	16
7. Germat dhe shqiptimi i tyre .....	18
8. Shenjat e pikësimit .....	23
9. Ndarja e fjalës në rrokje .....	24
10. Theksi .....	24
11. Përdorimi i germave të mëdha (kapitale) .....	25
12. Dallimet armenisht - shqip .....	25

## **KREU II - Emri**

1. Gjinia .....	27
2. Nyja .....	27
3. Nyja shquese .....	27
4. Shumësi i emrave .....	28
5. Nyja e pashquar .....	29
6. Emri .....	29
7. Emrat e përveçëm .....	29

8. Lakimi .....	29
9. Dallimet armenisht - shqip .....	38

### **KREU III - Mbiemri**

1. Llojet e mbiemrave .....	40
2. Mbiemrat Cilësorë .....	41
3. Krahasimi.....	41
4. Mbiemrat Dëftorë .....	43
5. Mbiemrat Numërorë .....	43
6. Numërorët Themelorë.....	44
7. Numërorët Rreshtorë.....	45
8. Numërorët Shpërndarës .....	46
9. Mbiemrat Pronorë .....	47
10. Mbiemrat e Pacaktuar .....	49
11. Dallimet armenisht - shqip .....	51

### **KREU IV - Përemri**

1. Përemrat Vetorë.....	53
2. Përemrat Reciprokë .....	55
3. Përemrat Reflektorë.....	55
4. Përemrat Pronorë.....	57
5. Përemrat Lidhorë.....	59
6. Përemrat Dëftorë .....	60
7. Përemrat e Pacaktuar.....	61
8. Përemrat Pyetës .....	62
9. Dallimet armenisht - shqip .....	62

### **KREU V - Folja**

1. Të përgjithshme .....	65
2. Foljet ndihmëse .....	68
a) “ըլլալ” - të jesh.....	68
b) “նստնալ” - të kesh.....	72

3.	Foljet e rregullta .....	78
4.	Foljet e rregullta. Zgjedhimi i parë .....	79
5.	Foljet e rregullta. Zgjedhimi i dytë .....	84
6.	Foljet e rregullta. Zgjedhimi i tretë .....	87
7.	Foljet e parregullta (devijuese).....	91
8.	Foljet devijuese të zgjedhimit të parë .....	91
9.	Foljet devijuese të zgjedhimit të dytë .....	93
10.	Foljet që mbarojnë me “չի” .....	95
11.	Foljet devijuese të zgjedhimit të tretë .....	96
12.	Foljet që mbarojnë me “ու” .....	100
13.	Foljet pavetore .....	101
14.	Foljet e parregullta .....	101
15.	Foljet difektoze .....	103
16.	Foljet mohore .....	104
17.	Foljet pasive .....	107
18.	Foljet kalimtare .....	110
19.	Dallimet armenisht - shqip .....	111

## **KREU VI - Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës**

1.	Parafjalët dhe pasfjalët .....	117
2.	Parafjalët .....	117
3.	Pasfjalët .....	118
4.	Ndajfoljet .....	120
5.	Lidhëzat .....	122
6.	Pasthirrmat .....	123
7.	Idiomat .....	124

## **KREU VII - Fjalët**

1.	Fjalët e prejardhura dhe të përbëra .....	125
2.	Fjalët e prejardhura .....	126
3.	Fjalët e përbëra .....	131

**KREU VIII - Infinitivi, pjesoret, emërzimi**

- |                    |     |
|--------------------|-----|
| 1. Infinitivi..... | 133 |
| 2. Pjesoret.....   | 135 |

**KREU IX - Rasa të imponuara nga foljet ose mbiemrat**

- |  |     |
|--|-----|
| 1. Rasa të imponuara nga foljet ose mbiemrat ..... | 139 |
|--|-----|

**KREU X - Fjalitë në gjuhën Armene**

- |                                     |     |
|-------------------------------------|-----|
| 1. Fjalitë në gjuhën Armene .....   | 143 |
| 2. Dallimet armenisht - shqip ..... | 146 |

**KREU XI - Fjalor termash gramatikore**

- |   |     |
|---|-----|
| 1. Fjalor termash gramatikore Shqip - Armenisht ..... | 147 |
|---|-----|

# KREU I

## HYRJE NË GJUHËN SHQIPE

### ALFABETI I GJUHËS SHQIPE

A	a	N	n
B	b	Nj	nj
C	c	O	o
Ç	ç	P	p
D	d	Q	q
Dh	dh	R	r
E	e	Rr	rr
Ë	ë	S	s
F	f	Sh	sh
G	g	T	t
Gj	gj	Th	th
H	h	U	u
I	i	V	v
J	j	X	x
K	k	Xh	xh
L	l	Y	y
Ll	ll	Z	z
M	m	Zh	zh

# Gramatika e Gjuhës Shqipe

## Njohuri të përgjithshme për pjesët e ligjëratës

Gjuha shqipe ka dhjetë lloj fjalësh që quhen pjesë të ligjëratës ose klasa, dhe këto janë:

**Emri, Mbiemri, Numërori, Përemri, Folja**

dhe

**Ndajfolja, Parafjala, Lidhëza, Pjesëza, Pasthirrma**

**A. Emri, mbiemri, numërori, përemri dhe folja** - quhen pjesë të **ndryshueshme** të ligjëratës, sepse e ndryshojnë formën e tyre në fjali (lakohen ose zgjedhohen).

Nga këto:

- a) Emri, mbiemri, numërori dhe përemri kanë **gjini, numër dhe rasë**.
- b) Folja ka **mënyrë, kohë, numër dhe vetë**.

**B. Ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza dhe pasthirrma** - quhen pjesë të **pandryshueshme** të ligjëratës, sepse nuk e ndryshojnë formën e tyre gjatë përdorimit në fjali

**Gjinitë** e pjesëve të lakueshme janë **tri**: Mashkullore, Femërore, Asnjanëse

**Numrat** janë **dy**: Njëjës, Shumës

**Rasat** janë **pesë**: Emërore, Gjinore, Dhanore, Kallzore, Rrjedhore

## Hyrje në gjuhën Armene Perëndimore

### Gjuha Armene (*Հայերէն Լեզու*)

Armenët e quajnë veten e tyre “Հայ-Հայ” dhe gjuhën e tyre “Հայերէն- Armenisht”. Gjuha Armene i përket familjes së gjuhëve indoeuropiane, njëlloj si Sanskritja, Latinishtja, Persishtja, Greqishtja, Gjermanishtja, Anglishtja, Frengjishtja dhe Shqipja. Ajo shkruhet nga e majta në të djathtë.

Gjuha e shkruar ka kaluar nëpër tre faza:

1. **Armenishtja e vjetër (Grabar)**, që ka qenë në përdorim nga fillimi i shek. 5<sup>-të</sup>, kur u krijua alfabeti Armen nga Mesrob Mashtoc, deri në shek. 19<sup>-të</sup>. Kryesisht e përdorur për shkrime fetare. Armenishtja e vjetër sot përdoret vetëm në kishë.
2. **Armenishtja e Mesme**, e ashtuquajtur “**Vulgare**” ose gjuha e popullit, me të cilën janë shkruajtur shumë vepra nga shek. 12<sup>-të</sup> deri në shek. 18<sup>-të</sup>.
3. **Armenishtja Moderne** (Ashkharabar) që fillon në shek. 19<sup>-të</sup> dhe ka dy degë:
  - a) **Armenishtja Perëndimore**, që bazohet në dialektin e Kostandinopojës (Stambollit të sotëm) dhe që përdoret sot prej Armenëve që banojnë në Perëndim.
  - b) **Armenishtja Lindore**, që bazohet në dialektin e Jerevanit dhe që përdoret sot në Armeni, Persi dhe Indi.

Që të dy këto degë kanë ndryshime të vogla në gramatikë dhe shqiptim, por në themel kanë të njëjtin fjalor. Secila degë kuptohet lehtësisht nga të dy palët.

## Alfabeti (*Այբուբեն*)

**Alfabeti Armen Perëndimor** përbëhet nga 38 germa që përfaqësojnë zanore dhe bashkëtingëllore.

*Հայ Արևմտյան Այբուբեն* - **Alfabeti Armen Perëndimor**

Germa dhe shqiptimi në gjuhën armene			Shqiptimi dhe germa korresponduese në gjuhën shqipe		
Ա	u	այբ	ajp	A	a
Բ	p	բեն	pen	P	p
Գ	q	գիմ	kim	K	k
Դ	η	դա	ta	T	t
Ե	t	էջ	ječ	JE	je
Զ	q	զա	za	Z	z
Է	t	է	e	E	e
Ը	p	ըն	ët	Ë	ë
Թ	p	թո	to	T	t
Ճ	đ	ժէ	zhe	ZH	zh
Ի	h	ինի	ini	I	i
Լ	l	լիւն	ljun	L	l
Խ	hu	խէ	he	H	h

Germa dhe shqiptimi  
në gjuhën armene

Shqiptimi dhe germa  
korresponduese në  
gjuhën shqipe

<i>Օ</i>	<i>օ</i>	<i>օւ</i>	xa	X	x
<i>Կ</i>	<i>կ</i>	<i>կէն</i>	gen	G	g
<i>Հ</i>	<i>հ</i>	<i>հօ</i>	ho	H	h
<i>Ձ</i>	<i>ձ</i>	<i>ձւ</i>	ca	C	c
<i>Ղ</i>	<i>ղ</i>	<i>ղաւս</i>	ghad	GH	gh
<i>Ճ</i>	<i>ճ</i>	<i>ճէ</i>	xhe	XH	xh
<i>Մ</i>	<i>մ</i>	<i>մէն</i>	men	M	m
<i>ԅ</i>	<i>յ</i>	<i>յի</i>	hi	J	j
<i>Ն</i>	<i>ն</i>	<i>նու</i>	nu	N	n
<i>Շ</i>	<i>շ</i>	<i>շւ</i>	sha	SH	sh
<i>Ո</i>	<i>ո</i>	<i>օ</i>	vo	VO	vo
<i>Չ</i>	<i>չ</i>	<i>չւ</i>	ça	Ç	ç
<i>Պ</i>	<i>պ</i>	<i>պէ</i>	be	B	b
<i>Ջ</i>	<i>ջ</i>	<i>ջէ</i>	çe	Ç	ç
<i>Ռ</i>	<i>ր</i>	<i>րու</i>	rra	RR	rr
<i>Ս</i>	<i>ս</i>	<i>սէ</i>	se	S	s
<i>Վ</i>	<i>վ</i>	<i>վէն</i>	ve	V	v
<i>Տ</i>	<i>տ</i>	<i>տիւն</i>	djun	D	d
<i>Ր</i>	<i>ր</i>	<i>րէ</i>	re	R	r
<i>Յ</i>	<i>ց</i>	<i>ցօ</i>	co	C	c
<i>Ի</i>	<i>ւ</i>	<i>հիւն</i>	hjun	JU	ju
<i>Փ</i>	<i>փ</i>	<i>փիւր</i>	pjur	P	p
<i>Ք</i>	<i>ք</i>	<i>քէ</i>	ke	K	k
<i>Օ</i>	<i>օ</i>	<i>օ</i>	o	O	o
<i>Ֆ</i>	<i>ֆ</i>	<i>ֆէ</i>	fe	F	f

## Germat dhe shqiptimi i tyre

**Alfabeti Armen Perëndimor** përbëhet nga 38 germa që përfaqësojnë zanore dhe bashkëtingëllore.

### Zanoret (*Հայկականները*)

Zanoret janë: **u, ɫ, ɹ, ɦ, o.**

Secila prej germave përfaqëson një tingull të vetëm.

**u** - lexohet si - **a** - e shqipes

**ɫ** - lexohet si - **e** - e shqipes

**ɹ** - lexohet si - **ë** - e shqipes

**ɦ** - lexohet si - **i** - e shqipes

**o** - lexohet si - **o** - e shqipes

### Zanore të krijuara nga bashkimi i dy germave

Në gjuhën Armene Perëndimore nuk ka një germë të vetme për të shprehur zanoren “**u**” dhe “**y**” të shqipes.

Në këtë rast germa “**u**” formohet nga bashkimi i germave “**n**” dhe “**ɫ**” e gjuhës Armene Perëndimore, ndërsa germa “**y**” formohet nga bashkimi i germave “**ɦ**” dhe “**ɫ**” e gjuhës Armene Perëndimore.

Si rrjedhim kemi dy zanore të reja të formuara nga bashkangjitja e dy germave.

**nu** - lexohet si - **u** - e shqipes

**hu** - lexohet si - **y** - e shqipes

### Raste të veçanta:

- a) Germa e bashkangjitur “**ɫ**” - je, kur është në fillim të fjalës lexohet si “**je**” në shqip, ndërsa kur është në mes të fjalës lexohet si zanorja “**e**” e shqipes.

**Shembull:**

*էրթալ* [jerta'l] - shkoj

*սեպտեմբեր* [septembe'r] - shtator

*րոլ* [ter] - rol

- b) Germa e bashkangjitur “*ել*” - jev

Kur është në fillim të fjalës lexohet si “**jev**” në shqip, ndërsa kur është në mes të fjalës lexohet si “**ev**” e shqipes.

**Shembull:**

*ել* [jev] - dhe, edhe

*սել* [sev] - i zi

*սեպյա* [sevaçja'] - syzi, syzezë

- c) *ը* - lexohet si “**ë**” në shqip

Zanorja “*ը*” (ë) shpesh qëllon që të jetë e pranishme ndërmjet dy bashkëtingëlloreve, ndonëse e pashkruar. Kështu p.sh. fjala *մրմնջի* lexohet sikur të jetë shkruar *մըըմընջի* (mërmënçel) - murmuris. Kjo “*ը*” (ë) e pashkruar, por e lexuar quhet: “*ը*” (ë) natyrale (*բնականը* “*ը*”)

- d) Germa e bashkangjitur “*ն*” - vo, kur është në fillim të fjalës lexohet si “**vo**” e shqipes, ndërsa kur është në mes të fjalës lexohet si zanorja “**o**” e shqipes.

**Shembull:**

*նրոշ* (vorosh) - i përcaktuar

*նրսորդ* (vorsort) - gjuetar

## Bashkëtingëlloret (*Բաղաձայնները*)

Disa nga bashkëtingëlloret shqiptohen njëllor nga Armenët që jetojnë në perëndim, të cilët nuk bëjnë më diferencë ndërmjet tyre. Megjithatë ata i mbajnë ato në gjuhën e shkruar për t'i qëndruar korrekt drejtshkrimit tradicional. Ndërsa Armenët në lindje kanë ruajtur shqiptimin origjinal të këtyre germave:

Në gjuhën Armene Perëndimore:

<i>Ɔ - ϕ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>p</b>	në shqip
<i>Ɔ - ρ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>k</b>	në shqip
<i>Ɔ - ϑ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>t</b>	në shqip
<i>ϐ - β</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>c</b>	në shqip
<i>ϐ - ϑ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>ç</b>	në shqip

Të parat i ngjajnë bashkëtingëlloreve fishkëlyese (p.sh. *ph, kh, etj*), të dytat janë të theksuara. Ndonëse në të folurën perëndimore dallimi ndërmjet tyre nuk bie në sy, në të shkruar ka shumë rëndësi të shkruhen korrekt pasi mund të ndryshojnë kuptimin e fjalës.

<i>ϑ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>z</b>	në shqip
----------	---------------------------------	----------	----------

**Shënim:**

Fjalët që fillojnë me germën *q* dhe ndiqen nga bashkëtingëlloret *p* ose *q* lexohen sikur kanë zanoren **ë** përpara:

**Shëmbull:**

- (p) qpnuułp* - ëzposa'nk - shetitje
- (p) qqtuun* - ëzke'sd - veshje

<i>Ɔ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>zh</b>	në shqip
<i>Ɔ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>l</b>	në shqip
<i>Ɔ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>h</b>	në shqip
<i>Ɔ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>x</b>	në shqip
<i>Ɔ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>g</b>	në shqip
<i>Ɔ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>h</b>	në shqip
<i>Ɔ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>gh</b>	në shqip
<i>Ɔ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>xh</b>	në shqip
<i>U</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>m</b>	në shqip
<i>β</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>j</b>	në shqip

**Shënim:**

1. Kur bashkëtingëlloret *j* ndodhet në fillim të fjalës, shqiptohet ose lexohet si germa **h** në shqip.

*յիշէլ* - hishe'l - kujtoj, sjell ndër mend

*յարսւյր* - harma'r - i përshtatshëm

2. Kur bashkëtingëllorja *յ* ndodhet në mes të fjalës, shqiptohet ose lexohet si germa **յ** në shqip kur ndodhet ndërmjet dy zanoreve ose kur ndiqet nga një bashkëtingëllore.

*կայարան* - gajara'n - stacion

*մայր* - majr - nënë

3. Kur bashkëtingëllorja *յ* ndodhet në fund të fjalës, nuk shqiptohet ose lexohet.

*վրայ* - vra - mbi, sipër

*վկայ* - vga - dëshmitar

Շ shqiptohet ose lexohet si germa **sh** në shqip

### Shënim:

Fjalët që fillojnë me germën “շ” dhe ndiqen nga bashkëtingëllorja “ւ” lexohen sikur kanë zanoren “ë” përpara:

#### Shembull:

(ը) *շտայտլ* - ëshdabe'l - nxitoj

(ը) *շտււարան* - ëshdemara'n - magazinë, depo

Ռ shqiptohet ose lexohet si rrokja “vo” në shqip kur është në fillim të fjalës:

#### Shembull:

*որ* - vor - kush, që

*որդի* - vorti' - bir

*որակ* - vora'g - cilësi

Kur ndiqet nga germa “վ” atëhere e humbet tingullin fillestar “v” dhe lexohet thjesht “o”:

Kur ndodhet në mes të fjalës gjithashtu e humbet tingullin fillestar “v” dhe lexohet thjesht “o”:

#### Shembull:

*հով* - hov - erë

*նորոկ* - noroke'l - rinovoj

*փոշի* - poshi' - pluhur, pudër

Kur germa “n” bashkohet me germën “j” në formën e grupit “nj” dhe ndodhen në fund të fjalës, atëhere bashkëtingëllorja “j” që ndodhet në fund të fjalës, nuk shqiptohet ose lexohet. Por nëqoftëse grupi i germave “nj” ndiqet nga një bashkëtingëllorë, atëhere shqiptohet ose lexohet “uj” në shqip:

**Shembull:***qnjû* - kujn - ngjyrë, bojë*pnjû* - pujn - fole*lnju* - lujs - dritë*jnju* - hujs - shpresë

<i>ŋ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>b</b>	në shqip
----------	---------------------------------	----------	----------

<i>Ŧ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>rr</b>	në shqip
----------	---------------------------------	-----------	----------

<i>U</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>s</b>	në shqip
----------	---------------------------------	----------	----------

**Shënim:**

Fjalët që fillojnë me germën “u”, kur ndiqen nga bashkëtingëlloret *lj, uj, un, p* lexohen sikur kanë germën zanore “ë” përpara.

**Shembull:***(p) uljhqp* - ësgj'zp - fillim*(p) uujhunwlj* - ësbida'g - i bardhë

<i>ç</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>v</b>	në shqip
----------	---------------------------------	----------	----------

<i>S</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>d</b>	në shqip
----------	---------------------------------	----------	----------

<i>Ŧ</i>	shqiptohet ose lexohet si germa	<b>r</b>	në shqip
----------	---------------------------------	----------	----------

<i>h</i>	As edhe një fjalë fillon me këtë germë. Në mes të fjalës, ndërmjet dy zanoreve ose pas një zanoreje, ajo lexohet si germa	<b>v</b>	në gjuhën shqipe.
----------	---	----------	-------------------

**Shembull:***quuwj* - kava't - gotë, kupë*utrlj* - djerje'v - gjethe*uwljh* - aveli' - më shumë, më tepër*utl* - sev - i zi

Siç është përmendur më sipër, në Armenishten Perëndimore, bashkimi i germave “h” dhe “l” në formën “hl” formon një diftong. Ky diftong zakonisht haset në fund të emrave abstraktë në formën “*nljhlj*” dhe lexohet si “**utjun**” në gjuhën shqipe:

**Shembull:**

*միտյու՛ն* - miutju'n - bashkim

*մարտյու՛ն* - makrutju'n - pastërti

## Shenjat e pikësimit (*կտադրութիւն*)

, *ստորակտ* (storage'd) - presje

Njëlloj si presja në shqip

<sup>1</sup> *քութ* (put) - thumb, gishtëz

Njëlloj presjeje që vihet në gërmën e fundit të një fjale për të treguar një pushim të shkurtër

. *միջակտ* (miçage'd) - pikëpresje

Njëlloj si pikëpresje në shqip

<sup>o</sup> *պարկյ* (baru'g) - pikëpyetje

Njëlloj si pikëpyetje në shqip. Vendoset mbi fjalë.

... *կախում կտ* (gahma'n ge'd)

I korrespondon pikë thirrje ose pikë çuditëse ! në shqip

<sup>1</sup> *երկար* (jerga'r)

Përdoret si “shenjë pashtrmë” në fjalët që shprehin ndjenjë. Në shqip në këto raste përdoret përsëri “pikë thirrje ose pikë çuditëse !.

: *վերջակտ* (verçage'd) - pikë

Njëlloj si pika në shqip që vendoset në fund të fjalisë apo frazës.

( ) *փակագիծ* (pagaki'x) - kllapa

Njëlloj si kllapat në shqip.

- *գծիկ* (këxi'g)

Vijë e gjatë që tregon ndërhyrjen e folësit.

« » չաղէրս (çage'rd) - thonjëza

Njëlloj si thonjëzat në shqip.

- ապաթարձ (abata'rc) - vizë ndarëse

Njëlloj si vizë ndarëse në shqip.

## Ndarja e fjalës në rrokje

Ndarja e fjalës në rrokje bëhet në këtë mënyrë:

1. N.q.s bashkëtingëllorja ndodhet ndërmjet dy zanoreve, gjatë ndarjes ajo shkon me rrokjen pasardhëse:

*ււ - քուք, կւ - տու*

2. N.q.s fjala fillon me tre bashkëtingëllore, gjatë ndarjes bashkëtingëllorja e fundit shkon me rrokjen pasardhëse:

*դր - դէլ, Վր - մուճ, թր - չու*

3. N.q.s ndodhet më shumë se një bashkëtingëllore ndërmjet dy zanoreve, gjatë ndarjes bashkëtingëllorja e fundit shkon me rrokjen pasardhëse:

*բաղ - նիք, մար - վիւ, հաւ - բուր*

4. N.q.s dy zanore njera pas tjetres nuk formojnë një tingull (një diftong apo një zanore të bashkangjitur), gjatë ndarjes çdo zanore formon një rrokje më vete:

*է - ալ, է - ութ - իււ, սի - րէ - ի*

## Theksi

Në fjalët e gjuhës Armene theksi bie gjithnjë mbi rrokjen e fundit:

*բա - գու'ի, մա - քու'ր, աւ - կո - դի'ւ, թա - քա - տ'ր*

Nyja shquese “ը” që vihet në fund të fjalës nuk theksohet: theksi në këtë rast bie mbi rrokjen e fundit të fjalës si në rastin kur fjala është në trajtën e pashquar:

*բա - գո'ւկը, մար - վի'ւր, աւ - կո - դի'ւր, թա - քա - տ'րը*

## Përdorimi i germave të mëdha (kapitale)

Germat e mëdha përdoren në këto raste:

1. Fjala fillon gjithnjë me germë të madhe
2. Çdo strofë në vjershat fillon me germë të madhe
3. Emrat e përveçëm fillojnë me germë të madhe
4. Emrat e njerëzve fillojnë me germë të madhe
5. Emrat gjeografike fillojnë me germë të madhe
6. Fjala “Zot” dhe sinonimet e tij fillojnë me germë të madhe. Nuk fillojnë me germë të madhe emrat e sipërpërmendur në rastet kur:
  - a. Emrat e njerëzve përdoren si mbiemra:  
*հայ գրագետ, յոյն սարդ*
  - b. Emrat e veçantë përdoren si mbiemra:  
*Էւրոպական, հայկական*
  - c. Përdoren për të treguar fe, besim, religion:  
*քրիստոնէութիւն, մահմետականութիւն*

## Dallimet Armenisht - Shqip

**Alfabeti Armen Perëndimor** përbëhet nga **38** germa

**Alfabeti Shqip** përbëhet nga **36** germa

**Alfabeti Armen Perëndimor** ka **5** (pesë) **zanore**, që shkruhen me një germë të vetme dhe përfaqësojnë një tingull të vetëm

**Alfabeti Shqip** ka **7** (shtatë) **zanore**, që shkruhen me një germë të vetme dhe përfaqësojnë një tingull të vetëm

**Alfabeti Armen Perëndimor** ka këto germa që nuk i ka **Alfabeti Shqip**:

Ե	է	էջ
Ղ	ղ	ղատ
Ռ	ռ	վո
Ի	ւ	հիւն

**Alfabeti Shqip** ka këto germa që nuk i ka **Alfabeti Armen Perëndimor**:

DH	dh
GJ	gj
LL	ll
NJ	nj
TH	th
U	u
Y	y

**Shënim 1:** Në fakt, **Alfabeti Armen Perëndimor** e përdor germën “ll”, pavarësisht se nuk e ka si germë më vete. Në këtë rast ajo formohet nga vendosja e dy germave “l” njera pas tjetrës. Shembull për këtë shërben rasti i foljes ndihmëse “լլալլ” - të jesh, që lexohet “**ëllall**”.

**Shënim 2:** Rasti i transkriptimit me “ll” të “l - së” fundore nuk ka lidhje me sa është thënë më sipër.

**Alfabeti Armen Perëndimor** nuk ka asnjë germë të përngjitur.

**Alfabeti Shqip** ka 6 (gjashtë) germa të përngjitura.

# KREU II

## EMRI (ԱՆՈՒՆԻ Կամ ԳՈՅԱԿԱՆ)

### GJINIA

Emrat në gjuhën Armene nuk kanë gjini.

### NYJA (Յօղ)

Ashtu si edhe në gjuhën shqipe, emrat në gjuhën Armene, hasen në trajtë të shquar ose të pashquar, si në numrin njëjës, ashtu edhe në numrin shumës.

### 1. Nyja Shquese

Rolin e nyjes shquese në gjuhën Armene e luan germa “ը” që vendoset në fund të fjalëve që mbarojnë me bashkëtingëllore; ose germa “ւ” në fund të fjalëve që mbarojnë me zanore:

այթոռն karrige զիրք libër

այթոռը karrig'ja զիրքը libri

զինի verë լեզու գjuhë

զինիւ vera լեզուի գjuha

Në rastet kur fjala mbaron me “յ” të pazëshme, “յ” bie dhe në vend të saj vendoset “ւ”:

ճամբայ rrugë ապագայ e ardhme

ճամբան rruha ապագան e ardhmja

հսկայ gjigant ենթակայ kryefjalë

հսկան gjiganti ենթական kryefjala

Në rastet kur fjala mbaron me “j” të zëshme, “j” mbetet dhe shtohet edhe germa “ը”:

<i>հայ</i>	armen	<i>բայ</i>	folje	<i>թէյ</i>	çaj
<i>հայը</i>	armeni	<i>բայը</i>	folja	<i>թէյը</i>	çaji

Fjalët që mbarojnë me “ւ” që lexohet si “v”, gjithashtu marrin nyjen “ը” në fund:

<i>սլաստիւ</i> - nder	<i>ցաւ</i> - dhimbje
<i>սլաստիւր</i> - nderi	<i>ցաւը</i> - dhimbja

Ka edhe fjalë që mbarojnë me bashkëtingëllore dhe që marrin nyjen shquese “ւ” në vend të “ը”. Kjo ndodh në rastet kur fjala, që vjen menjëherë pas tyre në fjali, fillon me zanore. Në këtë rast, “ւ” shqiptohet bashkë me zanoren që vjen menjëherë pas saj:

<i>Հայ-նու-Յոյնը</i>	Armeni dhe Greku
<i>հաց-նու-սլանիքը</i>	buka dhe djathi
<i>մարդ-նալ</i>	burri gjithashtu
<i>տղա-նալ, աղջիկ-նալ</i>	edhe djali, edhe vajza
<i>ծառ-նալ, սլտուղ-նալ</i>	edhe pema, edhe fruti

### Shumësi i Emrave (*Յոգնակի*)

Shumësi i emrave formohet në këtë mënyrë:

a) Kur fjala ka vetëm një rrokje, në fund të saj shtohet “ւր”:

<i>մարդ</i>	njeri	<i>տուն</i>	shtëpi	<i>քար</i>	gur
<i>մարդեր</i>	njerëz	<i>տուներ</i>	shtëpitë	<i>քարեր</i>	gurë

b) Kur fjala ka më shumë se një rrokje, në fund të saj shtohet “ւեր”:

<i>սլարտէզ</i>	- lulishte	<i>սսուս</i>	- kometë
<i>սլարտէզներ</i>	- lulishte	<i>սսուսներ</i>	- kometa
<i>գնդակ</i>	- top	<i>շուկայ</i>	- treg
<i>գնդակներ</i>	- topa	<i>շուկաներ</i>	- tregje

#### Shënim:

Në fjalën “շուկայ”, “j” e pazëshme bie dhe shtohet “ներ”.

## Nyja e pashquar

Rolin e nyjes së pashquar e luan pjesëza “*ւր*”, e cila vendoset pas fjalës në mënyrë të ndarë prej saj. Pjesëza “*ւր*” përkthehet “**një**” në shqip, dhe, njëllonj si në shqip, e vendos emrin në trajtë të pashquar:

<i>ւարդ ւր</i>	një njeri	<i>տուն ւր</i>	një shtëpi
<i>գնդակ ւր</i>	një top	<i>պարտեզ ւր</i>	një lulishte

## Emri (*ԱՆՈՒՆ Կամ ԳՈՅԱԿԱՆ*)

Siç shihet nga titulli, gjuha Armene përdor dy fjalë për të treguar emrin;

Normalisht (“*ԱՆՈՒՆ*” - emër) - përdoret kur kemi të bëjmë me emërtime frymorësh ose jo frymorësh, konkretë ose abstraktë, dhe duke qenë se është më përgjithësues, është edhe më i pranishëm në përdorim,

Ndërsa (“*ԳՈՅԱԿԱՆ*” - emër) - zakonisht përdoret, kur ky emërtim trajtohet në planin gramatikor.

Në të dy rastet, gjatë trajtimit gramatikor, kuptimi nuk ndryshon.

## Emrat e përveçëm (*ՅԱՏՈՒԿ ԱՆՈՒՆՆԵՐ*)

Emrat e përveçëm (emrat e personave, vendeve, etj) fillojnë me germë të madhe:

<i>Արշակ</i>	<i>Յակոբ</i>	<i>Նյու Եորք</i>	<i>Երևան</i>	<i>Հայաստան</i>
Arshag	Agop	Nju Jork	Jerevan	Hajasdan

## Lakimi (*ՀՈԼՈՎՈՒՄԸ*)

Në gjuhën Armene emrat lakohen. Gjatë lakimit mbaresat e tyre ndryshojnë në varësi të detyrës që kryejnë në fjali. Format e ndryshme që marrin emrat gjatë lakimit quhen rasa (*հոլովներ*).

Ka gjashtë (6) rasa:

- |    |                  |               |           |
|----|------------------|---------------|-----------|
| 1. | <i>նւղղական</i>  | emërore       | (Em.)     |
| 2. | <i>հայցական</i>  | kallzore      | (Kallz.)  |
| 3. | <i>սեռական</i>   | gjinore       | (Gjin.)   |
| 4. | <i>տրական</i>    | dhanore       | (Dhan.)   |
| 5. | <i>բացառական</i> | rrjedhore     | (Rrjedh.) |
| 6. | <i>գործիական</i> | instrumentale | (Instr.)  |

1. **Rasa Emërore** është edhe rasa që përdor ose në të cilën vihet kryefjala e fjalisë:  
*Տունը մեծ է:*        **Shtëpia** është e madhe (Shtëpia - kryefjala)

2. **Rasa Kallzore** është rasa në të cilën vihet kundrina e drejtë:  
*Կը սիրեմ տունը:* Unë e pëlqej **shtëpinë**. (shtëpinë - kundrina e drejtë)

3. **Rasa Gjinore** është rasa që tregon se kujt i përket prona (objekti).

Pronari, që mund të jetë person ose send, vendoset në fillim:

*Յաղարհն տունը*    Shtëpia e Agopit

*Մարդուն աչքը*    Syri i njeriut

*Տունին դուռը*    Dera e shtëpisë

*Աչքին գոյնը*      Ngjyra e syve

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, renditja e fjalëve që tregojnë pronarin dhe pronën, në gjuhën Armene, është e ndryshme nga gjuha Shqipe, ku fjala që tregon pronarin vjen pas fjalës që tregon pronën.

4. **Rasa Dhanore** është rasa në të cilën vihet kundrina e zhdrejtë, e cila tregon personin ose sendin të cilit i adresohet veprimi:

*Արշալիհն կուտամ* - po ja jap **Arshagut** (Arshagut - kundrina e zhdrejtë)

5. **Rasa Rrjedhore** është rasa që tregon se prej cilit person apo send e ka burimin veprimi:

*Տունն է կուգամ* - po vij **prej shtëpie**

6. **Rasa Instrumentale** është rasa që tregon se me çfarë mjete kryhet veprimi.

*Գրիչով կը գրեմ* - Unë shkruaj **me penë**.

## Forma bazë e lakimit

	Njëjës		Shumës	
		Trajta e Pashquar		
<b>E.</b>	<i>նաշտ</i>	fushë	<i>նաշտեր</i>	fusha
<b>K.</b>	<i>նաշտ</i>	fushën	<i>նաշտեր</i>	fusha
<b>Gj.</b>	<i>նաշտի</i>	i/e/të fushës	<i>նաշտերու</i>	i/e/të fushave
<b>Dh.</b>	<i>նաշտի</i>	fushës	<i>նաշտերու</i>	fushave
<b>Rr.</b>	<i>նաշտէ</i>	prej fushë	<i>նաշտերէ</i>	prej fushave
<b>I.</b>	<i>նաշտով</i>	me fushën	<i>նաշտերով</i>	me fusha
		Trajta e Shquar		
<b>E.</b>	<i>նաշտը</i>	fusha	<i>նաշտերը</i>	fushat
<b>K.</b>	<i>նաշտը</i>	fushën	<i>նաշտերը</i>	fushat
<b>Gj.</b>	<i>նաշտին</i>	i/e/të fushës	<i>նաշտերուն</i>	i/e/të fushavet
<b>Dh.</b>	<i>նաշտին</i>	fushës	<i>նաշտերուն</i>	fushavet
<b>Rr.</b>	<i>նաշտէն</i>	prej fushës	<i>նաշտերէն</i>	prej fushavet
<b>I.</b>	<i>նաշտովը</i>	me fushën	<i>նաշտերովը</i>	me fushat

Siç shihet nga tabelat e mësipërme, rasa emërore me rasën kallzore, si edhe rasa gjinore me rasën dhanore, si në njëjës, ashtu edhe në shumës, janë të njëjta në formë. Përveç lakimit bazë, ka edhe forma të tjera lakimi të trashëguara nga e kaluara, të cilat ndonëse pothuajse nuk përdoren më, mund të gjenden në përdorim. Tendencë e gjuhës së sotme Armene është për t'i braktisur ato sa më tepër të jetë e mundur, me qëllim unifikimi të lakimit dhe gjuhës së folur e të shkruar.

**Shënim:**

Rradha e vendosjes së fjalëve në një fjali të thjeshtë është:

Në fillim vendoset **Kryefjala**, pas saj **Cilësoret** dhe në fund **Folja**.

Siç shihet kjo renditje nuk përputhet me renditjen e fjalëve në fjalitë e gjuhës Shqipe, ku mbizotëron rregulli:

Në fillim vendoset **Kryefjala**, pas saj **Folja** dhe në fund **Cilësorët**.

## Forma të tjera lakimi

Duke qenë se dallimi kryesor në format e lakimit përcaktohet nga mbaresa e rasës gjinore, numri njëjës, atëhere edhe format e lakimit do t'i emërtojmë sipas mbaresës fundore të rasës gjinore, numri njëjës:

### a) Lakimi me “*ni*”

	Njëjës		Shumës	
	Trajta e Pashquar			
<b>E.</b>	<i>huj</i>	armen	<i>hujեր</i>	armenë
<b>K.</b>	<i>huj</i>	armenin	<i>hujեր</i>	armenët
<b>Gj.</b>	<i>hujni</i>	i/e/të armenit	<i>hujերու, hujոց</i>	i/e/të armenëve
<b>Dh.</b>	<i>hujni</i>	armenit	<i>hujերու</i>	armenëve
<b>Rr.</b>	<i>hujէ</i>	prej armenit	<i>hujերէ</i>	prej armenëve
<b>I.</b>	<i>hujով</i>	me armenin	<i>hujերով</i>	me armenët

Siç shihet nga lakimi i mësipërm, ndryshimi nga forma bazë e lakimit, qëndron në rasën gjinore dhe dhanore, të cilat bëhen “*hujni*” në vend të “*hujh*”.

Fjalët që lakohen sipas këtij lloj lakimi nuk janë shumë. Kryesisht janë fjalët njërrrokëshe.

Disa fjalë që lakohen sipas lakimit me “*ni*”:

<i>ւարդ</i> - njeri	<i>գար</i> - gur	<i>գահ</i> - fron	<i>արջ</i> - ari
<i>հաւ</i> - pulë	<i>լոյլ</i> - lopë	<i>ծով</i> - det	<i>ձի</i> - kalë
<i>ւսուչ</i> - djalë	<i>շահ</i> - fitim	<i>արեւ</i> - diell	<i>հով</i> - erë, fllad
<i>ւաւ</i> - varkë, barkë			

### Shënim:

Fjalët “*huj*” dhe “*ւարդ*”, në rasën gjinore dhe dhanore, numri shumës, përdoren edhe në trajtën “*hujոց*”, “*ւարդոց*”, krahas me formën e zakonshme “*hujերու*”, “*ւարդերու*”:

*hujոց պատմութիւնը* - historia e Armenëve

*ւարդոց շարութիւնը* - ligësia e njerëzve

**Shembuj:**

<i>արևուն լոյսը</i>	drita e diellit
<i>ծովուն ալիքները</i>	dallgët e detit
<i>հովուն ձայնը</i>	zhurma e erës
<i>դարուն ոգին</i>	shpirti i shekullit

Të gjithë Infinitivët, kur përdoren si emra, lakohen si më poshtë:

<i>սիրել</i> - <i>սիրելու</i> , <i>սիրելի</i> , <i>սիրելով</i>
<i>սիրելու</i> <i>ուարիքը</i> - mosha e të dashuruarit (e dashurisë)
<i>սիրելի</i> <i>դադրիլ</i> - të tërhequrit prej dashurisë (të heqësh dorë)

**b) Lakimi me “եան” (բարութիւն - բարութեան)**

Të gjitha fjalët që mbarojnë me “իւն” lakohen si më poshtë:

Në përgjithësi, këto fjalë janë emra abstraktë.

**Shembull:**

Lakimi i fjalës “բարութիւն - mirësi”.

	Njëjës		Shumës
		Trajta e Pashquar	
<b>E.</b>	<i>բարութիւն</i>	mirësi	<i>բարութիւններ</i> mirësitë
<b>K.</b>	<i>բարութիւն</i>	mirësinë	<i>բարութիւններ</i> mirësitë
<b>Gj.</b>	<i>բարութեան</i>	i/e/të mirësisë	<i>բարութեանց</i> i/e/të mirësive
<b>Dh.</b>	<i>բարութեան</i>	mirësisë	<i>բարութեանց</i> mirësive
<b>Rr.</b>	<i>բարութենէ</i>	prej mirësisë	<i>բարութիւններէ</i> prej mirësive
<b>I.</b>	<i>բարութեամբ</i>	me mirësi	<i>բարութիւններով</i> me mirësitë
	<i>բարութիւնով</i>		

Në numrin shumë, këto fjalë lakohen sipas lakimit bazë, me përjashtim të rasës gjinore dhe dhanore, ku mbaresa “եանց” përdoret krahas mbaresës së rregullt “երու”:

*բարութիւններու - բարութեանց*

c) Lakimi me “*wú*” (*op - opniwú*)

**Shembull:**

Lakimi i fjalës “*op - ditë*”.

<b>E.</b>	<i>op</i>	ditë
<b>K.</b>	<i>op</i>	ditën
<b>Gj.</b>	<i>opniwú</i>	i/e/të ditës
<b>Dh.</b>	<i>opniwú</i>	ditës
<b>Rr.</b>	<i>opt, opnipt</i>	prej ditës
<b>I.</b>	<i>opni</i>	me ditë

Diferenca në lakim nga forma bazë qëndron në rasën gjinore dhe dhanore, njëjës, e cila formohet me mbaresën “*niwú*” në vend të mbaresës së rregullt me “*p*”.

Shumësi formohet duke ndjekur rregullin bazë të lakimit të emrave.

Emra të tjerë që lakohen njëjloj si “*op - opniwú*” janë:

<i>wúwop</i> - verë	<i>wúqawp</i> - herë	<i>wúwop</i> - para, përpara
<i>wúwop</i> - sot	<i>wúwop</i> - mëngjes	<i>qhp</i> - mbrëmje, natë
<i>pwúwop</i> - nesër	<i>pwúwúwúwú</i> - kohë	<i>hp</i> - mbrëmje
<i>wúwop</i> - vit	<i>wúwop</i> - muaj	<i>gtp</i> - mesditë
<i>tp</i> - dje	<i>wúw</i> - vdekje	<i>lp</i> - mesditë

Fjalët: *wúwop*, *pwúwop*, *pwúwúwúwú*, *wúqawp* ndjekin gjithnjë lakimin bazë në rasën rrjedhore dhe nuk bëjnë: *wúwúwúwúwú*, *pwúwop*, *pwúwúwúwúwúwúwú*, *wúqawp*

Në rasën gjinore dhe dhanore, shumë prej këtyre fjalëve ndjekin lakimin bazë.

**Shembull:**

<i>opniwú</i> <i>pwúwop</i>	orët e ditës
<i>wúwúwúwúwú</i> <i>hp</i> <i>pwúwop</i>	që prej mëngjesit
<i>wúwúwúwúwú</i> <i>op</i>	mot vere
<i>qhp</i> <i>pwúwúwúwúwúwúwúwúwú</i>	dritat e mbrëmjes
<i>tp</i> <i>wúqawp</i> <i>wúwúwúwúwúwúwúwúwú</i>	për dy herë
<i>tp</i> <i>pwúwúwúwúwúwúwúwúwú</i>	lajmi i djeshëm

**d)** Lakimi me “*ււ*” i fjalëve që mbarojnë me “*ու*”

(*շարժու* - *շարժւան*)

Fjalët që mbarojnë me “*ու*” e formojnë rasën gjinore dhe dhanore duke hequr “*ու*” dhe duke shtuar “*ան*”, ndërsa rasën instrumentale e formojnë duke shtuar “*աւր*”:

### Shembull:

Lakimi i fjalës “*շարժու* - lëvizje (të lëvizurit)”.

<b>E.</b>	<i>շարժու</i>	lëvizje
<b>K.</b>	<i>շարժու</i>	lëvizjen
<b>Gj.</b>	<i>շարժւան</i>	i/e lëvizjes
<b>Dh.</b>	<i>շարժւան</i>	lëvizjes
<b>Rr.</b>	<i>շարժոււր</i>	prej lëvizjes
<b>I.</b>	<i>շարժւաւր</i>	me lëvizjen
	<i>շարժուով</i>	

Në të njëjtën mënyrë lakohen edhe fjalët: *ղաղարու*, *կործանու*, *անկու*, etj.

**e)** Lakimi me “*ւո*” i fjalëve që mbarojnë me “*ր*” dhe “*ու*”

(*հոզ* - *հոզու*)

Fjalët që mbarojnë me “*ր*” dhe “*ու*” e formojnë rasën gjinore dhe dhanore duke hequr “*ր*” ose “*ու*” dhe duke shtuar “*ւո*”.

Këtij lakimi i përkasin fjalët:

<i>հոզ</i> - shpirt	<i>հոզու</i> - i/e, shpirtit
<i>զոհ</i> - verë	<i>զոհու</i> - i/e, verës
<i>կիկեղեցի</i> - kishë	<i>կիկեղեցու</i> - i/e, kishës
<i>ստուար</i> - nder	<i>ստուարու</i> - i/e, nderit
<i>հաշի</i> - llogari	<i>հաշու</i> - i/e, llogarisë

**f)** Lakimi i fjalëve të tipit “*հայր*” - baba, që rasën gjinore dhe dhanore e bën “*որ*”.

(*հայր* - *որ*)

<b>E.</b>	<i>հայր</i>	baba
<b>K.</b>	<i>հայր</i>	babain

<b>Gj.</b>	<i>hoy</i>	i/e babait
<b>Dh.</b>	<i>hoy</i>	babait
<b>Rr.</b>	<i>hoyult</i>	prej babait
<b>I.</b>	<i>hoyunul</i>	me babain

Si fjala “*hoy*” - baba, lakohen edhe fjalët e mëposhtëme:

<i>uloy</i>	<i>Shryawuloy</i>
<i>teyoy</i>	<i>Usunulawuloy</i>
<i>hoyteyoy</i>	<i>ulawuloy</i>
<i>uloyteyoy</i>	<i>ulawuloy</i>
<i>lyeyoy</i>	<i>lyeyawuloy</i>

**g)** Lakimi i fjalës (*pyoy* - motër)

<b>E.</b>	<i>pyoy</i>	motër
<b>K.</b>	<i>pyoy</i>	motrën
<b>Gj.</b>	<i>pyoy</i>	i/e motrës
<b>Dh.</b>	<i>pyoy</i>	motrës
<b>Rr.</b>	<i>pyoyult</i>	prej motrës
<b>I.</b>	<i>pyoyunul</i>	me motrën

Në të njëjtën mënyrë lakohen edhe fjalët:

<i>uloy</i> (zotëri)	<i>uloyoy</i>
<i>lyoy</i> (grua)	<i>lyoyoy</i>
<i>uloyoy</i> (mik, shok)	<i>uloyoyoy</i>

**h)** Lakimi me “*oy*”

<b>E.</b>	<i>Ulyoy</i>	Anglia
<b>K.</b>	<i>Ulyoy</i>	Anglinë
<b>Gj.</b>	<i>Ulyoyoy</i>	i/e Anglisë
<b>Dh.</b>	<i>Ulyoyoy</i>	Anglisë
<b>Rr.</b>	<i>Ulyoyoyult</i>	prej Anglisë
<b>I.</b>	<i>Ulyoyoyunul</i>	me Anglinë

Emrat që mbarojnë me “*hu*” lakohen sipas shembullit të mësipërm. Të tillë janë emrat e shteteve si:

<i>Իտալիա, Իտալիոյ</i>	Italia
<i>Ռուսիա, Ռուսիոյ</i>	Rusia
<i>Սպանիա, Սպանիոյ</i>	Spanja, etj

Ndërsa, emrat e personave që mbarojnë me “*u*”, ndjekin lakimin klasik (bazik); vetëm se germa “*յ*” futet ndërmjet zanores “*u*” dhe zanores tjetër:

<b>E.</b>	<i>Եղիա</i>
<b>K.</b>	<i>Եղիա</i>
<b>Gj.</b>	<i>Եղիայի</i>
<b>Dh.</b>	<i>Եղիայի</i>
<b>Rr.</b>	<i>Եղիայէ</i>
<b>I.</b>	<i>Եղիայով</i>

**i) Lakime të veçanta me “*u*”**

	vajzë	burrë	fëmijë	mal	nip
<b>E.</b>	<i>աղջիկ</i>	<i>էրիկ</i>	<i>մանուկ</i>	<i>լեռ</i>	<i>թոռ</i>
<b>K.</b>	<i>աղջիկ</i>	<i>էրիկ</i>	<i>մանուկ</i>	<i>լեռ</i>	<i>թոռ</i>
<b>Gj.</b>	<i>աղջկան</i>	<i>էրկան</i>	<i>մանկան</i>	<i>լեռան</i>	<i>թոռան</i>
<b>Dh.</b>	<i>աղջկան</i>	<i>էրկան</i>	<i>մանկան</i>	<i>լեռան</i>	<i>թոռան</i>
<b>Rr.</b>	<i>աղջիկէ</i>	<i>էրիկէ</i>	<i>մանուկէ</i>	<i>լեռէ</i>	<i>թոռէ</i>
<b>I.</b>	<i>աղջիկով</i>	<i>էրիկով</i>	<i>մանուկով</i>	<i>լեռով</i>	<i>թոռով</i>

Në kohën e sotme, sidoqoftë, këto lloj emrash mund të lakohen edhe sipas lakimit të parë bazë.

**k) Lakimi i fjalës “*սստուած - սստուծոյ*”:**

<b>E.</b>	<i>Սստուած</i>	Zot
<b>K.</b>	<i>Սստուած</i>	Zotin
<b>Gj.</b>	<i>Սստուծոյ</i>	i/e Zotit
<b>Dh.</b>	<i>Սստուծոյ</i>	Zotit
<b>Rr.</b>	<i>Սստուծւէ</i>	prej Zotit
<b>I.</b>	<i>Սստուծով</i>	me Zotin

1) Shumësi i parregullt i fjalëve “*վարդիկ* - njerëz” dhe “*տղաք* - fëmijë” lakohet si më poshtë:

<b>E.</b>	<i>վարդիկ</i>	<i>տղաք</i>
<b>K.</b>	<i>վարդիկ</i>	<i>տղաք</i>
<b>Gj.</b>	<i>վարդոց</i>	<i>տղոց</i>
<b>Dh.</b>	<i>վարդոց</i>	<i>տղոց</i>
<b>Rr.</b>	<i>վարդոցմէ</i>	<i>տղոցմէ</i>
<b>I.</b>	<i>վարդոցմով</i>	<i>տղոցմով</i>

**Shënim i Rëndësishëm:**

Mënyra më e sigurtë për të shmangur gabimet në lakimin e emrave është përdorimi sa të jetë i mundur e më tepër i formës së lakimit bazë. Format e parregullta të lakimit, paraqitur këtu më sipër, janë dhënë me qëllim që të njihen dhe të mos bëhen shkak keqkuptimesh, kudo që ato hasen.

Dallimet Armenisht - Shqip

**Gjuha Armene Perëndimore** nuk ka gjini.

**Gjuha Shqipe** ka **3** (tre) gjini: mashkullore, femërore, asnjane.

**Gjuha Armene Perëndimore**

ka gjashtë (6) rasa

- |    |                   |               |
|----|-------------------|---------------|
| 1. | <i>ուղղական</i>   | emërore       |
| 2. | <i>հայցական</i>   | kallzore      |
| 3. | <i>սեռական</i>    | gjinore       |
| 4. | <i>տրական</i>     | dhanore       |
| 5. | <i>բացատրական</i> | rrjedhore     |
| 6. | <i>գործիական</i>  | instrumentale |

**Gjuha Shqipe**

ka pesë (5) rasa:

- |    |           |
|----|-----------|
| 1. | emërore   |
| 2. | kallzore  |
| 3. | gjinore   |
| 4. | dhanore   |
| 5. | rrjedhore |

**Nuk ka**

# KREU III

## MBIEMRI (ԱԾԱԿԱՆ)

Mbiemrat vendosen përpas emrit (në raste të rallë vendosen edhe pas emrit) dhe mbeten të pandryshuar pavarësisht numrit dhe rasës së emrit që cilësojnë. Gjatë lakimit së bashku me emrin, vetëm emri lakohet në numrin njëjës dhe shumës.

### Njëjës

Em.	<i>կարսիր վարդ</i>	trëndafil i kuq
Kall.	<i>կարսիր վարդ</i>	trëndafilin e kuq
Gjin.	<i>կարսիր վարդի</i>	i/e trëndafilin të kuq
Dhan.	<i>կարսիր վարդի</i>	trëndafilin të kuq
Rrjedh.	<i>կարսիր վարդէ</i>	prej trëndafilin të kuq
Instr.	<i>կարսիր վարդով</i>	me trëndafilin e kuq

### Shumës

Em.	<i>կարսիր վարդեր</i>	trëndafila të kuq
Kall.	<i>կարսիր վարդեր</i>	trëndafilat e kuq
Gjin.	<i>կարսիր վարդերու</i>	i/e trëndafilave të kuq
Dhan.	<i>կարսիր վարդերու</i>	trëndafilave të kuq
Rrjedh.	<i>կարսիր վարդերէ</i>	prej trëndafilave të kuq
Instr.	<i>կարսիր վարդերով</i>	me trëndafilat e kuq

Gjatë lakimit, mbiemrat nuk marrin nyje. Nyje marrin vetëm emrat.

<i>կարսիր վարդը</i>	trëndafili i kuq
<i>բարձր տունը</i>	shtëpia e madhe
<i>անուշ հոտովը</i>	me erë të mirë
<i>սեւ ջուներուն</i>	qenve të zinj

Mbiemrat mund të përdoren si emra (në këtë rast thuhet që mbiemri është emëruar, dhe vetë procesi i ndryshimit quhet emërzim i mbiemrit). Në këtë, rast ata mund të marrin nyje, mund të lakohen dhe të vendosen në numrin shumës, pra të gëzojnë të gjitha vetitë që gëzon emri.

## Njëjës

Em.	<i>կարսիրը</i>	i kuqi
Kall.	<i>կարսիրը</i>	të kuqin
Gjin.	<i>կարսիրին</i>	i/e të kuqit
Dhan.	<i>կարսիրին</i>	të kuqit
Rrjedh.	<i>կարսիրէն</i>	prej të kuqit
Instr.	<i>կարսիրով</i>	me të kuqin

## Shumës

Em.	<i>կարսիրները</i>	të kuqtë
Kall.	<i>կարսիրները</i>	të kuqtë
Gjin.	<i>կարսիրներուն</i>	i/e të kuqve
Dhan.	<i>կարսիրներուն</i>	të kuqve
Rrjedh.	<i>կարսիրներէն</i>	prej të kuqve
Instr.	<i>կարսիրներովը</i>	me të kuqtë

## Llojet e mbiemrave

Në grupin e mbiemrave bëjnë pjesë 5 (pesë) grupe kryesore:

1. Mbiemrat Cilësorë (*Որակական Ածականներ*)
2. Mbiemrat Dëftorë (*Յուցական Ածականներ*)
3. Mbiemrat Numërorë (*Թուական Ածականներ*)
4. Mbiemrat Pronorë (*Ստացական Ածականներ*)
5. Mbiemrat e Pacaktuar (*Անորոշ Ածականներ*)

## 1. Mbiemrat Cilësorë (*Որակական Ածականներ*)

Këta tregojnë cilësinë e emrit, të cilit i bashkëngjiten:

<i>խելացի մարդ</i>	njeri i mençur
<i>գեղեցիկ կին</i>	grua e bukur
<i>սիրելի աղջիկ</i>	vajzë e dashur
<i>մեծ տուն</i>	shtëpi e madhe
<i>արագ զետ</i>	lumë i shpejtë
<i>սպառ ջուր</i>	ujë i ftohtë

### Krahasimi

Mbiemri, në gjuhën Armene, ka tre shkallë:

- a) pohore - *դրական*
- b) krahasore - *բաղդատական*
- c) sipërore - *գերադրական*

- a) mbiemri në shkallën pohore tregon cilësinë e emrit, ashtu siç vetë emri është, pa bërë krahasim me ndonjë emër tjetër, pa bërë mbivlerësim apo nënvlerësim. Kjo është edhe forma me të cilën mbiemri shfaqet në fjalor:

<i>խելացի մարդ</i>	njeri i mençur
<i>գեղեցիկ կին</i>	grua e bukur
<i>մեծ տուն</i>	shtëpi e madhe

- b) mbiemri në shkallën krahasore mund të tregojë superioritet, inferioritet ose nivel të barabartë cilësor të emrave, të cilëve u bashkëngjitet:

1. Në rastin kur duhet të tregojë superioritet, përpara mbiemrit vendoset ndajfolja “*աւելի*” (me i/e/të), dhe emri ndaj të cilit bëhet krahasimi, vendoset në rasën rrjedhore:

*Արամ Գրիգորէն աւելի խելացի է:*  
Arami është më i zgjuar se Grigori.

*Նուարդ իր քույրէն աւելի սիրուն է:*

Nevarti është më e këndshme se motra e saj

ose, emri ndaj të cilit bëhet krahasimi vendoset në rasën kallzore, duke u paraprirë nga fjala “*քան*” (se):

*Արամ աւելի խելացի է քան Գրիգորը:*

*Նուարդ աւելի սիրուն է քան իր քույրը:*

- 2. Nə rastin kur duhet të tregojë inferioritet, përpara mbiemrit vendoset ndajfolja “*նուազ*” (më pak i/e/të), dhe emri, ndaj të cilit bëhet krahasimi, vendoset në rasën rrjedhore; ose, emri ndaj të cilit bëhet krahasimi, vendoset në rasën kallzore duke u paraprirë nga fjala “*քան*” (se):

*Գրիգոր նուազ խելացի է Արամէն: (rrjedh.)*

*Գրիգոր նուազ խելացի է քան Արամը: (kallz.)*

Nə të dy rastet përkthimi është: Grigori është më pak i zgjuar se Arami.

- 3. Nə rast krahasimi cilësish të barabarta, përpara mbiemrit vendosen ndajfoljet:

*չափ, այնչափ, այնքան, նույնչափ, նույնքան..... որքան:*

*Գրիգոր Արամին (dhan.) չափ խելացի է:*

*Գրիգոր նույնչափ խելացի է որքան Արամը:*

Nə të dy rastet përkthimi është: Grigori është po aq i zgjuar sa Arami.

- c) mbiemri në shkallën krahasore tregon superioritet ose inferioritet absolut, pa bërë krahasim me asgjë tjetër. Kjo formë arrihet, ose duke i vendosur fjalën “*ավէնէն*” (me i/e të) përpara mbiemrit, ose duke i vendosur mbiemrit parashtesën “*ամենա*”, ose duke i vendosur mbiemrit prapashtesën “*ազոյն*”. Këto dy të fundit i japin mbiemrit të njëjtën vlerë dhe kuptim, që i jep fjala “*ավէնէն*” (me i/e të), e vendosur përpara mbiemrit:

*ավէնէն բարձր շէնքը:* Ndërtesa më e lartë. (nga të gjitha)

*ամենաբարձր շէնքը:* Ndërtesa më e lartë. (nga të gjitha)

*բարձրազոյն շէնքը:* Ndërtesa më e lartë. (nga të gjitha)

Siç shihet, në të tre rastet, ndonëse konstruksioni i fjalisë është i ndryshëm, kuptimi është i njëjtë.

## 2. Mbiemrat Dëftorë (*Յուզական Ածականներ*)

Mbiemrat dëftorë në formë janë njëlloj si përemrat dëftorë, vetëm se këta, në dallim nga përemri, nuk shoqërojnë foljen, por emrin. Përemrat dëftorë janë:

<i>այս</i>	ky, kjo	<i>սունք</i>	këta, këto
<i>այդ</i>	ai, ajo	<i>ստնք</i>	ata, ato
<i>այն</i>	ai, ajo	<i>սննք</i>	ata, ato

### Shënim:

- a) *այս* (ky, kjo), *սունք* (këta, këto) - përdoren kur objekti për të cilin po bashkëbisedohet ndodhet pranë folësit.
- a) *այդ* (ai, ajo), *ստնք* (ata, ato) - përdoren kur objekti për të cilin po bashkëbisedohet ndodhet pranë bashkëbiseduesit.
- a) *այն* (ai, ajo), *սննք* (ata, ato) - përdoren kur objekti për të cilin po bashkëbisedohet ndodhet larg folësit dhe bashkëbiseduesit.

Në rastin kur emri shoqërohet me mbiemrin dëftor, ai normalisht merr nyjen shquese në fund.

### Shembull:

Nuk thuhet dhe shkruhet:	<i>այս գիրք</i> - libër im
	<i>այս տուն</i> - shtëpi ime
Por thuhet dhe shkruhet:	<i>այս գիրքը</i> - libri im
	<i>այս տունը</i> - shtëpia ime

Mbiemrat dëftorë mbeten të pandryshueshëm, ndërsa emri, të cilin ata shoqërojnë, mund të lakohet.

## 3. Mbiemrat Numërorë (*Թուական Ածականներ*)

Mbiemrat Numërorë janë tre llojesh:

- a) Numërorë themelore
- b) Numërorë rreshtore
- c) Numërorë shpërndarës

**Shënim:** Mbiemrat Numërorë quhen thjesht **Numërorë**

## a) Numërorët Themelorë

Numërorë themelorë janë:

0	<i>qero</i>	21	<i>pusanemeli</i>
1	<i>veli</i>	30	<i>tertemin</i>
2	<i>terqni</i>	40	<i>pramatumin</i>
3	<i>terep</i>	50	<i>jhumin</i>
4	<i>znru</i>	60	<i>vlaxumin</i>
5	<i>hhip</i>	70	<i>teoxanatumin</i>
6	<i>veli</i>	80	<i>niptomun</i>
7	<i>teoxer</i>	90	<i>hinirumun</i>
8	<i>niptom</i>	100	<i>harpիր</i>
9	<i>hin</i>	101	<i>harpիրveli</i>
10	<i>umur</i>	200	<i>terqni harpիր</i>
11	<i>umanim veli</i>	300	<i>terep harpիր</i>
12	<i>umani terqni</i>	1000	<i>haqar</i>
13	<i>umani terep</i>	1001	<i>haqarveli</i>
14	<i>umanim znru</i>	2000	<i>terqni haqar</i>
15	<i>umanim hhip</i>	3000	<i>terep haqar</i>
16	<i>umanim veli</i>	10 000	<i>umur haqar</i>
17	<i>umanim teoxer</i>	20 000	<i>pusani haqar</i>
18	<i>umanim niptom</i>	100 000	<i>harpիր haqar</i>
19	<i>umanim hin</i>	1 000 000	<i>veli vիրիոն</i>
20	<i>pusani</i>		

**Shënim:**

Të kihet parasysh që në rolin e mbiemrit numëror nuk thuhet:  
*veli harpիր, veli haqar, por thjesht: harpիր, haqar*

**Shembull:**

*harpիր մատիտ ունիմ:*

Unë kam njëqind lapsa.

Numërorët vendosen përpara emrit dhe mbeten të pandryshueshëm, ndërsa emri, të cilin ata shoqërojnë, mund të lakohet. Kur përdoren si emra, pra kur emërzohen, ata mund të lakohen.

Pas një numërori themelor, emri (pavarësisht nëse përfaqëson një apo më shumë sende apo frymorë) vendoset në numrin njëjës kur përdoret në kuptimin e përgjithshëm; kur ai përfaqëson diçka të përcaktuar, atëhere vendoset në numrin shumës, kur bëhet fjalë për më shumë se një objekt.

### Shembull:

<i>Տեսա հինք տուն:</i>	Pashë pesë shtëpi. (në përgjithësi)
<i>Տեսա հինք տուններ:</i>	Pashë pesë shtëpitë. (të përcaktuara)

## b) Numërorët Rreshtorë

<i>ստացիւ</i>	i/e parë
<i>երկրորդ</i>	i/e dytë
<i>երրորդ</i>	i/e tretë
<i>չորրորդ</i>	i/e katërt
<i>հինգերորդ</i>	i/e pestë

Pas numrit të pestë, të gjithë numërorët e tjerë rreshtorë formohen duke u shtuar numërorëve themelorë prapashtesën “երրորդ”.

<i>վեցերորդ</i>	i/e gjashtë
<i>եօթերորդ</i>	i/e shtatë
<i>ութերորդ</i>	i/e tetë
<i>իններորդ</i>	i/e nëntë
<i>սասներորդ</i>	i/e dhjetë
<i>սասնելևկերորդ</i>	i/e njëmbëdhjetë
<i>սասներկոերորդ</i>	i/e dymbëdhjetë
<i>սասներեքերորդ</i>	i/e trembëdhjetë
<i>սասնելչորսերորդ</i>	i/e katërmbëdhjetë
<i>քսաներորդ</i>	i/e njëzetë
<i>յիսուներորդ</i>	i/e pesëdhjetë

<i>վաթսուներկուերորդ</i>	i/e gjashtëdhjetë e dytë
<i>հարհւրերորդ</i>	i/e njëqindtë
<i>հազարերորդ</i>	i/e njëmijtë
<i>երեքհազարերորդ</i>	i/e tremijtë

Në rastet kur numri është i përbërë, prapashtesa “երորդ” i shtohet numrit të fundit.

*Հարհւր եօթանասուն և վեցերորդ:*

I njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë.

*Չորս հարհւր վաթսուն և սէկերորդ:*

I katêrqind e gjashtëdhjetë e një.

Në rastin e thyesave të zakonshme, numëruesi lexohet si numëror themelor, ndërsa emëruesi lexohet si numëror rreshtor.

*5/8 հինք ութերորդ*

*1/2 սէկ երկրորդ*

*2/15 երկու տասն և հինքերորդ*

### c) Numërorët Shpërndarës

Numërorët shpërndarës tregojnë sasinë e vlerave për çdo emër, të cilit ata i përkasin. Me përjashtim të numrit një dhe dy, ata formohen duke i shtuar prapashtesën “-ական” numërorëve themelorë.

#### Shembull:

*երեքական* - nga tre secili

*տասնական* - nga dhjetë secili

*չորսական* - nga katêr secili

*հարհւրական* - nga njëqind secili

Në rastin e numrit një dhe dy, përveç përdorimit “սէկական” (nga një secili), përdoret varianti i përsëritjes së numrit, me kuptimin si më poshtë:

*սէկ սէկ* - nga një secili

*երկու երկու, երկերկու* dhe *երկուքական* - nga dy secili

#### Shembull:

*հինգական խնձոր տուհնք* - u dhamë nga pesë mollë secilit

#### 4. Mbiemrat Pronorë (*Մասցական Ածականներ*)

Mbiemrat pronorë tregojnë kujt i përket objekti për të cilin bëhet fjalë. Ata janë:

<i>իմ</i> - im, ime	<i>ւեր</i> - ynë, jonë
<i>քու</i> - yt, jote	<i>ձեր</i> - i/e juaj, i/e Juaj
<i>իր, ւնոր</i> - i tij, e saj	<i>իրենց</i> - i/e tyre

Emrat, që vijnë pas këtyre mbiemrave dhe të cilëve u përkasin këta mbiemra, marrin mbaresat *u, η, ն(ը)* në përputhje me personin apo personat, të cilëve u përket sendi. Këto mbaresa quhen **nyje pronore**.

##### Shembull:

<i>իմ գիրքս</i> - libri im	<i>ւեր գիրքը</i> - libri ynë
<i>քու գիրքդ</i> - libri yt	<i>ձեր գիրքը</i> - libri i juaj, i Juaj
<i>իր / ւնոր գիրքը</i> - libri i tij	<i>իրենց գիրքը</i> - libri i tyre

##### Shënim:

Të kihet parasysh, që në gjuhën Armene mbiemri nuk ka gjini, ndërsa në gjuhën Shqipe ai ka gjini. Në shëmbullin e mësipërm, përkthimi është bërë duke pasur parasysh gjininë mashkullore të pronës dhe pronarit.

Mbiemri pronor shpesh mund të hiqet si fjalë nga fjalia. Prezenca e tij kuptohet nga përdorimi i nyjes pronore në emrin, të cilit ai i përket.

Në vend të shkruhet apo thuhet "*իմ գիրքս*", mjafton të përdoret "*գիրքս*", që ka të njëjtin kuptim - **libri im**.

Nëqoftëse emri mbaron me zanore, në vend të nyjes pronore "*ը*", përdoret germa "*ւ*": *իր ձին, ւեր ձին, ձեր կատուն, etj.*

Nëqoftëse emrat janë në numrin shumë, përdoren përsëri po të njëjtat mbaresa:

##### Shembull:

<i>իմ գիրքերս</i> - librat e mi	<i>ւեր գիրքերը</i> - librat tanë/tonë
<i>քու գիրքերդ</i> - librat e tu	<i>ձեր գիրքերը</i> - librat tuaj/Tuaj
<i>իր / ւնոր գիրքերը</i> - librat e tij/e saj	<i>իրենց գիրքերը</i> - librat e tyre

Po njëlloj, mbiemrat në vetën e tretë njëjës mund të hiqen, pasi mbaresat e tregojnë qartë se kujt i përkasin objektet.

Emrat e përdorur me ose pa mbiemrat pronorë *hul*, *prn*, *hr*, *uñnr*, të cilët u paraprijnë atyre, lakohen rregullisht sipas lakimit të cilit i përkasin:

**Njëjës**

Em.	<i>hul qhrpru</i>	libri im
Kall.	<i>hul qhrpru</i>	librin tim
Gjin.	<i>hul qhrprhu</i>	i/e librit tim
Dhan.	<i>hul qhrprhu</i>	librit tim
Rrjedh.	<i>hul qhrprtu</i>	prej librit tim
Instr.	<i>hul qhrprnu</i>	me librin tim

**Shumës**

Em.	<i>hul qhrpreru</i>	librat e mi
Kall.	<i>hul qhrpreru</i>	librat e mi
Gjin.	<i>hul qhrprerun</i>	i/e librave të mi
Dhan.	<i>hul qhrprerun</i>	librave të mi
Rrjedh.	<i>hul qhrprertu</i>	prej librave të mi
Instr.	<i>hul qhrprernu</i>	me librat e mi

Në të njëjtën mënyrë lakohen edhe:

<i>(prn) qhrprn</i>	<i>(prn) qhrprern</i>
<i>(hr) qhrpr</i>	<i>(hr / uñnr) qhrprern</i>

Duke i qëndruar besnik sistemit të saj të bashkëtingëlloreve, gjuha Armene edhe në këtë rast paraqet një grup me tre bashkëtingëllore. Më tepër se një çift **Mbylltore**, d.m.th. (**g**) e zëshme dhe (**k**) e pazëshme që hasen në gjuhët Indoeuropiane, gjuha Armene Lindore ka një sistem tripleks (3) bashkëtingëllore: me një *q* (**g**) të zëshme dhe dy bashkëtingëllore të pazëshme, *l* (**k**) jo frymore dhe *p* (**k<sup>h</sup>**) frymore.

**Shënim për qartësim:**

Germa *q* e gjuhës Armene Lindore lexohet - **g** e zëshme në gjuhën Shqipe

Germa *l* e gjuhës Armene Lindore lexohet - **k** e pazëshme jofrymore në gjuhën Shqipe

Germa *p* e gjuhës Armene Lindore lexohet - **k<sup>h</sup>** e pazëshme frymore në gjuhën Shqipe

Në formë të përmbledhur do paraqiteshin kështu:

E zëshme	<i>Գ q</i>	( <b>g</b> )
E pazëshme jofrymore	<i>Կ l</i>	( <b>k</b> )
E pazëshme frymore	<i>Ք p</i>	( <b>k<sup>h</sup></b> )

Secila prej këtyre bashkëtingëlloreve paraqet një fonemë të veçantë (fonemë - njësia më e vogël fonetike e një gjuhe për të dalluar një fjalë nga tjetra). Si shembull për të treguar këtë vlejné tre fjalët e mëposhtëme, kuptimi i të cilave është i ndryshëm në varësi të bashkëtingëllores *q*, *l*, *p*, me të cilën shkruhen:

*գոյ* – vjedhës, hajdut      *կոյ* – brinjë      *քոյ* – vello, perçe

Si rregull, fjalët lexohen ashtu siç shkruhen, p.sh:

*Գաբրիել* (Gabriel) Gabriel, *Գագիկ* (Gagik) Gagik, *գագաթ* (gagat<sup>h</sup>) kulm, *Կատարինե* (Katerine) Katerinë, *կապիկ* (kapik) majmun, *Քրիստոս* (K<sup>h</sup>ristos) Krisht, *քաղաք* (k<sup>h</sup>aghak<sup>h</sup>) qytet, etj.

Nga ky rregull i përgjithshëm, ka disa përjashtime:

- a)** pas zanoreve, germa Armene *q* (**g**) shqiptohet si një (**k<sup>h</sup>**) e pazëshme frymore si në fjalët e mëposhtëme:

*հոկո* (hok<sup>h</sup>s) shqetësim, *ուրակ* (urak<sup>h</sup>) sqepar, *հոկոնակ* (hok<sup>h</sup>naki) shumë, *շոք* (shok<sup>h</sup>) vapë, zheg, *ձիկ* (xik<sup>h</sup>) i shtrënguar, *ձիկ* (xak<sup>h</sup>) i ri, *կարակ* (karak<sup>h</sup>) gjalpë, *իկան* (ik<sup>h</sup>akan) femër, *թավոր* (tak<sup>h</sup>avor) mbret, *ոկո* (ok<sup>h</sup>nel)

ndihmoj, *oqnuun* (ok<sup>h</sup>ud) dobi, *huqútl* (hak<sup>h</sup>nel) vesh, *znq̄h* (shok<sup>h</sup>i) avull, etj. I njëjti rregull aplikohet edhe për fjalët që janë të prejardhura prej tyre: *hnq̄h* (hok<sup>h</sup>i) shpirt, *hnq̄t̄l̄wú* (hok<sup>h</sup>ekan) shpirtëror, *hnq̄t̄pwú* (hok<sup>h</sup>eban) psikolog, *hnq̄l̄np̄wl̄wú* (hok<sup>h</sup>evorakan) fetar, prift, etj.

- b) pas bashkëtingëllores *ɲ* (**ɲ**), germa Armene *q* (**g**) shqiptohet si një (**kh**) e pazëshme frymore si në fjalët e mëposhtëme:

*ɣwɲq* (kark<sup>h</sup>) klasë, rradhë, *ɣwɲqwɲhɲ* (mark<sup>h</sup>arit) perlë, margaritar, *ɣwɲqwɲt* (mark<sup>h</sup>are) profet, *tɲq* (jerk<sup>h</sup>) këngë, *ɣhɲq* (mirk<sup>h</sup>) frut, *tɲqtl* (jerk<sup>h</sup>el) këndoj, *ɲwɲqɣwútl* (tark<sup>h</sup>manel) përkthej, *ɣwɲqɣ* (park<sup>h</sup>ev) dhuratë, etj.

### C. Germat *ɤ* *ɲ*, *S* *u* *n* dhe *ɬ* *ɮ*

Përveç sistemit të dyzuar të bashkëtingëlloreve **Mbylltore**, siç është “**d**” e zëshme dhe “**t**” e pazëshme, gjuha Armene Lindore ka një sistem tripleks me një *ɲ* (d) të zëshme dhe dy bashkëtingëllore të pazëshme, *u* (t) jofrymore dhe *ɮ* (t<sup>h</sup>) frymore.

Sistemi tripleks i bashkëtingëlloreve që kanë lidhje me njera tjetrën *ɲ*, *u*, *ɮ*, paraqitet në tabelën më poshtë:

E zëshme	<i>ɤ</i> <i>ɲ</i>	(d)
E pazëshme jofrymore	<i>S</i> <i>u</i>	(t)
E pazëshme frymore	<i>ɬ</i> <i>ɮ</i>	(t <sup>h</sup> )

Ashtu si në rastin e *p*, *ɣ*, *ɸ*, secila prej këtyre bashkëtingëlloreve është një fonemë e pavarur, d.m.th. njësia më e vogël fonetike që bën dallimin e fjalëve nga njera tjetra. Të tre fjalët e mëposhtëme ndryshojnë në kuptim në varësi të bashkëtingëllores – fonemë që është përdorur *ɲ*, *u* dhe *ɮ*:

<i>ɲtɲ</i> (der)	rol
<i>utɲ</i> (ter)	zotëri
<i>ɮtɲ</i> (t <sup>h</sup> er)	për

Në përgjithësi germat *ɤ* *ɲ*, *S* *u* *n* dhe *ɬ* *ɮ* lexohen ashtu si edhe shkruhen:

#### **Shembull:**

*ɤwúhɲtl* (Daniel) Daniel, *ɤwɣhɲ* (Davit<sup>h</sup>) David, *ɲuu* (das) mësim, *Shqɲwú* (Tigran) Tigran, *uwuɲhɣ* (tatig) gjyshe, *uwúuntɲ* (tanter) zot shtëpie, *ɬtɲtɣu* (Thereza) Tereza, *ɲɲn* (t<sup>h</sup>ë<sup>h</sup>u) thartirë, *ɲwɲ* (t<sup>h</sup>at<sup>h</sup>) putër, etj.

**Përfashtime:**

- a) Ka fjalë të cilat bëjnë përfashtim nga ky rregull me **η (d)** e zëshme të shqiptuar si (t<sup>h</sup>) e pazëshme frymore pas zanoreve dhe pas germës **ρ (r)**:

*Oη* (ot<sup>h</sup>) ajër, *ηωηωρ* (dat<sup>h</sup>ar) pushim, *qωρη* (zart<sup>h</sup>) zbukurim, *ρωρη* (bart<sup>h</sup>) i ndërlikuar, *ρνρη* (burt<sup>h</sup>) lesh, *ύωρη* (mart<sup>h</sup>) njeri, *ψωρη* (vart<sup>h</sup>) lule, *ίωρη* (niart<sup>h</sup>) nerv, *բերη* (bert<sup>h</sup>) fortesë, *ορηρηρη* (oriort<sup>h</sup>) zonjushë, *ջωρη* (xhart<sup>h</sup>) masakër, *որη* (vort<sup>h</sup>) krimb, *երրու* (jert<sup>h</sup>um) betim, *արար* (art<sup>h</sup>ar) pikërisht, tamam, *որի* (vort<sup>h</sup>i) djalë, bir, *արի* (art<sup>h</sup>en) tashmë, *րիլ* (d<sup>h</sup>rt<sup>h</sup>el) nxis, *արառոր* (araxhnort<sup>h</sup>) udhëheqës, etj.

- b) Në disa fjalë kjo gjë ndodh pas germës **ւ (n)**:

*անու* (ant<sup>h</sup>am) antar, *խի* (h<sup>h</sup>ir) kërkesë, *կենան* (kent<sup>h</sup>ani) kafshë, *ընամեն* (ënt<sup>h</sup>amenë) gjithsej, *ընարակ* (ënt<sup>h</sup>arcak) hapësinor, etj.

- c) Në disa fjalë të caktuara, si edhe në pozicionin fundor të fjalës, **η** shqiptohet si **ւ (t)** e pazëshme jofrymore:

*այ* (ajt) ajo, *իլի* (hehtel) mbys, zë frymën, *հիլ* (hotvax) nyje, etj.

- d) Po e njëjta gjë aplikohet edhe për mbaresat pronore:

*ուն* (tun<sup>h</sup>t) shtëpia yte, *հիլ* (hajr<sup>h</sup>t) babai yt, etj.

D. Germat **ղ η** dhe **խ ի**

**ղ η** (gh) dhe **խ ի** (kh) janë një çift bashkëtingëlloresh *guturale* (njera e zëshme, tjetra e pazëshme) të cilat nuk janë në gjuhën shqipe.

*Gutural* – është termi për tingujt që krijohen në fyt.

Tingulli i zëshëm **ղ η** (gh) është i ngjashëm me tingullin *uvular* “**r**” që përdorin francezët parizienë (**rouge** – i kuq, **arriere** – pas, prapa). Në Shqip – shqiptimi më i thjeshtuar, më i përafuar, më praktik (transkriptimi) do të ishte shqiptimi me **-h**:

**Shembull:**

*ղաղառու* (Ghazaros) – Lazarus, *լղաղ* (loghal) – notoj, *ղիղաղաղ* (ghekavar – drejtues).

Për efekt praktikiteti në Shqip do i transkriptojmë:

*ղաղառու* (Hazaros) – Lazarus, *լղաղ* (lohal) – notoj, *ղիղաղաղ* (hekavar – drejtues).

Tingulli i pazëshëm **խ ի** (kh) është i ngjashëm me tingullin “*velar frikative*” të gjuhës Gjermane në fjalët: **acht** (akht) – tetë ose **bach** (bakh) – lumë, që në Shqip – përsëri, shqiptimi më i thjeshtuar, më i përafuar, më praktik (transkriptimi) do të ishte shqiptimi me **-h**: **acht** (aht) dhe **bach** (bah)

**Shembull:**

*hunuł* (khusel) – shpresoj, *nruihu* (urakh) – i gëzuar, *huwnu* (kharrn) – i trazuar, *huruhunuł* (kh<sup>e</sup>rakhusel) – inkurajoj, etj.

Për efekt praktikiteti në Shqip do i transkriptojmë:

*hunuł* (husel) – shpresoj, *nruihu* (urah) – i gëzuar, *huwnu* (harrn) – i trazuar, *huruhunuł* (hrahusel) – inkurajoj, etj.

Në disa fjalë, *ŋ η* (gh) shqiptohet si *h u* (kh), shpesh duke vënë në vështirësi edhe vetë vendasit.

Normalisht duhet të shqiptoheshin: *uŋŋhł* (aghç<sup>h</sup>ik) – vajzë, bijë, *uŋpwan* (aghk<sup>h</sup>at) – i varfër

Praktikisht shqiptohen: *uŋŋhł* (akhç<sup>h</sup>ik) – vajzë, bijë, *uŋpwan* (akhk<sup>h</sup>at) – i varfër

Në Shqip do thjeshtohet: *uŋŋhł* – (ahçik ose akçik), dhe *uŋpwan* – (ahkad).

**Disa rregulla shqiptimi dhe germëzimi:**

1. Përpara germave *ŋ d* (c) dhe *ŋ x* (xh), germa *ŋ η* (gh) mund të shkruhet, ndërsa germa *h u* (kh) – jo; në këtë rast *ŋ η* (gh) shqiptohet si *h u* (kh).

Si duhej shqiptuar	Si shqiptohet	Shqipërimi
<i>ŋłŋd</i> (deghts <sup>h</sup> ) – pjeshkë	<i>ŋłŋd</i> (dekhts <sup>h</sup> )	<i>ŋłŋd</i> (dehc)
<i>ŋŋŋhł</i> (ch <sup>e</sup> ghchik) – shkop	<i>ŋŋŋhł</i> (ch <sup>e</sup> khchik)	<i>ŋŋŋhł</i> (çëhçik)

2. Përpara germës *ł ŋ*, mund të shkruhet germa *ŋ η* (gh) dhe jo germa *h u* (kh); në këtë rast *ŋ η* (gh) shqiptohet përsëri si *h u* (kh).

Si duhej shqiptuar	Si shqiptohet	Shqipërimi
<i>łŋłŋł</i> (t <sup>h</sup> ught <sup>h</sup> ) – letër	<i>łŋłŋł</i> (t <sup>h</sup> ukht <sup>h</sup> )	<i>łŋłŋł</i> (tuht)
<i>łŋŋłłł</i> (maght <sup>h</sup> el) – dëshiroj	<i>łŋŋłłł</i> (makht <sup>h</sup> el)	<i>łŋŋłłł</i> (mahtel)
<i>hŋŋłłłłł</i> (haght <sup>h</sup> anak) – fitore	<i>hŋŋłłłłł</i> (hakht <sup>h</sup> anak)	<i>hŋŋłłłłł</i> (hahtanak)

E. Germat *Ձ ձ*, *Մ ծ* dhe *Յ ց*

Në mënyrë të ngjashme me të gjitha bashkëtingëlloret e tjera të ngjashme të gjuhës Armene Lindore, “*afrikatet*” e gjuhës Armene Lindore paraqiten me një sistem tripleks (të trefishtë). *Ձ ձ*, *Մ ծ* dhe *Յ ց* janë grupi i afrikateve që i korrespondojnë tre zanoreve të veçanta:

**Shënim:**

**Afrikati** - është një tingull i përbërë (kompleks) që përbëhet nga një bashkëtingëllore **Mbylltore** dhe një bashkëtingëllore **Fishkëlljese**.

E zëshme                      *Ձ ձ*            (x) ose i ngjashem me (dz)

E pazëshme jofrymore    *Մ ծ*            (c) ose i ngjashem me (ts)

E pazëshme frymore      *Յ ց*            (c<sup>h</sup>) ose i ngjashem me (ts<sup>h</sup>)

Në varësi të përdorimit të secilit prej Afrikateve, përcaktohet edhe kuptimi i fjalës:

*ձախ*            (xah)            majtas

*ծախու(ել)*    (cahs)(el)      shes

*ցախ*            (c<sup>h</sup>ah)            modë

Shembuj përdorimi të *Ձ ձ* dhe transkriptimi në shqip:

*ձուկ*            (xuk)            peshk

*օձիք*            (oxik<sup>h</sup>)            qafore, kravatë

*ձի*                (xi)                kalë

Shembuj përdorimi të *Մ ծ* dhe transkriptimi në shqip:

*ծաղիկ*            (cahik)            lule

*ծով*                (cov)                det

*ծիծաղել*            (cicahel)            qesh

Shembuj përdorimi të *Յ ց* dhe transkriptimi në shqip:

Shënim: **c<sup>h</sup>** – do përdoret në shqip si **c**.

*ցանց*            (canc)            rrjetë

*բաց*                (pac)                hapur

*ցուցակ*            (cucag)            tregues

**Raste të veçanta:**

Në një numër fjalësh, kur –đ ndodhet pas germës –p, shqiptohet njëlloj si germa –g:

<i>puprdp</i>	(barc <sup>er</sup> )	lart
<i>phnpđ</i>	(porc)	përpjekje
<i>puprd</i>	(barc)	jastëk
<i>uprdulq</i>	(arcak)	prozë
<i>htrpdulq</i>	(dercak)	rrobaqepës
<i>quprdtl</i>	(varcel)	huazoj

F. Germat *Q*, *Đ* dhe *Q*

*Q*, *Đ* dhe *Q* - është grupi i tre Afrikateve, që përcakton tre tinguj qartësisht të dallueshëm ndërmjet tyre.

Në Shqip korrespondojnë me:

1. E zëshme                      *Q*                      (xh)
2. E pazëshme jofrymore      *Đ*                      (ç)
3. E pazëshme frymore        *Q*                      (ç<sup>h</sup>)

**Shembuj:**

1. *qnp* (xhur) – ujë                      *qtrp* (xherm) – ngrohtë
2. *đulđ* (çanç) - mizë                      *đnđulđulq* (çoçanak) – lëkundje
3. *qnp* (ç<sup>h</sup>or) – i tharë                      *qnpqnpql* (ç<sup>h</sup>arç<sup>h</sup>arel) – torturoj  
*qulq* (ç<sup>h</sup>amiç<sup>h</sup>) – rrush i thatë, stafidhe

**Raste të veçanta:**

Në pozicione të caktuara, germa –q mund të lexohet njëlloj si germa –ç:

a) pas zanoreve:

*unwq* (arraç<sup>h</sup>) – përpara, *wq* (aç<sup>h</sup>) – djathtas, *nqh* (voç<sup>h</sup>il) – morr, *ulq* (meç<sup>h</sup>) – në, brenda, *unwqh* (arraç<sup>h</sup>in) – i pari, *ulqp* (meç<sup>h</sup>k) - kurriz.

E njëjta gjë vlen edhe për të gjitha format e gjindores që mbarojnë me *nq* (voç<sup>h</sup>), si p.sh:

*pnjp* (kujr) – motër, *ppnq* (kroç<sup>h</sup>) – i, e motrës, *qh* (kin) – grua, *qunq* (knoç<sup>h</sup>) – i, e gruas, etj.

b) pas germës –*ր* (r):

*արջ* (arç<sup>h</sup>) – ari, *թրջել* (t<sup>h</sup>rç<sup>h</sup>el) – njom, *վերջ* (verç<sup>h</sup>) – fund, *վերջին* (verç<sup>h</sup>in) – i,e fundit, *վերջնալիւն* (verç<sup>h</sup>nakan) - përfundimtar

c) pas germës – *ղ*:

*աղջիկ* (ahç<sup>h</sup>ik) – vajzë, *ողջ* (vohç<sup>h</sup>) – i gjallë, *աւքող* (ampohç<sup>h</sup>) – i,e tërë, *ողոն լիւն* (vohç<sup>h</sup>ujn) – shëndet!, etj.

### G. Germa *Ե է* apo *է է*?

Ka disa rregulla drejtshkrimi dhe fonetike të cilat janë mbizotëruese në përcaktimin e përdorimit të germave *Ե է* dhe *է է*.

*Ե է* - përdoret:

1. Në fillim të fjalës. Në këtë rast shqiptohet si – **je** – në shqip.

*էս* (jes) unë, *էրսոյ* (jeraz) ëndërr, *էփել* (jephel) ziej, *էլք* (jelkh) dalje

2. Në mes të fjalës. Në këtë rast shqiptohet si – **e** – në shqip.

*ւէրէնս* (mek<sup>h</sup>ena) makinë, *գրէլ* (g<sup>h</sup>rel) shkruaj, *թէթել* (t<sup>h</sup>et<sup>h</sup>ev) i lehtë

3. Në fund të fjalës. Në këtë rast shqiptohet si – **e** – në Shqip.

*րոպէ* (rope) minutë, *բազէ* (baze) skifter, *հասցէ* (hasce) adresë, *էթէ* (jet<sup>h</sup>e) nëqoftëse, *կուցէ* (kuce) ndoshta, etj.

4. Në fjalët e prejardhura apo të përbëra dhe shqiptohet:

a) si – **je** – në shqip kur ndodhet pas zanoreve:

*ամենատեղաւր* (amenajerkar) – më i gjati

*կիսատի* (kisajep<sup>h</sup>) – gjysëm i zier, gjysëm i gatuar

b) si – **e** – në shqip kur ndodhet pas bashkëtingëlloreve:

*անէրէս* (aneres) – i pafytyrë, i paturp

*քսանէրկու* (k<sup>h</sup>sanerku) – njëzet e dy

5. Në format e zgjedhueshme të foljes ndihmëse *tu*, *tu*, *tûp*, *tËp*, *tû*, *ku* (*t*) shqiptohet:
- si – **e** – në Shqip, kur folja vjen pas fjalëve që mbarojnë me bashkëtingëllore: *qûnum tu* (g<sup>e</sup>num em) po shkoj (unë), *uum tu* (asum en) po thonë (ata), etj.
  - si – **je** – në Shqip, kur folja vjen pas fjalëve që mbarojnë me zanore: *quim tu* (galu jem) do të vij, *un tu* (t<sup>e</sup>gha jes) ti je djalë, etj.

*t t* - përdoret:

- Në fillim të fjalës dhe në këtë rast shqiptohet si – **e** – në Shqip.  
*tdu* (ezhan) i lirë, *tq* (exh) faqe, *tul* (eak) krijesë, etj.
- Në fund të fjalës ose në mes të fjalës në rastin e fjalëve të prejardhura ose të përbëra dhe në këtë rast shqiptohet si – **e** – në Shqip.  
*jt* - jo, nuk është; vjen nga bashkimi (*jt* = jo + është)  
*utut* - zhduket; vjen nga bashkimi (*ut* + *ut* = pa + ekzistencë)  
*qt* - zbres; vjen nga bashkimi (*qt* + *jt* = poshtë + bie)

## H. Germa *n* apo *o*

Në gjuhën Armene Lindore, rregullat ortografike (drejtshkrimore) dhe fonetike përcaktojnë përdorimin e saktë të germave *n* dhe *o*:

*n* përdoret:

- Në fillim të fjalës, dhe lexohet si – **vo** në Shqip:  
*nh* (vort<sup>h</sup>) djalë, bir, *nv* (vors) gjueti, *nv* (votk<sup>h</sup>) këmbë, etj.
- Në mes dhe në fund të fjalës, dhe në këtë rast lexohet si – **o** në Shqip:  
*no* (çors) katër, *no* (bolor) i gjithë, *no* (Karo) – emër njeriu

3. Në fjalët e përbëra dhe të prejardhura ku – **n** shqiptohet:

a) si – **vo** në shqip kur ndodhet pas zanoreve:

*արջաւորն* – gjueti arinjsh (e prejardhur nga *արջ+ա+ւորն*),  
*աւետաւորաւյլ* – më i afti (prejardhur nga *աւետ+ա+ւորաւյլ*)

b) si – **o** në shqip kur ndodhet pas bashkëtingëlloreve:

*ձկնորս* – peshkatar (e prejardhur nga *ձուկ+որսալ*),  
*աւորոշ* – i papërcaktuar (prejardhur nga *աւ+որոշ*), etj.

### Përfashtim 1:

*Ո* – në fillim të fjalës, lexohet si – **o** vetëm në përemrin *նլ* – kush dhe formën e tij shumë *նլքեր* - cilët.

### Përfashtim 2:

Emrat me origjinë të huaj që fillojnë me (vo), zakonisht shkruhen me *Վ*, *վ* se sa vetëm me –*n*:

*Վոլգա* (Vollga) – lum në Rusi,

*վոլտ* (volt) – volt (njësia e tensionit në elektricitet), etj.

*Օ* o përdoret:

1. Në fillim të fjalës dhe në këtë rast lexohet si – **o** në Shqip:

*օր* (or) – ditë, *օգնել* (ok<sup>h</sup>nel) – ndihmoj, *օղ* (ot<sup>h</sup>) ajër, mot, etj.

2. Brenda fjalëve të përbëra apo të prejardhura, dhe lexohet si – **o**:

*ապօրհնհ* (aporini) ilegal – (prejardhur nga *ապ+օրհնհ*)

*կեսօր* (kesor) mesditë – (prejardhur nga *կե+սօր*)

*աւօգոստ* (anok<sup>h</sup>ut) i padobishëm – (prejardhur nga *աւ+օգոստ*)

*աւօրհնալ* (anorinak) i pashembullt – (prejardhur nga *աւ+օրհնալ*)

### I. Germa *Ելլ էլլ* apo *լ*?

Në gjuhën moderne Armene Lindore ka dy drejtshkrime ose drejtshqiptime të veçanta për kombinimin e tingujve *jev* dhe *ev*. Ata përfaqësohen:

1. Nëpërmjet germës *լ*, që përfaqëson bashkimin e germave *ե* dhe *լ*, dhe që përdoret vetëm kur shkrimi është me germa të vogla.
2. Nëpërmjet bashkimit të dy germave *ե* dhe *լլ*, që shfaqet në formën *Ելլ* ose *էլլ*.

Në ndryshim nga dy germat Armene *ե* dhe *լլ*, kombinimi *լ* nuk i përket alfabetit Armen për shkak të vlerës fonetike të dyfishtë që ka. Megjithatë ai konsiderohet si një kompletim i alfabetit dhe përdoret gjerësisht për të zëvendësuar kombinimin e *ե* dhe *լլ* në të shkruarën dhe printimin në gjuhën Armene Lindore. Më poshtë jepen disa rregulla drejtshkrimore dhe fonetike për përdorimin e *ե*, *լլ*, ose *լ*:

1. Përdorimi i *լ*:

- a) Bashkimi *լ* përdoret si fjalë e veçantë në trajtën e lidhëzës bashkuese: *եւ* – dhe, edhe, e, me, etj.

**Shembull:**

*լ ալլւ* – e te tjera, etj.

*ւարդիկ և նրազ սիջալսյրը* – Njerëzit dhe vendbanimi i tyre.

- b) Në pozicionin fundor ose në mes të fjalës, *լ* – lexohet si – **ev** pas bashkëtingëlloreve:

*եքույթ* (jerevujt) – fenomen, *թեւ* (tev) – krah, *արեւ* (arev), *օթևան* (otevan) – strehim, *տեղեւ* (derev) – gjethe, *իբրեւ* (iprev) – si, në rolin e..., *նրեւ* (vorev) – çdo, cilido, etj.

- c) Në pozicionin fundor ose në mes të fjalës, *լ* – lexohet si – **jev** pas zanoreve:

*լոււ* (najev) – gjithashtu, *թեւ* (tejev) – ndonëse

- d) Në fillim të fjalës, germa *լ* – shfaqet vetëm në dy raste:

*լու* (jevs) – gjithashtu, *եւթ* (jevet) – menjëherë

2. Përdorimi i *Ել* dhe *ել*:

- a) Në fillim të emrave me origjinë të huaj, si dhe i atyre të prejardhur ose të përbërë prej tyre:

*Եվրոպա* (jevropa) – Europa, *Եվրոպական* (jevropan) – european, *հնդեվրոպական* (h<sup>e</sup>ndevropan) – indoeuropean, etj.

- b) Gjatë ndarjes së fjalës: *Երեւոյթ*, *թեւոյնր*, *արեւոյհն*, etj.

- c) Kur shtypet me germa të mëdha (kapitale):

*Երեւոյնի* - fenomen, *Արեւելք* - lindje, *Թեւ* – krah, etj.

- d) Në fjalët e përbëra ku *ե* dhe *լ* takohen rastësisht:

*ուարեւերք* – fundviti, *հոգեւիճակ* – gjendje emocionale

J. Germa *Ռ* *n* apo *Ր* *n* ?

Germat *Ռ* *n* dhe *Ր* *n* përfaqësojnë dy tinguj të dallueshëm nga njeri tjetri: *Ռ* *n* (**rr** - Shqip) është një tingull rrokullisës (*alveolar*) me një vibrim të fortë dhe shqiptohet njëlloj si - **rr** - e Shqipes. Ndërsa *Ր* *n* përfaqëson një tingull më të butë, i njëllotë me - **r** - e shqipes. Në varësi të përdorimit të njerës apo tjetrës, fjalët marrin kuptime të ndryshme.

**Shembuj:**

*վարել* (varel) – drejtoj

*վարել* (varrel) - djeg

*լրել* (k<sup>e</sup>rel) - ngarkoj

*լրել* (k<sup>e</sup>rrel) – farkëtoj

Disa orientime lidhur me përdorimin e *Ռ* *n* dhe *Ր* *n* në gjuhën Armene:

1. Në gjuhën Armene, vetëm pak fjalë fillojnë me germat *Ռ* *n*. Akoma më pak fjalë fillojnë me germën - *Ր* *n*.

- a) Ndër më të përdorshmet që fillojnë me germën *Ռ* *n* janë:

*ռեւոյն* (rretin) – gomë, *ռազմիկ* (rrazmik) – luftëtar, *ռումբ* (rrumb) – bombë, *ռոճիկ* (roçik) – pagë, shpërblim, *Ռուսաստան* (Rrusastan) – Rusia, si edhe të prejardhurat prej tyre.

b) Ndër fjalët që fillojnë me germën - *Γ p* janë:

*ρnyκt* (rope) – minutë, moment, çast, *ρnyκtωlywú* (ropeakan) – momentalisht, *Γωφφh* (Raffi) – emër njeriu (mashkull)

2. Brenda fjalëve, germa -*n* zakonisht shfaqet para germës -*ú*:

*wnúktl* (armel) – marr, *ηwnúwl* (darrnal) – kthej, *ρnúktl* (p<sup>ε</sup>rrnel) – mbaj, *uywnúwl* (sparrnal) – kërcënoj, etj.

Përjashtim bën fjala:

*qwrúwú* (garnan) – i, e pranverës, që është gjindorja e fjalës *qwrnú* (garun) – pranverë, etj.

3. Përpara bashkëtingëllore të tjera, përjashtuar -*ú*, germa -*p* shfaqet në fjalët:

*úwrp* (mart<sup>h</sup>) – njeri, *ρmip* (burt<sup>h</sup>) – lesh, *ktppmú* (jert<sup>h</sup>um) – betim, *úwrp* (vart<sup>h</sup>) – trëndafil, etj.

Përjashtim bëjnë:

*đknp* (cerk<sup>h</sup>) – dorë, *úwnp* (p<sup>h</sup>ark<sup>h</sup>) – lavdi, *lywnp* (kark<sup>h</sup>) – karrocë, etj.

4. Fjalët, të cilat në gjuhën klasike Armene, mbaronin me -*nú*, e kanë hequr -*ú*- në fundore, duke e lënë fjalën të mbarojë me -*n*:

*ηnn* (durr) – derë, *uwun* (amarr) – verë, *đúkn* (c<sup>ε</sup>merr) – dimër, *úkn* (lerr) – mal, *ρnn* (t<sup>h</sup>orr) – nip, etj.

5. Më poshtë janë renditur disa fjalë që mbarojnë me -*n* ose që e kanë germën -*n* në mes të dy zanoreve:

*wúwn* (antarr) - pyll

*ρwn* (barr) - fjalë

*lyhn* (k<sup>ε</sup>shirr) - peshë

*wúwn* (astarr) - astar

*ptn* (berr) - ngarkesë

*đnn* (curr) - i shtrembër

*uywun* (patarr) - copë, pjesë

*ηúwn* (t<sup>ε</sup>shvarr) - i vështirë

*wun* (arrat) - i bollshëm

*ρwlywnktl* (t<sup>h</sup>apharrel) - bredh

*qnnq* (gorroz) - kryelartë

*nnnp* (urruck) - tumor, gjendër

*wuwhú* (arraçin) - i, e parë

*đwn* (carr) - pemë

*đwnúq* (zharrang) - trashëgimtar

*hwlywnly* (hakarrak) - përkundër

## K. Bashkëtingëlloret e Tjera

- Ƨ q* - shqiptohet ose lexohet si germa **z** në Shqip  
*Ƨ Ƨ* - shqiptohet ose lexohet si germa **zh** në Shqip  
*Ƨ Ƨ* - shqiptohet ose lexohet si germa **l** në Shqip  
*Ƨ h* - shqiptohet ose lexohet si germa **h** në Shqip  
*U u* - shqiptohet ose lexohet si germa **m** në Shqip  
*Ƨ j* - shqiptohet ose lexohet si germa **j** në Shqip  
*Ƨ u* - shqiptohet ose lexohet si germa **n** në Shqip  
*Ƨ Ƨ* - shqiptohet ose lexohet si germa **sh** në Shqip

**Shënim:**

Fjalët që fillojnë me germën “Ƨ” dhe ndiqen nga bashkëtingëlloretja “u” lexohen sikur kanë zanoren “ë” përpara:

**Shembull:**

( Ƨ ) *ƧunuuƧƧ* – ëshdabe’l - nxitoj

( Ƨ ) *ƧunƧuƧƧ* – ëshdemara’n – magazinë, depo

*U u* - shqiptohet ose lexohet si germa **s** në Shqip

**Shënim:**

Fjalët që fillojnë me germën “u”, kur ndiqen nga bashkëtingëlloret *Ƨ, u, u, p* lexohen sikur kanë germën zanore “ë” përpara.

**Shembull:**

( Ƨ ) *uƧhƧƧ* – ësgi’zp - fillim

( Ƨ ) *uuƧhunuƧ* – ësbida’g – i bardhë

*Ƨ Ƨ* - shqiptohet ose lexohet si germa **v** në Shqip

*Ƨ Ƨ* - shqiptohet ose lexohet si germa **f** në Shqip

## L. Bashkëtingëlloret e dyfishuara

Në gjuhën Armene, dyfishimi (dublimi) i zanoreve nuk ndodh, ndërsa dyfishimi (dublimi) i bashkëtingëlloreve është diçka krejt e zakonshme. Në varësi të pozicionit të tyre në fjalë, si edhe të origjinës së tyre, ato mund të shqiptohen si më poshtë.

1. Kur janë në krye të fjalës, bashkëtingëlloret e dyfishuara shqiptohen të veçuara, duke i shtuar një rrokje fjalës nëpërmjet shtimit të një  $\eta$  (<sup>e</sup>) të pashkruar ndërmjet tyre, por të lexuar:

*թթու* (t<sup>e</sup>tu) – thartirë, acid

*ծծել* (c<sup>e</sup>cel) - thith

*զզվելի* (z<sup>e</sup>zveli) – i pështirë, i neveritshëm

*դդում* (d<sup>e</sup>tum) - kungull

*կկու* (k<sup>e</sup>ku) – i krisur

*շշուկ* (sh<sup>e</sup>shuk) - pëshpëritje

2. Kur bashkëtingëlloret e dyfishuar ndodhet në grumbullin e bashkëtingëlloreve që ndodhen në krye të fjalës, bashkëtingëlloret e dyfishuara shqiptohen të veçuara nëpërmjet shtimit të një  $\eta$  (<sup>e</sup>) të pashkruar ndërmjet tyre, por të lexuar:

*ծննդաւայր* (x<sup>e</sup>n<sup>e</sup>ndavajr) - vendlindja

*ւննդարար* (s<sup>e</sup>n<sup>e</sup>ndarar) – ushqimor, i ushqyeshëm

*ծծւայր* (c<sup>e</sup>cmajr) – dado

3. Kur grumbulli i bashkëtingëlloreve është pasojë e heqjes së zanoreve dhe ndodhet përpara një zanoreje, bashkëtingëlloret e dyfishuar shqiptohen si një tingull i vetëm i zgjatur:

*ուղղազրուիլուն* (uh'hagrutjun) - drejtshkrim

*հովվապետ* (hov'vapet) - kryepastor

*օրրան* (or'ran) djep

4. *ն*– e dyfishuar, si rezultat i formimit të numrit shumës, lexohet si një *ն* e gjatë:

*սեհաներ* (sehan'ner) - tryeza

*գործներ* (gorcon'ner) - rrethanat

*բաշիներ* (bazhin'ner) – pjesë, departament

5. Kur bashkëtingëlloret e dyfishuara janë pasojë e fjalëformimit (në fjalët e prejardhura ose të përbëra), secila prej tyre shqiptohet qartë:

*աննայատակ* (an'nëpatak) – pa qëllim

*ընդդեմ* (ënt'dem) – kundër, përkundër

*էրկկնություն* (jerk'kënutjun)

*էրեսուրիչ* (jeres'sërpiç) – fshirëse fytyre, peshqir

Kur foljet pasive rrjedhin nga foljet kalimtare (me ndihmën e - *վ* -), bashkëtingëlloret e dyfishuar *վվ* lexohet si një *վ* e gjatë:

*հոլովվել* (holov'vel) - lakohe

*գրավվել* (g<sup>ë</sup>rav'vel) – jam i zënë me..

*բարելավվել* (barelav'vel) - përmirësohem

6. Në fjalët *onomatopoeike* bashkëtingëlloret e dyfishuara luajnë një rol të veçantë në përcaktimin e mënyrës se si duhet shqiptuar një tingull. Në fjalë të tilla, disa bashkëtingëllore të dyfishuara, siç janë ato dyshe dhe fishkëlljese (vërshëlljese), mund të përsëriten. Normalisht, ato shqiptohen si një bashkëtingëllore e gjatë:

*կրկր* (ç<sup>ë</sup>r'ral) – kërcas, gërvish

*խշշ* (h<sup>ë</sup>sh'shal) - shushurij

*բծծ* (b<sup>ë</sup>zh'zhal) - zukas

*կթթ* (ç<sup>ë</sup>t'tal) – kërcas

### Shënim:

**Onomatopetë** – janë fjalë, që shërbejnë për të riprodhuar tingujt, zërat, zhurmat, britmat. Në dallim nga pasthurrmat, ato nuk shërbejnë për të shprehur ndjenja

7. Në bisedat e përditshme emocionale, bashkëtingëlloret e dyfishuara mund të shërbejnë për të forcuar kuptimin e disa fjalëve. Në këtë funksion përforsues, çdo bashkëtingëllore mund të dyfishohet:

*հիմնում* (him'mar) – tepër budalla, budalla i madh

*հազարներ* (haz'zarner) - me mijëra

*ամեն* (am'men) – çdo njeri pa përjashtim

**Shënim:** Të kihet parasysh që emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm të huazuar në gjuhën Armene nga gjuhët e tjera, normalisht shqiptohen me një bashkëtingëllore të vetme, pothuajse njëlloj si në gjuhën shqipe, siç tregohet më poshtë. Në këtë pike, gjuha Armene gjen pikë kontakti me gjuhën Shqipe:

<b>Anglisht</b>	<b>Armenisht</b>	<b>Shqip</b>
professor	<i>պրոֆեսոր</i>	profesor
Thessalia	<i>Թեսալիա</i>	Thesalia
Apollon	<i>Ապոլոն</i>	Apollon, Apolon
communism	<i>կոմունիզմ</i>	komonizëm

**Përjashtime:**

Mohammed	<i>Մուհամմեդ</i>	Muhamet
<i>մասսուս</i>	<b>mass</b>	masë
<i>Աննա</i>	<b>Anna</b>	Ana
<i>Էմմա</i>	<b>Emma</b>	Ema

## 8. Shenjat e pikësimit

Gjuha Armene ka një grup të përcaktuar qartë shenjash pikësimi.

Shenjat e pikësimit që përdoren në gjuhën Armene ndryshojnë në njëfarë mase nga ato që përdoren në gjuhën Shqipe. Më poshtë tregohen disa prej tyre:

- [:] – dy pika. Në gjuhën Armene, dy pikat në fund të fjalisë tregojnë përfundimin e fjalisë, pra kryejnë të njëjtin funksion që kryen pika në fund të fjalisë në gjuhën Shqipe. Në gjuhën Armene, shenja [:] quhet *վերջաւիտւն* (verçaket) – që në shqip përkthehet - **pikë fundore**.
- [,] – *ստորակետ* (storaket) – **presje**. Kryen të njëjtin funksion si në gjuhën shqipe.  
Në paraqitje grafike, presja (,) e gjuhës Armene është e ngjashme me presjen (,) që përdoret në gjuhën Shqipe. Megjithatë, përdorimi i saj në fjali, nga pikëpamja kuptimore, shpesh është i ndryshëm. Përdoret:

- a) për të ndarë nga njeri tjetri fjalë, fjali apo fraza në një fjali apo frazë ku nuk ka lidhëza të tjera ose ndodhet një e tillë vetëm në fund:

*Դու բերեցիր վարդեր, շուշաններ և սեխակներ:*

Ti solle trëndafila, zambakë dhe karafila.

Kur fjalët, fjalitë dhe frazat lidhen ndërmjet tyre me lidhëzën *և* ose *ու*, përpara nuk përdoret shenja e presjes:

*Եկավ տուն, ճաշեց, սի քիչ հանգստացավ և նորից գնաց:*

Erdhi në shtëpi, hëngri, pushoi pak dhe shkoi përsëri.

- b) për të ndarë fjalinë e varur nga fjalia kryesore (njëlloj si në Shqip):

*Երբ քեզ տեսա, արդեն ուշ էր:*

Kur të pashë, tashmë ishte vonë.

*Կգաւ, էթէ ժամանակ ունենաւ:*

Do të vi, nëqoftëse do të kem kohë.

- c) pas pasthirmave ose emrave të cilëve u drejtohesh drejtpërdrejt:

*Անի, դուրը բաց արա: Ani, hape derën!*

### 3. (◌) - պարոյկ ( baru'jg ) - **pikëpyetje** (e barasvlershme me (?) në Shqip).

Nga pikëpamja e formës dhe përdorimi, shenja e pikëpyetjes që në gjuhën Armene ka formën (◌), ndërsa në Shqip ka formën (?), kemi dallim të dukshëm. Ndërsa fjalitë pyetëse në gjuhën Shqipe përfundojnë me shenjën (?), në gjuhën Armene shenja (◌) vihet mbi rrokjen e theksuar të fjalës që theksohet dhe në fund fjalia mbyllet me shenjën që tregon përfundimin e fjalisë, pra me shenjën (:).

#### Shembuj:

*Քանի՞ լեզու գիտեր:*

Sa gjuhë dini (ju) ?

*Այբաներեն հոսո՞ւմ էք:*

Flisni (ju) shqip ?

*Դո՞ւր էք հոսում այբաներեն:*

Flisni (ju) shqip ?

*Այբաներեն չե՞ք հոսում:*

Nuk flisni (ju) shqip ?

*Այբաներեն՞ն էք հոսում:*

Flisni (ju) shqip ?

*Այբաներեն ես սովորում, չե՞:*

Ju studjoni gjuhën shqipe, apo jo ?

*Մի՞թե այբաներեն ես սովորում:*

Vërtet studjon gjuhën shqipe ?

4. ( ´ ) dhe ( ˘ ) - **shenja te emocionit** (të barasvlershme me (!) në Shqip).

Ka dy shenja pikësimi në gjuhën Armene të cilat shprehin emocion: shenja që thekson një urdhër apo veprim ( ´ ), që do e quajmë shenja theksuese dhe shenja që shpreh çudi, admirim apo ndjenjë ( ˘ ), që do e quajmë shenja thirrrore. Në gjuhën shqipe këto dy shenja, në fakt, gjenden të përmbledhura në një të vetme, që quhet pikëçuditje (!). Po ashtu si pikëpyetja, në gjuhën Armene, edhe këto shenja vendosen mbi gërmë dhe pikërisht mbi rrokjen e fjalës që theksohet, ndërsa fjalitë e kësaj natyre në gjuhën Shqipe përfundojnë me shenjën (!), gjë që tregon natyrën e fjalisë dhe njëkohësisht përfundimin e saj.

Shenja theksuese ( ´ ), në gjuhën Armene, vendoset:

- a) Mbi fjalën e theksuar në një fjali urdhërore:

*Գիրքս ան՝ւր:* Më jep librin!

*Մի՛ զնա:* Mos shko!

- b) Mbi emrat e njerëzve ose fjalëve që përfaqësojnë njerëz:

*Ա՛րամ, ես այստեղ եմ:* Aram, unë jam këtu!

*Պարոն՛ն, այս տեղը ազու՛ն է:* Zotëri, i lirë është ky vend?

- c) Mbi përgjigjet njëfjalëshe që shprehin një pohim ose mohim me vendosmëri:

*Թեղթս բերե՛լ ես:* Ma solle gazetën?

*Այո՛: Ո՛չ: Իհա՛րկե:* Po! Jo! Natyrisht!

- e) Mbi fjalët që duhet të jenë më të theksuara në një fjali:

*Չեմ տեսնում ի՛նչ մատիտ:* Nuk po e shoh lapsin tim!

*Ի՛նչ մատիտը չեմ տեսնում:* Lapsin tim, nuk po e shoh!

Shenja theksuese (´) vendoset në fjalitë që shprehin emocione dhe ku zanorja e theksuar zakonisht shqiptohet më e zgjatuar, pikërisht për të shprehur këtë emocion. Ajo vendoset:

- a) Mbi përshëndetjet, urimet, dëshirat, etj.:

*Ողջո՛ւն*: Përshëndetje!  
*Շնորհապն՛ը*: Urime! ose Përshëndetje!  
*Բարո՛ւն ի՛նչպիսի*: Mirë se erdhe!

- b) Mbi përemrat pyetës me të cilat fillon fjalia që shpreh ndjenja admirimi, keqardhjeje, habie, etj.:

*Ի՛նչ մարդ է:* Çfarë njeriu! (Çfarë njeriu është!)  
*Ո՛ր ի՛նչ ապաստու՛մ:* Kush e priste!  
 ose Kujt ja priste mendja!  
*Ո՛ր րոտե՛ղ ե՛ն այն օրերը:* Ku janë ato ditë!

- c) Mbi shumicën e pasthirmave:

*Վա՛յն*: Ah!  
*Ափսո՛ս*: Medet!  
*Վա՛յ*: Uf!

5. Shenja [ ˘ ], në gjuhën Armene quhet *բութ* (but) dhe përdoret në këto raste:

- a) për të zëvendësuar fjalët që mungojnë:

*Դու նու՛ն ես գնալու, իսկ ես՝ աշխատանքի:*  
 Ti do të shkosh në shtëpi, kurse unë (*do të shktoj*) në punë.

- b) për të ndarë fjalët që janë shkruar pranë njera tjetrës në mungesë të fjalës ndërmjetëse:

*Իս՛կ քեզ սովա՛ծ քիրքն՛ն ի՛ր է:*  
 Ku është libri *im*, që të dhashë ty?

- c) për të ndarë një fjalë nga ndajshtesa e saj:

*Տիկին՛ Սարյանը՝ նուսուցու՛միս, այստե՛ղ է:*  
 Zonja Sarian, *mësuesja ime*, është këtu.

6. Shenja [.,] në gjuhën Armene quhet *վիջակետ* (mixhaket) – **pikë ndërmjetëse**, dhe përdoret në këto raste:

- a) për të lidhur me njera tjetrën fjali, të cilat kanë lidhje kuptimore me njera tjetrën, plotësojnë njera tjetrën, ose të gjitha së bashku plotësojnë idenë, që folësi do të shprehë. Në gjuhën Shqipe, kjo i korrespondon pikëpresjes (;):

*Ես հոգնած էի. փոքր շեշի հասնումսնայ:*

Unë isha i lodhur; vendosa të pushoj.

- b) kur fraza, brenda saj, ndërthur fjali dëftore me fjali pyetëse, çuditëse, etj. për të plotësuar kuptimin e asaj, që kërkohet të shprehet. Në gjuhën Shqipe shpesh në këto raste nuk përdoret pikëpresja, por dy pikat (:) si në rastin më poshtë:

*Հարցու այս է. ուր գնացիր:* Pyetja ime është kjo: ku shkove?

- c) në rastet e ligjëratës së drejtë:

*Դու սուսցիր. «Շատ ուրախ եմ»:* Ti the: Jam shumë i gëzuar!

- d) për të dhënë kuptimin e fjalëve të shkurtuara:

*Պրն. Պայլան (Պարոն Պայլան) - Z. Palian (Zoti Palian)*

7. [«...»] – *չակերտ* (çakert) – **thonjëzat**. Në gjuhën Armene thonjëzat përdoren:

- a) për të hapur ose mbyllur një material të cituar, fjalë, frazë apo fjali, si edhe ndonjë pasazh libri apo ligjëratë të drejtë:

*Դու սուսցիր. «Շատ ուրախ եմ»:* Ti the: Jam shumë i gëzuar!

Të kihet parasysh, që në dialogje, në vend të thonjézave, zakonisht përdoret viza e gjatë, veçanërisht kur përgjigja vjen direkt pas pyetjes:

*-Ո՞ր էս գնումս:* - Ku po shkove?

*-Տնն:* - Në shtëpi.

- b) për të vënë në dukje titujt e librave:

*Շեքսպիրի. «Համլետ»-ը:* Hamleti i Shekspirit

- c) në komente ironike, për të treguar që një fjalë e caktuar është vënë me kuptimin e kundërt të asaj që përfaqëson në të vërtetë:

*Ես նման «բարեկամներ» շատ եմ տեսել:*

Të këtillë “miq”, unë kam parë shumë.

*Բոլորը գիտեն, թե որքան «ազնիվ» ես:*

E dinë të gjithë, se sa i “ndershëm” je.

## 9. Ndarja e fjalës në rrokje

Ndarja e fjalëve në rrokje bëhet njëlloj si në gjuhën Shqipe, duke përdorur shenjën e vizës ndarëse (-).

1. Fjalët njërrrokëshe janë të pandashme:

*ունւ (shtëpi), լեռ (mal), լում (lajm), անւկ (këpurdhë), etj.*

2. Në fjalët me më tepër se një rrokje, bashkëtingellorja, që ndodhet ndërmjet dy zanoreve, shkon me zanoren e dytë:

*լու-լու-ուն-թում (mungesë), նե-րն-ղա-ւրտ (mëshirmadh), etj.*

3. Kur ndërmjet dy zanoreve ndodhen dy bashkëtingëllore, zakonisht gjatë ndarjes së fjalës, bashkëtingellorja e parë shkon me zanoren e parë dhe bashkëtingellorja e dytë shkon me zanoren e dytë:

*լար-տիզ-լու (kopshtar), բազ-ւււ-ղաւ (i përbërë, i shumëfishtë).*

4. Në një fjalë të përbërë, që ka dy zanore njera pas tjetrës, këto zakonisht ndahen:

*լի-ա-ւալ (bashkoj), է-ն-թում (qënie), տի-ե-զէրք (univers), etj.*

5. Tre bashkëtingëllore të ndodhura ndërmjet dy zanoreve zakonisht ndahen në këtë mënyrë: dy bashkëtingëlloret e para shkojnë me zanoren e parë dhe bashkëtingellorja e tretë shkon me zanoren e dytë:

*կանգ-նել (qëndroj), թարգ-ւււ (përkthyes), բարձ-րա-ւալ (ngjis, kacavirem), etj.*

6. *ը* – ë pashkruar, por e shqiptuar, kur ndodhet përpara ose në mes të bashkëtingëlloreve, formon një rrokje më vete dhe si e tillë, kur fjala ndahet, duhet shkruajtur:

*զըը-կէլ* (përqafoj) nga *զրկէլ*, *ըւ-բըն-նէլ* (rrok, kap) nga *ըւբննէլ*, *փըը-փնւր* (shkumë) nga *փրփնւր*, *ըս-կը-սէլ* (filloj, nis) nga *սկսէլ*

7. Një germë e vetme nuk ndahet dhe si e tillë nuk mund të kalojë në rreshtin e mëposhtëm.

8. Fjalët e përbëra mund të ndahen në përputhje me përbërësit e tyre:

*անգլուխ* (pa mend, i trashë) në *ան-գլուխ*, *այսքան* (kaq sa) në *այս-քան*, etj.

9. Fjalët e përbëra, me një bashkëtingëllore ndërmjet dy zanoreve, mund të ndahen sipas përbërësve të tyre ose sipas rregullit të përgjithshëm, sipas të cilit, bashkëtingëlloret ndërmjet dy zanoreve kalon me zanoren e dytë:

*կեսոր* (mesditë) ndahet *կէս-որ* ose *կէ-սոր*,  
*զեստափ* (breg lumi) ndahet *զէտ-ափ* ose *զէ-տափ*,  
*ծովեզերք* (bregdet) ndahet *ծով-եզերք* ose *ծո-վեզերք*,  
*փղնուկ* (fildish) ndahet *փըղ-նուկ* ose *փը-ղնուկ*, etj.

10. Rrokjet që përmbajnë germën “յ” lejojnë që të përdoren të dy variantet e ndarjes:

*այարզուրթուն* (thjeshtësi) ndahet *այար-զու-րթուն* ose *այար-զուրթ-ուն*  
*անկյուն* (qoshe, kënd) ndahet *ան-կյուն* ose *անկ-յուն*  
*ղարձյալ* (përsëri) ndahet *ղար-ձյալ* ose *ղարձ-յալ*, etj.

### 10. Përdorimi i zanores kalimtare ( օ ) për krijimin e rrokjes në gjuhën Armene

Në përgjithësi, në gjuhën Armene, fjalët kanë aq rrokje sa edhe zanore kanë:

një rrokje	<i>սաստ</i>	mur
dy rrokje	<i>ռեսին</i>	gomë
tre rrokje	<i>ընտանիք</i>	familje
katër rrokje	<i>էրկուշաբթի</i>	e Hënë
pesë rrokje	<i>վիրահասունություն</i>	kirurgji

Megjithatë, ky rregull nuk vlen për të gjitha fjalët Armene. Disa fjalë kanë:

**dy rrokje**, por vetëm një zanore: *նկար* (n<sup>e</sup>kar) - pikturë

**tre rrokje**, por vetëm një zanore: *սկրինի* (m<sup>e</sup>k<sup>e</sup>rtel) – pagëzoj

Siç shihet në shembujt e mësipërm, nëpërmjet zanores kalimtare ( <sup>e</sup> ) formohen rrokje shtesë. Zanozja kalimtare ( <sup>e</sup> ) nuk shkruhet, por lexohet. Krijimi i këtyre lloj rrokjeve drejtohet nga disa rregulla të caktuara.

Për shembull, ( <sup>e</sup> ) nuk shkruhet, por lexohet në rastet:

1. Kur ndodhet ndërmjet dy bashkëtingëlloreve në fillim të fjalës:

*մասլ* (m<sup>e</sup>nal) – qëndroj, mbes      *գնալ* (g<sup>e</sup>nal) - shkoj

*թթու* (t<sup>e</sup>tu) – acid, thartirë      *կոճոր* (k<sup>e</sup>dor) - copë

*սկար* (t<sup>e</sup>kar) – i dobët      *սխալ* (s<sup>e</sup>hal) – gabim

2. Përpara bashkëtingëlloreve *u*, *q* dhe *չ* të vendosura në fillim të fjalës dhe kur këto ndiqen nga bashkëtingëlloret *shpërthyes* *p*, *u*, *q*, *g*, *q*, *q*, *u* dhe *p*:

*զգալ* ( <sup>e</sup>sgal) – ndjej      *սկսել* ( <sup>e</sup>sk<sup>e</sup>sel) – filloj

*զգուշ* ( <sup>e</sup>zgush) – i kujdesshëm

3. Kur folja ka parashtesën mohore *-չ*:

*չլինել* ( <sup>e</sup>linel) – nuk jam      *չգիտեմ* ( <sup>e</sup>gitem) – nuk di

4. Kur folja ka parashtesën *-կ*:

*կգամ* (k<sup>e</sup>gam) – po vij/do të vij

*կվազեմ* (k<sup>e</sup>vazem) – do të vrapoj

5. Kur emri merr si prapashtesë mbaresën pronore *u (s)*, *η (t)*, *ն (n)*:

*տունի* (tun<sup>e</sup>t) - shtëpia jote      *մատնի* (mat<sup>e</sup>s) - gisht i im

*Տիգրանի Մեծն* (Tigran Mets<sup>e</sup>n) - Tigrani i Madh

6. Në rrokjen e fundit të patheksuar të disa fjalëve:

*արկ* (ark<sup>e</sup>h) – kuti

*աստ* (ast<sup>e</sup>h) – yll

*մետ* (met<sup>e</sup>r) – metër

## 11. Theksi

Si rregull, në gjuhën Armene, theksi bie mbi rrokjen e fundit. Kjo nënkupton, që theksi është i lëvizshëm dhe ndryshon kur kemi të bëjmë me krijimin e fjalëve të prejardhura apo të përbëra nga fjala bazë:

*հայ* (ha'j) armen

*հայեր* (haje'r) armenë

*հայերեն* (hajere'n) armenisht

*հայերենից* (hajereni'c) nga armenishtja

*հայագիտություն* (hajakidutju'n) armenologji (armenistikë)

Nga ky rregull bëjnë përjashtim këto raste:

1. Duke qenë se zanorja *-ը* (ë) është gjithnjë e patheksuar, theksi vihet mbi rrokjen e fundit, që është përpara rrokjes që përmban zanoren *-ը*, në rastin kur kjo e fundit shërben si mbarese shquese e emrit:

*հայը* (ha'jë) armeni (person)

*հայերը* (haje'rë) armenët

*հայերենը* (hajere'në) armenishtja

*հայագիտությունը* (hajakidutju'në) armenologjia (armenistika)

2. Disa fjalë dy-rrokëshe, jo domosdoshmërisht përbëhen nga dy zanore në të shkruajtur. Rrokja e fundit, në gjuhën Armene, shpesh përmban zanoren e pashkruajtur *-ը*, e cila shqiptohet nëpër dhëmbë, por nuk theksohet:

*բարձր* (pa'rcër) - lart

*վազր* (va'kër) - tigër

*մեղր* (me'hër) – mjaltë

3. Kur fjalët që mbarojnë me një bashkëtingëllore, pavarësisht nga gjatësia e tyre, marrin në fund nyjen e përemrit pronor *-u* (s) ose *-ի* (t), rrokja e fundit që përmban *-ը* e pashkruajtur, nuk theksohet:

*անուն* (anu'nës) – emri im

*ազգանուն* (azkanu'nët) – mbiemri yt

*մայրու* (ma'jrës) – nëna ime  
*գրքերդ* (kërke'rët) – librat e tu

4. Numërorët rreshtorë dhe fjalët e tjera që mbarojnë me *-երորդ* nuk e kanë theksin tek rrokja e fundit. Theksi mbetet tek komponentja kryesore e fjalës:

*հինգերորդ* (hi'nkjerort) – i pesti  
*քսաներորդ* (ksa'n jerort) – i njëzeti  
*իննսուններորդ* (inësü'n jerort) – i nëntëdhjeti  
*քանի՞երորդ* (kani'jerort) – i sati?

5. Disa fjalë të zakonshme nuk e kanë theksin tek rrokja e fundit, prandaj duhet pasur parasysh të mbahen mend përmendësh:

*որվւ՛տ* (vo'reve) – çdo, cilido  
*գո՛ւնէ* (ko'ne) – së paku, fundja, sidoqoftë  
*մի՛միայն* (mi'miajn) - vetëm  
*գո՛ցէ* (ku'ce) - ndoshta  
*գրե՛թէ* (kre'te) - pothuajse  
*նւ՛յնպէս* (nu'jnbes) – gjithashtu, po njëjllonj  
*ա՛նպայման* (a'n bajman) – patjetër, përfundimisht  
*իհա՛րցէ* (iha'rge) – natyrisht, vërtet  
*մա՛նավանդ* (ma'navant) – veçanërisht, mbi të gjitha  
*մի՞թէ* (mi'te) – vërtet? a thua? është e mundur?

## 12. Përdorimi i germave të mëdha (kapitale)

1. Njëjllonj si edhe në gjuhën Shqipe, fjala e parë e fjalisë në gjuhën Armene fillon me gërmë të madhe; po kështu edhe në citimet, vargjet e vjershave, si edhe germa e parë e fjalëve të përveçme:

*Արվւ՛տ* - Armen    *Երևա՛ն* - Jerevan    *Կիւրոս* - Qipru

2. Po kështu, me gërmë të madhe fillojnë emrat fetarë:

*Աստվաճ* - Zot    *Տէր* - Zotëri    *Տիրամայր* - Nëna e Zotit tonë

3. Në emrat e përbërë, të përbërë nga emra të veçantë, të gjithë këta fillojnë me germë të madhe:

a) emrat zyrtare të shteteve

<i>Սևերիկայի Միացյալ Նահանգներ</i>	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<i>Հայաստանի Հանրապետություն</i>	Republika e Armenisë
<i>Ռուսաստանի Դաշնություն</i>	Federata Ruse

b) emrat e njerëzve

<i>Ալեքսանդր Սերգեևիչ Պուշքին</i>	Aleksandër Sergejeviç Pushkin
<i>Ջորջ Բուշ Կրտսեր</i>	Xhorxh Bush i Riu
<i>Ջորջ Նոել Գորդոն Բայրոն</i>	Xhorxh Noel Gordon Bajron

c) emrat gjeografikë të përbërë nga emra të përveçëm të ndarë nga njeri tjetri

<i>Էլզաս Լոթարինքիա</i>	Alzas Lorena
<i>Մեծ Մասիա</i>	Masisi i Madh (Mali Ararat)
<i>Ադիս Աբեբա</i>	Adis Abeba
<i>Բոքր Ասիա</i>	Azia e Vogël

d) kishat dhe vendet e tjera të shenjta që përmbajnë emrin: *Սուրբ* - Shenjt

<i>Սայր Աթոռ Սուրբ Էջմիածին</i>	Selia e Shenjtë e Shën Էջմիաքinit
<i>Ախթաբանար Սուրբ Խաչ Եկեղեցի</i>	Kisha e Kryqit të Shenjtë Ahtamar
<i>Սուրբ Գեվորգ Վանք</i>	Manastiri i Shën Gjergjit

4. Në emrat e përveçëm të përbërë fillon me germë të madhe vetëm fjala e parë, ndërsa fjalët që tregojnë emra të përgjithshëm, jo.

**Shembuj:**

a) emrat e vendeve gjeografike

<i>Հայաստանի երկրամաս</i>	territori i Armenisë
<i>Սև ծով</i>	Deti i Zi
<i>Սևանա լիճ</i>	Liqeni Sevan

- b) emrat e vjetër dhe modernë të shteteve, krahinave dhe lokaliteteve të shteteve

<i>Քուզանական կայսրություն</i>	Perandoria Bizantine
<i>Գրիկիայի հայկական թաքավորություն</i>	Mbretëria Armene e Cilicisë
<i>Հայաստանի առաջին հանրապետություն</i>	Republika e Parë Armene

5. Emrat e çmimeve, shpërblimeve dhe medaljeve të njohura kombëtarisht ose ndërkombëtarisht

<i>Մուրբ Մեսրոպ Մաշտոցի շքանշան</i>	Medalja e Shën Mesrob Mashtocit
<i>Նոբելյան մրցանակ</i>	Çmimi Nobel
<i>Հայրենիքի շքանշան</i>	Medalja e Atdheut

6. Emrat e organizatave, bashkimeve dhe institucioneve ndërkombëtare

<i>Միավորված ազգերի կազմակերպություն</i>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<i>Հաղադրության համաշխարհային խորհուրդ</i>	Këshilli Ndërkombëtar i Paqes
<i>Ազգերի լիգա</i>	Liga e Kombeve

7. Emrat e festave

- a) ditët e festave kombëtare dhe ndërkombëtare

<i>Մարտի ութը</i>	8 Marsi (Dita ndërkombëtare e Gruas)
<i>Անկախության օր</i>	Dita e Pavarësisë
<i>Նոր տարի</i>	Viti i Ri

- b) festat fetare zyrtare

<i>Մուրբ ծննդի տոն</i>	Dita e Krishtlindjeve
<i>Զատիկի տոն</i>	Festa e Pashkëve
<i>Ավագ ուրբաթ</i>	E Premtja e Mirë

## 8. Emrat e ngjarjeve kryesore në histori

<i>Առաջին համաշխարհային պատերազմ</i>	Lufta e Parë Botërore
<i>Մեծ եղեռն</i>	Genocidi Armen
<i>Դիմադրության շարժում</i>	Lëvizja e Rezistencës
<i>Ֆրանսիական մեծ հեղափոխություն</i>	Revolucioni i Madh Francez

## 13. Dallimet Armenisht - Shqip

**Alfabeti Armen Lindor** përbëhet nga **39** germa

**Alfabeti Shqip** përbëhet nga **36** germa

**Alfabeti Armen Lindor** ka **6** (gjashtë) **zanore**, nga të cilat **5** (pesë) shkruhen me një gërmë të vetme dhe përfaqësojnë një tingull të vetëm, ndërsa **1** (një) është e përngjitur dhe përfaqëson një tingull të vetëm.

**Alfabeti Shqip** ka **7** (shtatë) **zanore**, që shkruhen me një gërmë të vetme dhe përfaqësojnë një tingull të vetëm

**Alfabeti Armen Lindor** ka këto germa që nuk i ka **Alfabeti Shqip**:

<i>Ե ե</i>	<i>է չ</i>
<i>Ղ ղ</i>	<i>ղաւտ</i>
<i>Ռ ռ</i>	<i>ւօ</i>
<i>ւ</i>	<i>յեւ</i>

**Alfabeti Shqip** ka këto germa që nuk i ka **Alfabeti Armen Lindor**:

<b>DH</b>	<b>dh</b>
<b>GJ</b>	<b>gj</b>
<b>LL</b>	<b>ll</b>
<b>NJ</b>	<b>nj</b>
<b>TH</b>	<b>th</b>
<b>Y</b>	<b>y</b>

**Alfabeti Armen Lindor** ka vetëm **1** (një) gërmë të përngjitur.

**Alfabeti Shqip** ka **6** (gjashtë) germa të përngjitura.

# KREU II

## EMRI (ԱՆՈՒՆ ԿԱՍ ԳՈՅԱԿԱՆ)

### 1. Trajta e emrave

Njëlloj si në gjuhën Shqipe, edhe në gjuhën Armene Lindore, emri shfaqet në dy trajta: e pashquar dhe e shquar

Emri në trajtë të pashquar nuk ka mbaresë dalluese; ai mund të mbarojë me bashkëtingëllore ose zanore. Kjo është edhe trajta në të cilën emri vendoset në fjalor.

Trajta e shquar e emrit formohet nëpërmjet nyjes shquese që vihet në fund të fjalës.

### 2. Nyja shquese $-ը$ (ë) dhe $-ի$ (n)

Të shquarit e një emri në gjuhën Armene Lindore realizohet duke i shtuar emrave mbaresën shquese  $-ը$  (ë) ose  $-ի$  (n). Përcaktimi, se cili prej tyre duhet përdorur, varet nga natyra fonetike e emrit për të cilin bëhet fjalë.

Si rregull, emri që është në rolin e kryefjalës, është gjithmonë i shquar, pra, e ka mbaresën shquese.

Në rastet e tjera, si rregull:

$-ը$  (ë) - vendoset pas emrave që mbarojnë me bashkëtingëllore, ndërsa

$-ի$  (n) – pas emrave që mbarojnë me zanore.

*զուհի*

qen

*զուհի-ը*

qen-i

*կապույտ*

mace

*կապույտ-ի*

mac-ja

-*û* (**n**) – mund të vendoset në fund të emrit për ta bërë atë të shquar edhe në rastet kur emri mbaron me bashkëtingëllore, por që ndiqet menjëherë me një fjalë që fillon me zanore, si p.sh:

<i>շու՛ն-ն ու կատու-ն</i>	<i>Սա սէր փոռոց-ն է:</i>
qeni dhe macja	Kjo është rruga jonë.

Emrat e përveçëm, në gjuhën Armene Lindore, si rregull e kërkojnë nyjen shquese. Kjo aplikohet në emrat gjeografikë:

<i>Չինաստանը սեճ երկիր է:</i>	<i>Երևանը մայրաքաղաք է:</i>
Kina është shtet i madh.	Jerevani është kryeqytet.

Emrat e njerëzve gjithashtu e kërkojnë nyjen shquese:

<i>Արամը նկարում է:</i>	<i>Արամն ու Լևոնը հայ են:</i>	<i>Անին կարդում է:</i>
Arami po vizaton. Arami dhe Levoni janë armenë.		Ani po lexon.

### 3. Nyja e pashquar – *ւի* (**mi**) - një

Në kontrast me nyjen shquese –*ը* (**ë**) dhe –*ն* (**n**), njëlloj si në gjuhën shqipe, nyja e pashquar *ւի* (**mi**) – një, vihet përpara emrit si element më vete, pa ju bashkangjitur atij në të shkruar.

<i>Մի տուն</i>	<i>մի տղա</i>	<i>մի վարդ</i>
një shtëpi	një djalë	një trëndafil

Sidoqoftë, sipas rastit, nyja e pashquar (*-ւի-*) mund të mos vihet ose të hiqet. Kjo aplikohet veçanërisht në fjalitë ku emri nuk ka të bëjë me anën sasiore, p.sh:

<i>Սա (ւի) վարդ է:</i>	<i>(ւի) նստակ գրեցի:</i>	<i>(ւի) Լավ զինի է:</i>
Ky është (një) trëndafil.	Shkrova (një) letër.	Është (një) verë e mirë.

### 4. Gjinia në gjuhën Armene Lindore

Në dallim nga gramatika e gjuhës Shqipe, e cila për emrin ka tre gjini, që dallohen nga mbaresa e emrit në numrin njëjës, rasa emërore, trajta e shquar, **emrat në gjuhën Armene nuk kanë gjini**.

Në gramatikën Armene, gjinia nuk ka shenjë dalluese siç ndodh në gjuhën Shqipe me mbaresat për gjininë mashkullore, femërore apo asnjane (i, u, a, etj). Në gjuhën Armene Lindore, gjinia dallohet nga konteksti i fjalisë ose situata. I vetmi rast për të shprehur dallimin në gjini në gjuhën Armene është prapashtesa – *nlhh*, e cila i shtohet emrave që tregojnë njerëz të gjinisë mashkullore për të formuar gjininë femërore:

<i>wɔwɔɫɛɾɪn</i> - nxënës	<i>wɔwɔɫɛɾɪnnlhh</i> - nxënëse
<i>nɪuʊɫɪnnɪ</i> - student	<i>nɪuʊɫɪnnɪnlhh</i> - studente

Normalisht, në gjuhën Armene Lindore, dallimi në gjini bëhet me anë të shprehjes së emrit nëpërmjet fjalëve të ndryshme në varësi të gjinisë, p.sh:

<i>ɪnnw</i> – djalë (mashk.)	<i>ɪnnɔɾɪɫ</i> – vajzë (fem.)
<i>hɪnn</i> – baba (mashk.)	<i>ɫɪnn</i> – nënë (fem.)

Në gjuhën Armene, përemri vetor i vetës së tretë, numri njëjës, nuk shpreh gjini siç ndodh me gjuhën Shqipe (**ai, ajo**).

Përsa i përket grupit të emrave të gjinisë asnjane, në përgjithësi në të futen emrat e krijuar si rezultat i emëzimeve të fjalëve të tjera (fjalëve, që nuk i përkasin grupit të emrave të mirëfilltë, por janë të prejardhura nga fjalë të tilla si: mbiemra, folje, ndajfolje, etj)

## 5. Numri i emrave

Njëllonj si në gjuhën Shqipe, edhe në gjuhën Armene Lindore, emri ka 2 numra: numrin njëjës dhe numrin shumës:

## 6. Formimi i numrit shumës të emrave

Shumica e emrave të numërueshëm të gjuhës Armene Lindore e formojnë shumësin e tyre duke i shtuar rrënjës së fjalës prapashtesën:

<i>ɫɾ</i> – për emrat me një rrokje.
<i>ɫɫɾ</i> – për emrat që kanë më shumë se një rrokje.

**Njëjës**

*լույս* – dritë

*զորդ* – qilim

*մատիտ* – laps

*պատմիկ* – dritare

**Shumës**

*լույսեր* - drita

*զորդեր* - qilima

*մատիտներ* - lapsa

*պատմիկներ* – dritare

Vetëm një grup i caktuar fjalësh njërrokëshe e formojnë shumësin me prapashtesën – *ներ*.

**Njëjës**

*լեռ* – mal

*թոռ* – nip

*զառ* – ցինգ

*դուռ* – derë

**Shumës**

*լեռներ* - male

*թոռներ* - nipër

*զառներ* - ցինգյա

*դռներ* - dyer

Prapashtesa – *ներ* vendoset gjithashtu tek fjalët që kanë vetëm një zanore të shkruar, por që lexohen sikur kanë më shumë se një rrokje për shkak të gërmës së pashfaqur –*ը* (<sup>ε</sup>) (që nuk shkruhet, por që shqiptohet) që shqiptohet përpara ose ndërmjet bashkëtingëlloreve:

**Njëjës**

*նկար* (n<sup>ε</sup>kar) – pikturë

*զգեստ* (<sup>ε</sup>zgest) – kostum

**Shumës**

*նկարներ* (n<sup>ε</sup>karner) – piktura

*զգեստներ* (<sup>ε</sup>zgestner) - kostume

por

*վագր* (vag<sup>ε</sup>r) – tigër

*աստղ* (ast<sup>ε</sup>h) – yll

*վագրեր* (vagr<sup>ε</sup>r) – tigra

*աստղեր* (ast<sup>ε</sup>her) – yje

Emrat e përngjitur e marrin prapashtesën –*եր*, n.q.s. përbërësi i dytë është fjalë njërrokëshe:

**Njëjës**

*նսսագիրք* – libër mësimor

*շոգենավ* – anije me avull

*սոսածառ* – pema e Krishtlindjes

**Shumës**

*նսսագիրքեր* - libra mësimorë

*շոգենավեր* - anije me avull

*սոսածառեր* - pemë të Krishtlindjes

Sidoqoftë, nëse përbërësi i dytë është një një derivat foljor, që nuk mund të përdoret si emër më vete, atëhere emri i përbërë merr në fund prapashtesën *-úłr*:

**Njëjës***ստախոս* – gënjeshtar*ձկնորս* – peshkatar*ազգասեր* – patriot**Shumës***ստախոսներ* – gënjeshtarë*ձկնորսներ* – peshkatarë*ազգասերներ* – patriot

Disa emra e formojnë shumësin me prapashtesë të ndryshme. Emrat që mbarojnë me *-gh*, *-wgh*, *-łgh*, e formojnë shumësin duke marrë prapashtesën arkaikë (të lashtë) *-p*:

**Njëjës***երևանցի*

(banor i Jerevanit)

*լոռեցի*

(banor i krahinës Lori)

*գյուղացի* - fshatar**Shumës***երևանցիք* ose *երևանցիներ*

(banorë të Jerevanit)

*լոռեցիք* ose *լոռեցիներ*

(banorë të krahinës Lori)

*գյուղացիք* ose *գյուղացիներ* - fshatarë

Formë tjetër të formimit të shumësit paraqesin emrat:

**Njëjës***կին* – grua*տիկին* – zonjë*պարոն* – zotëri*մարդ* – burrë*տղամարդ* – djalë**Shumës***կանայք* - grua*տիկնայք* ose *տիկիններ* - zonjë*պարոնայք* - zotërinj*մարդիկ* - burra*տղամարդիկ* – djem

**Kujdes:** Pas numërorëve, emrat përdoren në numrin njëjës:

*հինք մարդ* – pesë njerëz; *մթ օր* – tetë ditë; *30 էջ* – tridhjetë faqe

E njëjta gjë ndodh shpesh me emrat që vijnë menjëherë pas përemrave që kanë lidhje me anën sasiore: *քանի* – sa?; *վի քանի* – disa; emrat përdoren shpesh në numrin njëjës:

*Քանի կտոր* – Sa copë?

*Չորս կտոր* – 4 copë.

Megjithatë, pas përemrave: *բոլոր* – të gjithë, *որոշ* – një numër i caktuar, *բազմաթիվ* - shumë, një numër i madh, etj., emrat që vijnë menjëherë pas tyre normalisht i nënshtrohen rregullit të përgjithshëm të formimit të shumësit:

*բոլոր հարցերը* – të gjitha çështjet

*որոշ ուսանողներ* – një numër i caktuar nxënësish

*բազմաթիվ գույներ* – shumë ngjyra (ngjyra të shumta)

Pas përemrave – *շատ* (shumë) dhe – *քիչ* (pak), emri që vjen pas tyre mund të përdoret si në numrin njëjës ashtu edhe në shumës:

*շատ բան* ose *շատ բաներ* – shumë gjëra

*քիչ սարք* ose *քիչ սարքիկ* – pak njerëz

## 7. Lakimi i emrave

Emri në gjuhën Shqipe ka **3** (tre) lakime: lakimi i parë, lakimi i dytë, lakimi i tretë. Në gjuhën Armene Lindore emri ka **disa lakime, të cilët përcaktohen në bazë të ndryshimit që pëson emri fillimisht në rasën gjinore**. Për to do të flitet gjerësisht në kapitullin “Llojet e lakimit të emrave”.

Në gjuhën Armene Lindore, njëlloj si në gjuhën Shqipe, emrat lakohen në trajtën e pashquar dhe të shquar, njëjës dhe shumës.

Ndërsa në gjuhën Shqipe ka pesë rase që janë: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore; në gjuhën Armene Lindore ka shtatë rase që janë: emërore, kallëzore, gjinore, dhanore, rrjedhore, instrumentale dhe vendore.

## 8. Rregulli i lakimit

Për të kryer funksionet e ndryshme sintaksore në një fjali, emrat dhe përemrat në gjuhën Armene Lindore i nënshtrohen një sistemi të tërë të përpunuar të lakimit të tyre.

Ato e ndryshojnë formën e tyre nëpërmjet vendosjes së shenjës së rasës, ndryshimit të zanores apo ndryshimeve të brendshme, ose duke përdorur të dyja njëkohësisht.

Gjuha Armene Lindore ka shtatë rase: emërore, kallëzore, gjinore, dhanore, rrjedhore, instrumentale dhe vendore. Katër të parat emërore, kallëzore, gjinore dhe dhanore formojnë dy çifte që mund të përputhen në formë, por ndryshojnë

në funksionin sintaksor. Funksioni i ndryshëm i çdo rase përcaktohet nga pyetja e veçantë që i korrespondon rasës përkatëse:

Rasa	Person	Jo Person
Emërore	<i>n<sup>o</sup> ul</i> (kush?)	<i>h<sup>o</sup> ul(p)</i> çfarë?
Kallëzore	<i>n<sup>o</sup> ul</i> (kë?)	<i>h<sup>o</sup> ul(p)</i> çfarë?
Gjinore	<i>n<sup>o</sup> ul</i> (i,e kujt?)	<i>h<sup>o</sup> ulh</i> (i,e kujt?)
Dhanore	<i>n<sup>o</sup> ul</i> (kujt?)	<i>h<sup>o</sup> ulh<sup>o</sup> (u)</i> (kujt?)
Rrjedhore	<i>nuh<sup>o</sup> g</i> (prej kujt?)	<i>h<sup>o</sup> ulh<sup>o</sup> g</i> (prej çfarë?)
Instrumentale	-	<i>h<sup>o</sup> uln ul</i> (me çfarë?)
Vendore	-	<i>h<sup>o</sup> uln ul</i> (në çfarë?)

### FORMA BAZË E LAKIMIT

	Person		Jo Person	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
<b>E.</b>	<i>wzalkerpun(p)</i>	<i>wzalkerpun<sup>er</sup>(p)</i>	<i>nyppng(p)</i>	<i>nyppng<sup>er</sup>(p)</i>
<b>K.</b>	<i>wzalkerpih<sup>u</sup></i>	<i>wzalkerpih<sup>er</sup></i>	<i>nyppng(p)</i>	<i>nyppng<sup>er</sup>(p)</i>
<b>Gj.</b>	<i>wzalkerpih</i>	<i>wzalkerpih<sup>er</sup></i>	<i>nyppngh</i>	<i>nyppng<sup>er</sup></i>
<b>Dh.</b>	<i>wzalkerpih(u)</i>	<i>wzalkerpih<sup>er</sup>(u)</i>	<i>nyppngh(u)</i>	<i>nyppng<sup>er</sup>(u)</i>
<b>Rr.</b>	<i>wzalkerpihg</i>	<i>wzalkerpihg<sup>er</sup></i>	<i>nyppnghg</i>	<i>nyppng<sup>er</sup>hg</i>
<b>I.</b>	<i>wzalkerpihul</i>	<i>wzalkerpih<sup>er</sup>ul</i>	<i>nyppngul</i>	<i>nyppng<sup>er</sup>ul</i>
<b>V.</b>	-	-	<i>nyppngul</i>	<i>nyppng<sup>er</sup>ul</i>

**Shënim:** Germat në kllapa i përkasin trajtës së shquar!

## 9. Rasa Emërore dhe Kallëzore

Rasa emërore, në numrin njëjës, është forma me të cilën emri shfaqet në fjalor. Ajo është forma fillestare e rregullit të lakimit dhe nuk ka shenjë dalluese të veçantë. Sidoqoftë, ajo mund të përdoret me ose pa mbaresën shquese (që e bën emrin të shquar) (*-p / -u*) ose mbaresën e pronorit (*-u, -p*), ose (*-p / -u*), sipas rastit.

Emri në rasën emërore, piksëpari, shërben si kryefjalë e fjalisë, pra si emër që përbën boshtin e formimit të fjalisë:

*Անահիսը վառ գույնէր էր սիրում:*      *Գորգու նոր է:*  
 Anahidi pëlqen ngjyrat e ndritshme.      Qilimi im është i ri.

Në fjalitë e mësipërme *Անահիսը* dhe *Գորգու* janë kryefjalë (subjekt) dhe ndodhen në rasën emërore. Kjo mund të kuptohet edhe nga pyetja respektive *ն ի՞նչ* (kush?) të cilës i jepet përgjigja (*Անահիսը*) për rastin e parë dhe *ի՞նչ* (çfarë?) për rastin e dytë, të cilës i jepet përgjigja (*Գորգու*).

Funksioni i dytë sintaksor i rasës emërore është që të shërbejë si subjekt plotësues i kryefjalës. Këtë funksion ajo e kryen duke u bashkuar me foljen ndihmëse - *ես* (jam) ose folje të tjera ndihmëse:

*Եղբայրս բժիշկ է:*      *Արամը փում է ընկերու:*  
 Vëllai im është mjek.      Arami mbetet miku im.

Në fjalinë e parë, si kryefjala *Եղբայրս* (vëllai im), po ashtu edhe plotësuesi i tij *բժիշկ* (mjek) janë në rasën emërore. Ato lidhen me njera tjetrën me foljen ndihmëse *է*. Në fjalinë e dytë, është folja *փում* (qëndroj) që lidh kryefjalën *Արամը* (Arami) me fjalën *ընկերու* (miku im); edhe këtu, përsëri, të dy emrat janë në rasën emërore.

**Rasa kallëzore** ndryshon në varësi të semantikës (**semantika** – fusha kuptimore e fjalës ) së emrit. **Gjuha Armene Lindore bën dallim ndërmjet emrave të personave dhe të atyre që nuk janë persona:** emrat që tregojnë persona përdorin në mënyrë qartësisht të dukshme shenjat që tregojnë rasën; në rastin konkret forma e rasës kallëzore është njëlloj me formën e rasës dhanore (shih: Rregulli i Lakimit); ndërsa emrat që tregojnë jo-persona nuk ndryshojnë, pra janë njëlloj si forma emërore.

Emrat që tregojnë persona:      rasa kallëzore = rasa dhanore  
 Emrat që tregojnë jopersona:      rasa kallëzore = rasa emërore

Në një fjali, rasa kallëzore kryen funksionet si më poshtë:

a) Kundrinë e drejtë në fjali me folje kalimtare:

*Հայրը գովում է որդուն:*      Babai lavdëron djalin e tij.  
*Նկարներու տեսս ի:*      I pe pikturat e mia?

Në këto fjali, *որոնն* dhe *նկարներու* – janë objekt direkt (në gjuhën Shqipe emërtohet – kundrinë e drejtë) mbi të cilin bien veprimet e foljes kalimtare (që në gjuhën Shqipe përkon me – kalimtare veprorë e drejtë), respektivisht *գուլելի* dhe *տեսնելի*. Në fjalinë e parë, pyetja që ka lidhje me djalin (*որոնն*), është *ն ւմ* (kë) dhe të dyja, si pyetja ashtu dhe forma e emrit *որոն*, korrespondojnë me rasën dhanore. Në fjalinë e dytë, pyetja *ի նշ* (çfarë?) i referohet një objekti jo-person; prandaj edhe forma e emrit *նկարներու*, ndonëse emri është në rasën kallëzore, korrespondon me rasën emërore.

b) Ndajfolje vendi që i përgjigjet pyetjes *ն ւր* (ku?):

*Վերջապետ տունն եկա:* Më së fundmi erdha në shtëpi.

*Երբեքս գրադարանն էի գնում:* Nganjëherë shkoja në bibliotekë.

Në fjalitë e mësipërme, emrat *տուն* dhe *գրադարան* janë ndajfolje vendi.

Ndajfolje kohe që i përgjigjet pyetjes *է րբ* (kur?):

*Մի օր էլ նա անհետացավ:* Një ditë prej ditësh ai u zhduk.

*Հաջորդ օտարի կտեսնվենք:* Do të shihemi vitin e ardhshëm.

Në fjalitë e mësipërme, emrat *օր* dhe *օտարի* janë ndajfolje kohe.

c) Ndajfolje që tregon masa apo madhësi (kg., litra, etj.)

*Երեք բաժակ զինի խմեցի:* Piva tre gota verë.

*Տասը գմ. քայլեցինք:* Udhëtua dhjetë km.

Në fjalitë e mësipërme, *երեք բաժակ* dhe *տասը գմ.* vendosen në rasën kallëzore. Pyetjet respektive do formuloheshin në këtë mënyrë:

*Որքա ն զինի խմեցիք:* Sa verë pitë?

*Որքա ն քայլեցիք:* Sa km. udhëtuat?

Rasa emërore, në numrin shumës, merr mbaresën *-(ն)եր*, e cila shfaqet e shoqëruar me ose pa përcaktorë, d.m.th. me nyjen shquese *(-ը / -ն)* ose nyjen pronore *(- u, -դ ose -ը / -ն)*. Kjo sidoqoftë nuk përdoret për emrat që mbarojnë

në numrin shumës me *-p*, *-h*q, ose *-w*q, pasi këto mbaresa të shumësit nuk i pranojnë nyjet *-p* ose *-h*:

**Shembull:**

*Երեխաներն ուշագան:*

Fëmijët u vonuan.

*Մարդիկ (տիկնայք) ուշագան:*

Njerëzit (gratë) u vonuan.

Për rastin e kundrinës së drejtë, rasi kallëzore në numrin shumës zbatohet njëlloj si për numrin njëjës, si për emra personash ashtu edhe për emra jo-persona. Emrat që tregojnë persona përdorin rasën e tyre gjinore – dhanore, ndërsa për emrat jo-person përdoret rasi emërore – kallëzore.

**Shembull:**

*Պաշտպանն նք երեխաներին:*

Të mbrojmë fëmijët!

*Պաշտպանն նք սեր անտանները:*

Të mbrojmë pyjet tona!

## 10. Llojet e lakimit të emrave

Kur lakohen, emrat ndryshojnë formë. Ky ndryshim fillimisht shfaqet në rasën gjinore, pasi kjo është edhe rasi që vjen fill pas rasës emërore. Këtu emri ose merr shenjën (mbaresën) e rasës gjinore, ose ndryshon, ose i bën të dyja njëkohësisht (ndryshon dhe merr edhe mbaresën e rasës gjinore). Nga kjo gjë rrjedh edhe fakti, që **lakimi emërohet sipas ndryshimit, të cilin e pëson emri, kur kalon në rasën gjinore**, si p.sh: lakimi me *-h*, lakimi me *-ni*, lakimi me *-np*, etj.

Më poshtë jepen disa nga mënyrat më të përdorshme të formimit të rasës gjinore të emrit:

**Lakimi me *-h*** (nëpërmjet shtimit të mbaresës *-h* në rasën gjinore);

Kjo është forma më e përdorur.

Shumica e emrave të përgjithshëm dhe të përveçëm Armenë, si edhe mbiemrat, pjesoret, numërorët dhe pronorët e emëruar lakohen sipas shembujve të treguar më poshtë:

*սեղան – սեղանի, քաղաք – քաղաքի, ծառ – ծառի, չառը – չառի, յոթը – յոթի, գրածը – գրածի, սեջը – սեջի, սյուսը – սյուսի, Փարիզ – Փարիզի, etj.*

**Lakimi me** - *ni* (nëpërmjet shtimit të mbaresës – *ni* në rasën gjinore);

Këtij rasti i përkasin:

- a) - shumica e emrave që mbarojnë me – *h*:

*đh* – *đhni*, *nulh* – *nulni*, *użwlyktrunlhh*– *użwlyktrunlhn*, etj.

- b) - të gjithë infinitivët:

*qrlł* – *qrlłni*, *qwl* – *qwlni*, *hullł* – *hullłni*, etj.

- c) - disa emra të përveçëm Armenë dhe jo Armenë:

*Ułnrh* – *Ułnrni*, *Lnrh* – *Lnrni*, *Qnrlyh* – *Qnrlyni*, etj.

- d) - si edhe emrat që vijojnë:

*ıwrrh* – *ıwrrhni*, *wınuıh* – *wınuıni*, *wınyrh* – *wınyrhni*,  
*Uıuıwıđ* – *Uıuıđni*, *wıqh* – *wıqni*, *qhıh* – *qhıni*, etj.

**Lakimi me** – *wı* (nëpërmjet shtimit të mbaresës – *wı* në rasën gjinore);

Këtij rasti i përkasin:

- a) - emrat abstraktë që mbarojnë me – *ni*:

*nıunıw* – *nıunıwıni*, *rniđniw* – *rniđniwıni*, etj.

- b) - disa fjalë njërrrokëshe:

*rhnr* – *rhnrıni*, *qwn* – *qwnıni*, *đniy* – *đniyıni*, *ıniy* – *ıniyıni*, *rhnr* – *rhnrıni*,  
etj.

- c) - dhe fjalët: *wznı* – *wznıni*, *qwrni* – *qwrniıni*,

*ıwıniy* – *ıwıniyıni*

- d) - emrat abstraktë që mbarojnë me – *ni*:*rhni*:

*nırwıhıni* – *nırwıhıniıni*, *đnrni* – *đnrniıni*, *rwrni* – *rwrniıni*  
– *rwrniıni*, etj.

**Lakimi me** – *w* (nëpërmjet shtimit të mbaresës – *w* në rasën gjinore);

Këtij rasti i përkasin:

- a) - emrat që tregojnë kohë: *đw* – *đwıwı*, *or* – *orıwı*, *żwıwı* – *żwıwııwı*,  
*ıwrrh* – *ıwrrıwı*, *qhżkr* – *qhżkrıwı*, *gkrk* – *gkrkıwı*, *wıwn* –  
*wıwnıwı*, *đıkn* – *đıknıwı*, *wıwıwı* – *wıwıwııwı*, *đwıwıwı* –  
*đwıwıwııwı*, etj.

- b) - dhe shumë ndajfolje kohë: *wıor* – *wıorıwı*, *krk* – *krkıwı*, *wıwr* –  
*wıwrıwı*, *wıwı* – *wıwııwı*, *hıwı* – *hıwııwı*, *wıwrıg* – *wıwrıgıwı*, etj.

**Lakimi me** – *nr* (nëpërmjet shtimit të mbaresës – *nr* në rasën gjinore);

Këtij rasti i përkasin emrat që tregojnë pjestarë të familjes:

*hայր – հոր, մայր – մոր, եղբայր – եղբոր, si edhe մորեղբայր – մորեղբոր, etj.*

**Lakimi me** – *nɔ* (nëpërmjet shtimit të mbaresës – *nɔ* në rasën gjinore);

Këtij rasti i përkasin disa pak emra që tregojnë lidhje gjinore apo miqësie:

*քոյր – քրոջ, կին – կնոջ, ընկեր – ընկերոջ, սկեսուր – սկեսրոջ, տալ – տալոջ, տեգր – տեգրոջ, տեր – տիրոջ, տիկին – տիկնոջ, etj.*

**Lakimi me** – *n* (nëpërmjet shtimit të mbaresës – *n* në rasën gjinore);

Ky rast ka të bëjë me disa forma arkaike (të vjetëruara) zgjedhimi. Vetëm shumë pak emra vazhdojnë ta bëjnë gjinoren në këtë formë:

*հույս – հուսոս, սուգ – սգո, սեր – սիրո, պատիիլ – պատիլո, մամուլ – մամլո, etj.*

Gjithashtu ka edhe disa forma të parregullta të gjinores – dhanores që përdoren vetëm në një ose disa pak fjalë:

*-ու: աղջիկ – աղջկա*  
*-եր: դուստր – դստեր, կայսր – կայսեր*  
*-վան: մահ – մահվան, անուն – անվան*  
*-յան: սյուն – սյան, գալուստ – գալստյան, ծնունդ – ծննդյան, անկյուն – անկյան, արյուն – արյան*

Ndonëse grupe të caktuara semantike tentojnë të shkojnë drejt mënyrave të veçanta të lakimit, për çdo rast, nuk mund të thuhet se rregullat e mësipërme të lakimit e kanë përmbyllur këtë temë. Për këtë arsye, lakimi i çdo emri duhet parë si veçori e tij. Duhet pasur parasysh që në përdorimin aktual (bashkëkohor), tendenca e shumicës së emrave është të ndjekin formimin e gjinores nëpërmjet shtimit të mbaresës fundore – *ի*. Kjo duket më e theksuar veçanërisht në bashkëbisedime:

*արյուն      արյան      ose      արյունի*  
*անուն      անվան      ose      անունի*  
*մամուլ      մանկան      ose      մամուկի*  
*գալուստ      գալստյան      ose      գալուստի*

Ndonëse rasa gjinore dhe dhanore e emrit në numrin njëjës kanë ndryshim të madh nga rasa emërore, kjo nuk mund të thuhet për këto dy rasa në numrin shumës, ku ruajnë si bazë rasën emërore. Shumësi i rasës gjinore dhe dhanore të emrit formohet nga rasa emërore e emrit në numrin njëjës duke i shtuar mbaresën *-û(êr)*, plus mbaresën *-(h)û* pas saj:

<b>Emërore</b> <b>(njëjës)</b>	<b>Gjinore</b> <b>(njëjës)</b>	<b>Gjinore/Dhanore</b> <b>(shumës)</b>
<i>ւղջիկ</i>	<i>ւղջկա</i>	<i>ւղջիկ-ûêr-h(û)</i>
<i>ւնու</i>	<i>ւնվա</i>	<i>ւնու-ûêr-h(û)</i>
<i>ձի</i>	<i>ձիու</i>	<i>ձի-êr-h(û)</i>
<i>քոյր</i>	<i>քոջ</i>	<i>քոյր-êr-h(û)</i>

Ndryshimin ose zhvendosjen e zanoreve të caktuara në rasën gjinore, numri njëjës, disa emra e ruajnë edhe në rasën gjinore, numri shumës.

<b>Emërore</b> <b>(njëjës)</b>	<b>Gjinore</b> <b>(njëjës)</b>	<b>Gjinore/Dhanore</b> <b>(shumës)</b>
<i>գիրք</i>	<i>գրքի</i>	<i>գրքերի(û)</i>
<i>ուն</i>	<i>ստի</i>	<i>ստերի(û)</i>

Disa emra devijojnë nga rregulli i mësipërm. Emrat që mbarojnë në rasën emërore shumës me *-ք*, *-իկ* dhe *-այք* marrin në fund mbaresën *-ց*:

<b>Emërore</b> <b>(njëjës)</b>	<b>Emërore</b> <b>(shumës)</b>	<b>Gjinore/Dhanore</b> <b>(shumës)</b>
<i>կի</i>	<i>կանայք</i>	<i>կանանց</i>
<i>մարդ</i>	<i>մարդիկ</i>	<i>մարդկանց</i>
<i>Գրիգոր</i>	<i>Գրիգորէք</i>	<i>Գրիգորեանց</i>

## 11. Rasat Gjinore dhe Dhanore

Të dy rasat kanë ngjashmëri në formë, por ndryshojnë në funksion. Ndërsa gjinorja përdoret gjithnjë pa nyjen shquese, dhanorja shfaqet herë me të dhe herë pa të.

Rasa gjinore si funksion kryesor të saj ka shprehjen e pronësisë. Ajo mund të shprehë prejardhje ose cilësi; si e tillë ajo plotëson një emër i cili është kryefjalë

ose plotësues në një fjali. Në gjuhën Armene, rasa gjinore zakonisht vihet përpara emrit që plotëson:

<i>Երևանի հայրերը</i> – rrusi i Jerevanit	lakimi me <i>-ի</i>
<i>մարդու երագները</i> – ëndrrat e njeriut	lakimi me <i>-ու</i>
<i>նրան զույնը</i> – ngjyra e shegës	lakimi me <i>-ան</i>
<i>ուրախության արցունքները</i> – lotët e gëzimit	lakimi me <i>-յան</i>
<i>տարվա եղանակները</i> – stinët e vitit	lakimi me <i>-վա</i>
<i>քրոջս ամուսինը</i> – burri i motrës	lakimi me <i>-ոջ</i>

Forma gjinore e emrit shpesh është sinonim me mbiemrat e prejardhur prej emrave:

<i>մոր սերը</i>	<i>մայրական սերը</i>
dashuria e nënës	dashuria amësore
<i>թագավորի պալատը</i>	<i>թագավորական պալատը</i>
pallati i mbretit	pallati mbretëror
<i>տան աշխատանք</i>	<i>տնային աշխատանք</i>
puna e shtëpisë	punë shtëpiake

Rasa gjinore kërkohet gjithashtu nga disa parafjalë dhe pasfjalë:

<i>տանց աշխատանքի</i>	<i>հորս մասին</i>
pa punë	për babain tim

Funksioni primar i rasës dhanore është të tregojë marrësin ose përfituesin e një veprimi. Kjo rasë formon kundrinën e zhdrejtë. Shumë folje, emra dhe mbiemra e kërkojnë kundrinën e zhdrejtë në rasën dhanore.

Në gjuhën Armene Lindore, vetëm një numër i kufizuar foljesh shoqërohen vetëm me një kundrinë, dhe këtë në rasën dhanore, ndërsa shumica zakonisht shoqërohet me dy kundrina, njerën në rasën dhanore dhe tjetrën në kallëzore. Foljet me kuptimin “i jep, i huazon, i ofron, etj.” dhe “komunikon, transmeton, etj.” i përkasin këtij grupi të dytë. Në secilën nga fjalitë e mëposhtëme, foljet shoqërohen me të dy llojet e kundrinave:

<i>Գիրքս ուսանողին տվեցի:</i>	Unë ja dhashë studentit librin tim.
<i>Խնդիրը քեզ բացատրել է:</i>	Unë ta kam shpjeguar ty problemin.

Kundrina e drejtë dhe e zhdrejtë në këtë rast imponohen respektivisht nga folja *սալ* (jap) dhe *բացատրել* (shpjegoj): Si rregull, kundrina e drejtë që vendoset në rasën kallëzore i referohet një sendi (*զիրքս, խնդիրը*), ndërsa kundrina e zhdrejtë që vendoset në rasën dhanore përfaqëson një person (*ուսանողին, քեզ*), i cili është marrësi ose përfituesi i veprimit.

Rasa dhanore mund të përdoret edhe për të shprehur ndajfolje të ndryshme, p.sh:

a) kohe

*Մայիսին վարդերը բացվում են:*

Trëndafilat hapin gjatë Majit.

*Կեսզիշերին սի ձայն լսեցի:*

Dëgjova një zhurmë rreth mesnatës.

b) vendi

*Նա դռանը կանգնած է:*

Ai po qëndronte pranë derës.

*Կտուրին սի թռչուն էր երգում:*

Një zog po këndonte mbi çatì.

c) mënyre (çmim, masë, moshë, etj)

*Հազար դրամի գնեցի:*

E bleva për njëqind lekë.

*Մենք նույն տարիքի մարդիկ ենք:*

Ne jemi njerëz të një moshe.

d) qëllimi

*Ճաշի գնացիք:*

Shkuam të darkojmë.

*Եկանք օգնելու:*

Erdhëm të të ndihmojmë.

## 12. Rasa Rrjedhore e emrave

Rasa rrjedhore e gjuhës Armene është e ngjashme me rasën rrjedhore të gjuhës Shqipe në përmbajtje por jo në formë. Gjuha Shqipe e formon rasën rrjedhore me parafjalën “prej”, ndërsa gjuha Armene e formon me mbaresat përkatëse të rasës rrjedhore, që i shtohen emrit ose përemrit. Mbaresat më të përdorura të rasës rrjedhore në gjuhën Armene janë *-ից* dhe *-ուց*, të cilat normalisht i shtohen rasës emërore.

*տուն* – shtëpi

*տն-ից* – prej shtëpisë

*արևելք* – lindje

*արևելք-ից* – prej lindjes

*մարդ* – njeri

*մարդ-ուց* – prej njeriut

*դու* – ti (përemër)

*քեզ(ս)-ից* – prej teje

Megjithatë, ka disa fjalë që e formojnë rasën rrjedhore duke u bazuar në rasën gjinore:

<b>Emërore njëjës</b>	<b>Gjinore njëjës</b>	<b>Rrjedhore njëjës</b>
<i>huyp</i>	<i>hnpr</i>	<i>hnpr-hg</i>
<i>pnlyp</i>	<i>ppnz</i>	<i>ppnz-hg</i>

Kur rasa gjinore mbaron me *-u*, atëhere futet një *-û* ndërmjet formës gjinore dhe mbaresës së rrjedhores *-hg*:

<b>Emërore njëjës</b>	<b>Gjinore njëjës</b>	<b>Rrjedhore njëjës</b>
<i>uηzhlq</i>	<i>uηzlyu</i>	<i>uηzlyu-û-hg</i>
<i>op</i>	<i>oplyu</i>	<i>oplyu-û-hg</i>

Disa emra i ruajnë edhe në rasën gjinore dhe rrjedhore ndryshimet ose këmbimet, që u ndodhin në numrin shumës zanoreve të rrënjës së disa emrave: P.sh.: *qhrp* (njëjës) – *qrpłr* (shumës)

<b>Emërore njëjës</b>	<b>Gjinore njëjës</b>	<b>Rrjedhore njëjës</b>
<i>qhrp</i>	<i>qrpł</i>	<i>qrpł-hg</i>
<i>uuln</i>	<i>uulł</i>	<i>uulł-hg</i>
<i>hużhlq</i>	<i>hużłł</i>	<i>hużłł-hg</i>

Shumëllojshmëria e rrënjëve të emrit që vihet re në numrin njëjës, nuk ruhet në numrin shumës. Formimi i rasës rrjedhore në numrin shumës bazohet mbi numrin shumës të rasës emërore dhe bëhet thjesht duke shtuar mbaresën e rrjedhores *-hg* pas mbaresës së numrit shumës *-(û)łr*:

<b>Emërore njëjës</b>	<b>Emërore shumës</b>	<b>Rrjedhore shumës</b>
<i>pnlyp</i>	<i>pplyp-łr</i>	<i>pplyp-łr-hg</i>
<i>huyp</i>	<i>hulyp-łr</i>	<i>hulyp-łr-hg</i>
<i>uyqł</i>	<i>uyqł-û-łr</i>	<i>uyqł-û-łr-hg</i>

Përjashtime nga ky rregull bëjnë: një grup i kufizuar emrash që në shumës mbarojnë me *-p*, *-łłp*, *-nłp*, *-łł* dhe *-uył*. Formimi i rasës rrjedhore të këtyre emrave bazohet në shumësin e rasës gjinore/dhanore të tyre që mbaron me mbaresën *-g*:

<b>Emërore njëjës</b>	<b>Gjinore shumës</b>	<b>Rrjedhore shumës</b>
<i>qrlhqnrłłp</i>	<i>qrlhqnrłłg</i>	<i>qrlhqnrłłg-hg</i>
<i>lyłnuył</i>	<i>lyłnłng</i>	<i>lyłnłng-hg</i>
<i>ulnrłłł</i>	<i>ulnrłłłng</i>	<i>ulnrłłłng-hg</i>

## 13. Perdorimi i rasës Rrjedhore

Rasa Rrjedhore përdoret:

1. Kur këtë e dikton folja ose mbiemri:

*Uju շնից վախենում եմ:* Unë kam frikë prej këtij qeni.

Në këtë rast thuhet që rasa rrjedhore – *շնից* (prej qenit) diktohet nga folja *վախենում* – trembem. Në shqip mund të përkthehet edhe “unë kam frikë nga ky qen” ose “ky qen më tremb”.

*Այբից հեռու, ստբից հեռու:* Larg prej syve, larg prej mendjes.

Në këtë rast thuhet që rasa rrjedhore – *այբից* (prej syve) dhe – *ստբից* (prej mendjes), diktohen nga ndajfolja – *հեռու* – larg.

2. Për të përshkruar hollësi të ndryshme rrethanoresh siç është, prejardhja, origjina, çvendosje, ose distancë. Ajo mund të tregojë, p.sh. pikënisjen e një veprimi ose ngjarjeje.

- a) personin që është mbartës i një veprimi:

*Uju նվերն ստացել եմ ստրիցու:*

Unë e mora këtë dhuratë prej nënës time.

Këtu fjala në rasën rrjedhore është – “*ստրիցու* - prej nënës”. Kjo fjalë në mënyrë indirekte tregon atë që ka kryer veprimin, pra atë që ka bërë dhuratën. Në këtë rast pyetja që bëhet është: *նուի՞ց*: - prej kujt?

- b) vendin ku fillon një veprim:

*Որտեղի՞ց ես գալիս: Շուկայից:*

Prej nga po vjen? Prej pazarit.

Në këtë rast pyetja që bëhet është: *Որտեղի՞ց*: - prej nga?

- c) personin, vendin apo materialet prej nga e kanë prejardhjen njerëzit apo sendet:

*Երկուսս էլ նույն հորից ենք:* Të dy rrjedhim prej të njëjtit baba.

*Շեքըրը կառուցեցին քարից:* Ndërtesa u ndërtua prej guri.

Pyetja që bëhet në këtë rast është: *նուի՞ց*: - prej kujt? në rastin e parë, dhe *իսի՞ց*: - prej çfarë? në rastin e dytë.

d) kohën si pikënisje e një veprimi apo ngjarjeje:

*Utky çarparþhg lqawt:*

Për një javë do të vij. / Do të vij pas një jave.

*Utingyay tawpawñhg wjuntkñ tkñp:*

Ne ndodhemi këtu që prej vitit të kaluar.

Pyetja që bëhet në këtë rast është: *hñypw ð awñawñhg*: - kur? në ç'kohë?  
- për rastin e parë, dhe *tkñpawñhg g:* - që kur?, qysh kur?, prej kur? - për rastin e dytë.

e) shkakun e një veprimi apo gjendjeje:

*Þrutþg ññññi tkñ:*

Po dridhem prej të ftohtit.

*Unwþhg çawnterþ ðawhawñ:*

Shumica vdiqën prej urie.

3. Shpreh tërësinë e një gjendjeje nga e cila shkëputen pjesë:

*Þñwþtkñhg utkñr uwi t:*

Kjo është njera prej motrave.

*Ujw huwþhg wñ luntþr kw ñ:*

Ha një copë prej kësaj buke.

4. Rasa rrjedhore përdoret për krahasime:

*Ñutkññ awðawþhg (awtkññ) þawñk t:*

Ari është më i shtrenjtë se argjendi.

*Tw þtkawñhg awraq tkñ wñawñwñ:*

Unë vrapoj më shpejt se ty.

5. Rasa rrjedhore përdoret në fjalitë me folje në trajtën pësore ku kryefjala (subjekti kryesor) është larguar nga pozicioni i saj normal dhe është kthyer në një kundrinë të zhdrejtë. Shih krahasimin e dy fjalive më poshtë:

*luntþr þawñðwñkg awtkñhg:*

Bari u dogj prej diellit.

*Þçñawñññ huwþwñkg utkñr luntþhg:*

Armiku u mund prej nesh.

6. Përveç emrave dhe përemrave, në rasën rrjedhore mund të përdoren edhe lloje të tjera fjalësh (siç mund të jenë: ndajfoljet, numërorët, etj) të emëruara:

*wjuntkñ* – këtu      *wjuntkñhg* – prej këtu (nga këtu)

*ðawñ* – majtas      *ðawñhg* – prej anës së majtë (nga e majta)

*utkñ* - brenda      *utkñhg* – prej brendësisë (nga brenda)

## 14. Rasa Instrumentale e emrave

Rasa Instrumentale e emrave, në gjuhën Armene, normalisht tregon mjetin me anë të të cilit kryhet veprimi i shprehur nga folja. Ajo nuk ka ekuivalent në gjuhën Shqipe. Atje ku Shqipja e shpreh kuptimin instrumental duke i shtuar emrit parafjalën **-me** (me laps, me pene, etj), në Armenisht ajo formohet duke i shtuar emrit prapashtesën instrumentale përkatëse të emrit apo përemrit (në rastin e përemrit).

**Shembull:**

<i>nnp</i> – këmbë	<i>nnpnl</i> – me këmbë
<i>lwlh</i> – laps	<i>lwlhnl</i> – me laps
<i>ku</i> – unë (përemër)	<i>hndwnl</i> – me mua

Përrjashtim nga ky rregull bëjnë emrat që mbarojnë me *-nlpnl*. Në rasën instrumentale, numri njëjës, ata mund të marrin edhe mbaresën *-nlpnl*.

Emërore: *qdlwrlpnl* - vështirësi

Instrumentale: *qdlwrlpnl* ose *qdlwrlpnlnl* – me vështirësi

Emërore: *nrlwrlpnl* - gëzim

Instrumentale: *nrlwrlpnl* ose *nrlwrlpnlnl* – me gëzim

## 15. Përdorimet e rasës Instrumentale

1. Rasa Instrumentale shpreh kuptime të ndryshme.

a) Tregon mjetin ose mënyrën me anë të të cilit kryhet një veprim:

*zwgr nwnlwl* kën *lwrlwl*:

Buka pritet me thikë.

*qel wlrlwl hndwrlpnl dwnwrlwrlpnl*:

Nuk më pëlqen udhëtimi me aeroplan.

- b) Tregon shtim të një elementi tek një tjetër:

*Սուրճը կաթով եւ սիրով:* Më pëlqen kafeja me qumësht.

*Այս սպորը բրնձով եւ եփով:* Kjo supë është gatuar me oriz.

- c) Tregon rrugën ose mënyrën e kryerjes së një veprimi:

*Եւ հուզմունքով լսեց ինձ:* Ai më dëgjoji me emocion.

*Համբերությամբ սպասեցի:* E prita me durim.

- d) E përdorur me emra në numrin njëjës që tregojnë kohë, tregon një periudhë të caktuar kohe:

*Մեկ շաբաթով եկա:* Erdha për një javë.

- e) E përdorur me emra në numrin shumës që tregojnë kohë, tregon një periudhë të shtrirë (zgjatur) në kohë:

*Օրերով / շաբաթներով / ամիսներով նրան շտեայ:*

Nuk e kam parë atë me ditë/javë/muaj.

2. Përdorimi i rasës Instrumentale mund të jetë i detyruar nga folja ose mbiemri i përdorur në fjali.

*Այս գուճարով բավարարվում եմ:*

Unë jam i kënaqur me këtë shumë (sasi).

*Մենք հպարտ ենք մեր անցյալով:*

Ne jemi krenarë me (për) të kaluarën tonë.

Në fjalinë e parë, rasa Instrumentale kërkohet prej foljes *-բավարարվել* – të jesh i kënaqur (me diçka), ndërsa në rastin e dytë prej togfjalëshit *- հպարտ լինել* – të jesh krenar (me diçka).

Krahas formës së mirëfilltë instrumentale, gjuha Armene Lindore përdor edhe emrat me prapafjalë (siç janë: head – me, ose *սիջոցով* – me anë të...). Këto dy konstrukcione paralele të fjalisë kanë kuptime të ndryshme. Si shembull për këtë vlen krahasimi i emrit *ամի* - peshk në dy fjalitë e mëposhtëme, ku ai është përdorur:

- a) me prapafjalën – *հետ* në rastin e parë, dhe

- b) në rasën instrumentale (pa prapafjalë apo prapafjalë).

**Shembull:**

- a) emër në rasën dhanore + prapafjala *-hken*  
*Ձկան հետ սպիտակ գինի են խմում:*  
 (Bashkë) Me peshkun ata pinë verë të bardhë.
- b) emër në rasën instrumentale  
*Միայն ձկով չեմ կշտանա:*  
 Vetëm me peshk nuk ngopem.

**Shembuj të tjerë:**

- a) *Մարդկանց հե՛տ եկար:*  
 Erdhe bashkë me njerëz të tjerë?
- b) *Փողոցները լցված էին մարդկանցով:*  
 Rrugët ishin të mbushura me njerëz.

**Gjithashtu:**

*գնացքի հետ = գնացքով* – me tren – me (nëpërmjet) trenit  
*աշխատանքի հետ = աշխատանքով* – me (nëpërmjet) punës

## 16. Rasa Vendore e emrave

Rasa Vendore nominalisht tregon vendin ku ndodh veprimi i shprehur nga folja. Ajo nuk ka ekuivalent në gjuhën Shqipe. Atje ku Shqipja shpreh kuptimin vendor nëpërmjet një parafjale, p.sh. – në (në shtëpi), gjuha Armene e shpreh këtë kuptim (pra e krijon këtë efekt) duke i shtuar emrave dhe disa prej përemrave shenjën e rasës vendore. Shenja më e përdorshme për rasën vendore është – *ում*, që i shtohet emrit të rasës emërore në numrin njëjës ose shumës.

**Shembuj:**

<i>համալսարան</i> – universitet	<i>համալսարանում</i> – në universitet
<i>գիրք</i> – libër	<i>գիրքում</i> – në libër
<i>քաղաքներ</i> – qytete	<i>քաղաքներում</i> – në qytete
<i>հայելիներ</i> – pasqyra	<i>հայելիներում</i> – në pasqyra

## 17. Përdorimi i rasës Vendore

Në ndryshim nga rasat e tjera të gjuhës Armene, jo të gjithë emrat mund ta marrin këtë rasë. Për shkak të kuptimit që ata shprehin, disa grupe semantike emrash nuk mund ta kenë mbaresën vendore – *nuł*:

- emrat abstraktë, si p.sh. *nułwıhıwıřnuł* – gëzim, *uıwıwınuł* – pritje, etj.
- emrat që tregojnë persona, si të përgjithshëm ashtu edhe të përveçëm, si p.sh. *Uıwıwı* – Aram, *hıwıwı* – baba, *uıwıwıwı* – drejtor, etj.
- emrat që nuk tregojnë vend, si p.sh. *uıwıwıwı* – laps, *uıwıwı* – gjilpërë, *uıwıwı* – çekiç, etj.
- infinitivët e emëruar, si p.sh. *nułwıwıwı* – të ngrënë, *uıwıwıwıwı* – të jetuarit, si edhe
- shumë emra që shprehin kohë, si p.sh. *hıwıwıwıwı* – Janar, *wıwıwıwıwıwı* – E Martë, *wıwıwıwı* – mbrëmje, natë, etj.

Kur lind nevoja e dhënies së kuptimit vendor, atëhere mund të përdoret parafjala *-uıwı* me emrin në rasën gjinore: *wıwıwıwıwıwı uıwı* – brenda javës, *nułwıhıwıwıwıwı uıwı* – në gëzim, *nułwıwıwı uıwı* – gjatë të ngrënit, etj. Në shumë raste, rasa vendore e krijuar me mbaresën vendore – *nuł* mund të këmbehet reciprokisht me konstruksionin analitik -(me një emër në rasën gjinore + *uıwı*):

### Shembuj:

<i>wıwıwıwıwıwıwı</i>	ose	<i>wıwıwıwıwıwıwı uıwı</i>	në punë
<i>wıwıwıwıwıwı</i>	ose	<i>wıwıwıwıwıwı uıwı</i>	në sytë e tu
<i>hıwıwıwıwıwı</i>	ose	<i>hıwıwıwıwıwı uıwı</i>	në zemrën time
<i>wıwıwıwıwıwı</i>	ose	<i>wıwıwıwıwıwı uıwı</i>	në libra

Krahas emrave, edhe shumë pjesë të tjera të fjalisë mund ta marrin mbaresën treguese të rasës vendore – *nuł*.

Këto mund të jenë ndajfolje të vendit, p.sh.

<i>wıwıwı</i> – përpara	<i>wıwıwıwıwı</i> – nga përpara, në pjesën e përparme
<i>wıwıwı</i> – sipër	<i>wıwıwıwıwı</i> – në majë
<i>hıwıwı</i> – prapa, pas	<i>hıwıwıwıwı</i> – nga prapa, në pjesën e mbrapme

si edhe përemra, p.sh.

*դա* – ai, ajo      *դրանում* – në të  
*ուս* – ky, kjo      *սրանում* – në këtë

Përveç vendorit të vendit, shpesh përdoret edhe një vendor kohe që shërben për të treguar kohën brenda të cilës zhvillohet një veprim:

*այս դարում* – këtë shekull, *վեր ժամանակներում* – në kohët tona, *սկզբում* – në fillim, *վերջում* – në fund, *հինգ օրում* – brenda pesë ditëve, *որքա՞ն ժամանակում* – brenda sa kohe?, *կես ժամում* – për (brenda) gjysëm ore, etj.

### 18. Shembuj lakimi të emrave

#### FORMA BAZË E LAKIMIT

	Person		Jo Person	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
<b>E.</b>	<i>աշակերտ(ը)</i>	<i>աշակերտներ(ը)</i>	<i>դպրոց(ը)</i>	<i>դպրոցներ(ը)</i>
<b>K.</b>	<i>աշակերտին</i>	<i>աշակերտներին</i>	<i>դպրոց(ը)</i>	<i>դպրոցներ(ը)</i>
<b>Gj.</b>	<i>աշակերտի</i>	<i>աշակերտների</i>	<i>դպրոցի</i>	<i>դպրոցների</i>
<b>Dh.</b>	<i>աշակերտի(ն)</i>	<i>աշակերտների(ն)</i>	<i>դպրոցի(ն)</i>	<i>դպրոցների(ն)</i>
<b>Rr.</b>	<i>աշակերտից</i>	<i>աշակերտներից</i>	<i>դպրոցից</i>	<i>դպրոցներից</i>
<b>I.</b>	<i>աշակերտով</i>	<i>աշակերտներով</i>	<i>դպրոցով</i>	<i>դպրոցներով</i>
<b>V.</b>	-	-	<i>դպրոցում</i>	<i>դպրոցներում</i>

(**Shënim:** Germat në kllapa i përkasin trajtës së shquar !)

#### LLOJET E TJERA TË LAKIMIT TË EMRAVE

##### 1. Lakimi me -ի

	Njëjës	Shumës
<b>Emërore</b>	<i>քաղաք</i>	<i>քաղաքներ</i>
<b>Kallzore</b>	<i>քաղաք</i>	<i>քաղաքներ</i>
<b>Gjinore</b>	<i>քաղաքի</i>	<i>քաղաքների</i>
<b>Dhanore</b>	<i>քաղաքի</i>	<i>քաղաքների</i>

<b>Rrjedhore</b>	<i>քաղաքից</i>	<i>քաղաքներից</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>քաղաքով</i>	<i>քաղաքներով</i>
<b>Vendore</b>	<i>քաղաքում</i>	<i>քաղաքներում</i>

Shumica e emrave, si edhe mbiemrat, pjesoret, numërorët, emrat e përveçëm, ndajfoljet dhe pasfjalët e emëruara, ndjekin rregullin e mësipërm të lakimit. Shumë emra të tjerë, të cilët i përkasin grupeve që lakohen sipas rregullave të veçantë, tentojnë, që paralelisht me të, të krijojnë forma të ngjashme lakimi që i përkasin lakimit me *-ի*

2. Lakimi me *-ու*

a)

	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>այգի</i>	<i>այգիներ</i>
<b>Kallzore</b>	<i>այգի</i>	<i>այգիներ</i>
<b>Gjinore</b>	<i>այգու</i>	<i>այգիների</i>
<b>Dhanore</b>	<i>այգու</i>	<i>այգիների</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>այգուց</i>	<i>այգիներից</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>այգով</i>	<i>այգիներով</i>
<b>Vendore</b>	<i>այգում</i>	<i>այգիներում</i>

Shumica e emrave që mbarojnë me *-ի*, dhe disa emra si: *սարդ, Աստված, ամուսին*, etj, si edhe infinitivët ndjekin rregullin e lakimit me *-ու*.

b)

	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>սիրելի(ը)</i>	nuk ka
<b>Kallzore</b>	<i>սիրելի(ը)</i>	nuk ka
<b>Gjinore</b>	<i>սիրելու(ն)</i>	nuk ka
<b>Dhanore</b>	<i>սիրելու(ն)</i>	nuk ka
<b>Rrjedhore</b>	<i>սիրելուց</i>	nuk ka
<b>Instrumentale</b>	<i>սիրելով</i>	nuk ka
<b>Vendore</b>	-	-



Sipas shembullit të mësipërm lakohen fjalët njërrrokëshe: *qiri* (*qirawán*), *uili* (*uiliwán*), *qaw* (*qawwán*), *qiri* (*qirriwán*), etj.

d)

	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>uánwily</i>	<i>uánwilynter</i>
<b>Kallzore</b>	<i>uánwily</i>	<i>uánwilynter</i>
<b>Gjinore</b>	<i>uánwilyán</i>	<i>uánwilynterh</i>
<b>Dhanore</b>	<i>uánwilyán</i>	<i>uánwilynterh</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>uánwilyánhgy</i>	<i>uánwilynterhgy</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>uánwilyántwily</i>	<i>uánwilynterwily</i>
<b>Vendore</b>	-	-

Në rastin e emrave frymorë të përgjithshëm, lakimi bëhet sipas shembullit të mësipërm. Kur emri frymor trajtohet si emër i përveçëm, atëhere ai ndjek shembullin e lakimit të rregullt:

*Uánwily*, *Uánwilyh(ú)*, *Uánwilyhgy*, etj.

#### 4. Lakimi me *-ni / w*

a)

	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>rwirwilyntwily</i>	nuk ka
<b>Kallzore</b>	<i>rwirwilyntwily</i>	nuk ka
<b>Gjinore</b>	<i>rwirwilyntwilyán</i>	nuk ka
<b>Dhanore</b>	<i>rwirwilyntwilyán</i>	nuk ka
<b>Rrjedhore</b>	<i>rwirwilyntwilyánhgy</i>	nuk ka
<b>Instrumentale</b>	<i>rwirwilyntwilyntwily</i> ose <i>rwirwilyntwilyntwily</i>	nuk ka
<b>Vendore</b>	-	-

Sipas shembullit të mësipërm lakohen të gjithë emrat abstraktë, që mbarojnë me *-nilyntwily*: *nirwilyntwilyntwily* (*nirwilyntwilyntwilyán*), *uwilyntwilyntwily* (*uwilyntwilyntwilyán*), *uwilyntwilyntwily* (*uwilyntwilyntwilyán*), etj.

b)

	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>անկյուն</i>	<i>անկյուններ</i>
<b>Kallzore</b>	<i>անկյուն</i>	<i>անկյուններ</i>
<b>Gjinore</b>	<i>անկյան (ose անկյունի)</i>	<i>անկյունների(ն)</i>
<b>Dhanore</b>	<i>անկյան (ose անկյունի)</i>	<i>անկյունների(ն)</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>անկյունից</i>	<i>անկյուններից</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>անկյունով</i>	<i>անկյուններով</i>
<b>Vendore</b>	<i>անկյունում</i>	<i>անկյուններում</i>

Sipas shembullit të mësipërm lakohen emrat, që mbarojnë me *-ուն*:

*շուն (շան), արյուն (արյան), անկյուն (անկյան), տուն (տան), etj.*

#### 5. Lakimi me *-վա*

	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>ծավ</i>	<i>ծավեր</i>
<b>Kallzore</b>	<i>ծավ</i>	<i>ծավեր</i>
<b>Gjinore</b>	<i>ծավվա (ose ծավի)</i>	<i>ծավերի(ն)</i>
<b>Dhanore</b>	<i>ծավվա (ose ծավի)</i>	<i>ծավերի(ն)</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>ծավվանից (ose ծավից)</i>	<i>ծավերից</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>ծավով</i>	<i>ծավերով</i>
<b>Vendore</b>	<i>ծավում</i>	<i>ծավերում</i>

Sipas shembullit të mësipërm lakohen edhe emrat:

*օր (օրվա), գերեկ (գերեկվա), շաբաթ (շաբաթվա), տարի (տարվա)  
 ժամանակ (ժամանակվա), գիշեր (գիշերվա), երեկ (երեկվա), ձմեռ  
 (ձմեռվա ose ձմռան), etj.*

#### 6. Lakimi me *-որ*

	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>հայր</i>	<i>հայրեր</i>
<b>Kallzore</b>	<i>հոր</i>	<i>հայրերի(ն)</i>
<b>Gjinore</b>	<i>հոր</i>	<i>հայրերի</i>
<b>Dhanore</b>	<i>հոր</i>	<i>հայրերի(ն)</i>

<b>Rrjedhore</b>	<i>hnrh̄g</i>	<i>hայրերից</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>hnrnվ</i>	<i>հայրերով</i>
<b>Vendore</b>	-	-

Po kështu lakohen edhe emrat: *մայր (մոր), եղբայր (եղբոր), կնքամայր (կնքամոր), կնքահայր (կնքահոր),* etj.

7. Lakimi me *-nո*

	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>քույր</i>	<i>քույրեր</i>
<b>Kallzore</b>	<i>քրոջ</i>	<i>քույրերի(ն)</i>
<b>Gjinore</b>	<i>քրոջ</i>	<i>քույրերի</i>
<b>Dhanore</b>	<i>քրոջ</i>	<i>քույրերի(ն)</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>քրոջից</i>	<i>քույրերից</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>քրոջով</i>	<i>քույրերով</i>
<b>Vendore</b>	-	-

Po kështu lakohen edhe emrat:

*կին (կնոջ), ընկեր (ընկերոջ), տիկին (տիկնոջ), տալ (տալոջ), աներ (աներոջ) սկեսուր (սկեսրոջ), տանտիկին (տանտիկնոջ), դասընկեր (դասընկերոջ), տեր (տիրոջ),* etj.

8. Lakimi me *-n*

	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>ունգ</i>	nuk ka
<b>Kallzore</b>	<i>ունգ</i>	nuk ka
<b>Gjinore</b>	<i>ւզո (ose unւգ)</i>	nuk ka
<b>Dhanore</b>	<i>ւզո (ose unւգ)</i>	nuk ka
<b>Rrjedhore</b>	<i>ւզից</i>	nuk ka
<b>Instrumentale</b>	<i>ւզով</i>	nuk ka
<b>Vendore</b>	-	-

Po kështu lakohen edhe emrat: *լույս (լուստ ose լույսի), պատիվ (պատվոն ose պատվի), հուր (հրոն ose հրի),* etj.

## LAKIMI I PARREGULLT I DISA EMRAVE NË NUMRIN SHUMËS

		Shumës	
<b>Emërore</b>	<i>տիկնայք</i>	ose	<i>տիկիներ</i>
<b>Kallzore</b>	<i>տիկնանց</i>	ose	<i>տիկիների(ն)</i>
<b>Gjinore</b>	<i>տիկնանց</i>	ose	<i>տիկիների</i>
<b>Dhanore</b>	<i>տիկնանց</i>	ose	<i>տիկիների(ն)</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>տիկիներից</i>		
<b>Instrumentale</b>	<i>տիկիներով</i>		
<b>Vendore</b>	-		

Po kështu lakohen edhe emrat: *կին* – *կանայք*, *պարոն* – *պարոնայք* (ose *պարոններ*), etj.

	Shumës	Shumës
<b>Emërore</b>	<i>մարդիկ</i>	<i>Գրիգորենք</i>
<b>Kallzore</b>	<i>մարդկանց</i>	<i>Գրիգորենց</i>
<b>Gjinore</b>	<i>մարդկանց</i>	<i>Գրիգորենց</i>
<b>Dhanore</b>	<i>մարդկանց</i>	<i>Գրիգորենց</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>մարդկանցից</i>	<i>Գրիգորենցից</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>մարդկանցով</i>	<i>Գրիգորենց հետ</i>
<b>Vendore</b>	-	-

		Shumës	
<b>Emërore</b>	<i>ծնողք</i>	ose	<i>ծնողներ</i>
<b>Kallzore</b>	<i>ծնողների(ն)</i>		
<b>Gjinore</b>	<i>ծնողաց</i>	ose	<i>ծնողների</i>
<b>Dhanore</b>	<i>ծնողների(ն)</i>		
<b>Rrjedhore</b>	<i>ծնողներից</i>		
<b>Instrumentale</b>	<i>ծնողներով</i>		
<b>Vendore</b>	-		

	<b>Shumës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>անձինք</i>	<i>որդիք</i> ose <i>որդիներ</i>
<b>Kallzore</b>	<i>անձանց</i>	<i>որդիներհ(ն)</i>
<b>Gjinore</b>	<i>անձանց</i>	<i>որոնց</i> ose <i>որդիներհ</i>
<b>Dhanore</b>	<i>անձանց</i>	<i>որդիներհ(ն)</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>անձերից</i>	<i>որդիներից</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>անձերով</i>	<i>որդիներով</i>
<b>Vendore</b>	-	-

### 19. Formimi i Emrave

Në gjuhën Armene, ashtu si në gjuhën Shqipe, emrat klasifikohen në të përgjithshëm dhe të përveçëm, frymorë dhe jofrymorë, konkretë dhe abstraktë, etj. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për trajtimin si emra të thjeshtë, të përbërë ose të prejardhur.

Emërzimi është një tjetër mënyrë për të formuar emra nga fjalë që nuk i përkasin emrit.

Duke zbatuar për emrin e thjeshtë parimin e fjalës së thjeshtë (**fjalë e thjeshtë** ose **fjalë rrënjë** - do të konsiderohet fjala që nuk mund të zbërthehet më tej), më poshtë do trajtohet formimi i emrave të përbërë, emrave të prejardhur si edhe i atyre të përfutur nga emërzimi.

### 20. Formimi i emrave të përbëra

Emrat e përbërë në gjuhën Armene normalisht formohen nga bashkimi i dy elementeve bazë të cilët lidhen me njeri tjetrin direkt ose nëpërmjet zanores bashkuese “*u*”.

Më poshtë jepen disa emra të përbërë të bashkuar direkt, pa nevojën e zanores bashkuese “*u*”.

<i>լէսօր</i> – mesditë	<i>լէս + օր</i> – mes + ditë
<i>ծովափ</i> – bregdet	<i>ծով + փ</i> – det + breg

Sidoqoftë, përdorim më të madh ka bashkimi i të dy komponenteve nëpërmjet zanores bashkuese “u”:

<i>Հյուրասուեկյալ</i> – dhoma e pritjes	<i>հյուր + u + սուեկյալ</i> (mik + lidhëza a + dhomë)
<i>Հարցազրույց</i> – intervistë	<i>հարց + u + զրույց</i> (pyetje + lidhëza a + bisedë)

Fjala e përbërë mund të formohet nga bashkimi i:

- a) emër + emër: *զետափ* – breg lumi  
*զետ + փ* – breg + lumi
- b) emër + folje: *սարդասուսն* – vrasës  
*սարդ + u + սուսն(ել)* – njeri + vras
- c) folje + emër: *զրասուեղան* – tryezë shkrimi  
*զր(ել) + սուեղան* – shkruaj + tryezë
- d) mbiemër + emër: *լիալուսին* – hënë e plotë  
*լի + u + լուսին* – plot + hënë
- e) përemër + folje: *իսթնաթիռ* – aeroplan  
*իսթն + u + թռ(չել)* – vetë + fluturoj

Kur fjala e parë e fjalës së përbërë mbaron me “h”, atëhere zanorja “h” bie, dhe zanorja lidhëse “u” shndërrohet në “t”:

<i>զինեսունն</i> – pijetore	<i>զինի + u + սունն</i> – verë + lidh. + shtëpi
<i>զոգեսուլ</i> – avulllore	<i>զոգի + u + սուլ</i> – avull + lidh. + anije

Elementet që formojnë emrat e përbërë mund të lidhen me njëri tjetrin edhe me anë të lidhëzave shtuese “ni” dhe “u”, të cilat kanë të njëjtin kuptim, luajnë të njëjtin rol dhe përkthehen po njëjllor **-dhe, edhe**:

<i>այրուքեն</i> – alfabet	<i>այր + ու + քեն</i> – a + dhe + b
<i>կերուխում</i> – festë	<i>կեր + ու + խում</i> – ha + dhe + pi
<i>սոնսուր</i> – tregti	<i>սո + ու + սուր</i> – merr + dhe + jep

Në procesin e formimit të fjalëve në gjuhën Armene, është e zakonshme që disa prej zanoreve të këmbehen me njera tjetrën. Për shembull, “*ի*” dhe “*ու*” shndrohen në “*ե*” të pazëshme, “*ույ*” në “*ու*” dhe “*յա*” në “*ւ*”, etj.

<i>գին</i> (gin) – çmim	<i>գնացուցակ</i> (g <sup>g</sup> nacucak) – listë çmimesh
<i>սուտ</i> (sut) – gënjeshtër	<i>ստախոս</i> (s <sup>st</sup> ahos) – gënjeshtar
<i>լույս</i> (lujs) – dritë	<i>լուսավիճիկ</i> (lusampor) – abazhur
<i>մատյան</i> (matjan) – libër	<i>մատենագիր</i> (matenagir) - bibliograf

## 21. Emrat abstraktë të prejardhur

Në gramatikën Armene, njëlloji si në gjuhën Shqipe, emrat cilësohen konkretë ose abstraktë.

P.sh. shtëpi, njeri, etj. - cilësohen emra **koncretë**,  
 ndërsa gëzim, kënaqësi, rritje, etj. - cilësohen emra **abstraktë**.

Shumica e emrave abstraktë e kanë prejardhjen nga pjesë të tjera të fjalisë. Prapashtesa më e përdorshme në formimin e emrave abstraktë është:

*ություն, ում, անք.*

### 1. Prapashtesa *-ություն* përdoret gjerësisht për të formuar emra abstraktë:

a) nga mbiemrat:

<i>սուստ</i> – i bollshëm	<i>սոստություն</i> - bollëk
<i>ուրախ</i> – i gëzuar	<i>ուրախություն</i> – gëzim
<i>ծանր</i> – i rëndë	<i>ծանրություն</i> – rëndësi, peshë
<i>լեծ</i> – i madh	<i>լեծություն</i> – madhësi
<i>խաղաղ</i> – i qetë	<i>խաղաղություն</i> – qetësi, paqe

b) nga foljet:

<i>քննել</i> – provoj	<i>քննություն</i> - provim
<i>օգնել</i> – ndihmoj	<i>օգնություն</i> – ndihmë
<i>պաշտպանել</i> – mbroj	<i>պաշտպանություն</i> – mbrojtje
<i>շարունակել</i> – vazhdoj	<i>շարունակություն</i> - vazhdimësi

c) nga emrat:

<i>մայր</i> – nënë	<i>մայրություն</i> – amësi
<i>թշնամի</i> – armik	<i>թշնամություն</i> – armiçësi
<i>ընկեր</i> – mik	<i>ընկերություն</i> – miçësi

2. Prapashtesa – *ու* krijon emra abstraktë nga foljet:

<i>պաշարել</i> – rrethoj	<i>պաշարում</i> – rrethim
<i>շարժել</i> – lëviz	<i>շարժում</i> – lëvizje
<i>ներել</i> – fal	<i>ներում</i> – falje
<i>ստուգել</i> – kontrolloj	<i>ստուգում</i> – kontroll

3. Prapashtesa – *անք* krijon emra abstraktë nga foljet:

<i>աշխատել</i> – punoj	<i>աշխատանք</i> – punë
<i>հալածել</i> – persekutoj, ndjek	<i>հալածանք</i> – persekutim, ndjekje
<i>մարզել</i> – ushroj, trajnoj	<i>մարզանք</i> – ushtrim, trajnim
<i>տանջել</i> – torturoj, mundoj	<i>տանջանք</i> – torturë, mundim

## 22. Emrat e prejardhur që tregojnë vend ose vendndodhje

Në gramatikën Armene ka shumë pak prapashtesa për të formuar emra që tregojnë vend ose vendndodhje. Të tilla janë: *անոց*, *սասան*, *արան*.

1. Prapashtesa – *անոց* tregon vendndodhje të institucioneve. Këta lloj emrash e kanë prejardhjen nga mbiemra ose folje:

<i>ծեր</i> – plak, i vjetër	<i>ծերանոց</i> – shtëpi pleqsh (pension)
<i>հիվանդ</i> – i sëmurë	<i>հիվանդանոց</i> – spital
<i>հյուր</i> – mik	<i>հյուրանոց</i> – hotel, bujtinë
<i>արվեստ</i> – mjeshtëri	<i>արվեստանոց</i> – punishte, studio

Vetëm disa pak emra që mbarojnë me – *անոց* tregojnë kartmonedha me një vlerë të caktuar:

<i>հինգ</i> – pesë	<i>հինգանոց</i> – pesëshe
<i>սասը</i> – dhjetë	<i>սասանոց</i> – dhjetëshe
<i>հարյուր</i> – njëqind	<i>հարյուրանոց</i> – njëqindëshe

2. Prapashtesa – (w)ստան tregon emra vendesh:

Հայաստան – Armenia      Վրաստան – Gjeorgjia  
 Հունաստան – Greqia      Ռուսաստան – Rusia

3. Prapashtesa – արան tregon emra institucionesh, ambientesh dhe vendesh të ndryshme:

դասարան – klasë      լողարան – banjo      թնակարան – apartament  
 համալսարան – universitet      ճաշարան – restorant

Disa prej emrave, që mbarojnë me – արան, tregojnë pajisje, enë, mobilje, etj.  
 պահարան – depo      սառնարան – frigorifer      վառարան – sobë, furrë

Disa prej emrave, që mbarojnë me – արան, tregojnë libra të ndryshëm:  
 այբենարան – abetare      բառարան – fjalor      ավետարան – Bibla

### 23. Formimi i emrave që tregojnë njerëz

Prapashtesat më të përdorshme në formimin e emrave që tregojnë njerëz janë:

-ացի / -եցի / -ցի  
 -(w)պան  
 -որդ  
 -իչ  
 -բան

1. Emrat e formuar me prapashtesën -ացի / -եցի / -ցի tregojnë banorë. Këta emra janë të prejardhur nga emra të përgjithshëm ose të veçantë vendesh:

գյուղ – fshat      գյուղացի – fshatar  
 Վան – Van      վանեցի – banor i Vanit  
 Երևան – Jerevan      երևանցի – banor i Jerevanit

2. Emrat e formuar me prapashtesën -(w)պան tregojnë profesion. Këta emra janë të prejardhur nga emra:

դուռ – derë, portë      դռնապան – portier  
 պարտեզ – lulishte      պարտիզապան – lulishtar  
 կարո – karrocë      կարոապան – karrocier

3. Emrat e formuar me prapashtesën – *իչ*, që i shtohet rrënjës së foljes, tregojnë profesion:

<i>էրգել</i> – këndoj	<i>էրգիչ</i> – këngëtar
<i>նկարիչ</i> – pikturoj	<i>նկարիչ</i> – piktor
<i>հսկիչ</i> – kontrolloj	<i>հսկիչ</i> – kontrollor

4. Emrat e formuar me prapashtesën – *որդ*, që i shtohet rrënjës së foljes ose emrit, tregojnë impenjim, angazhim:

<i>սայլ</i> – qerre, karro	<i>սայլորդ</i> – karropunues
<i>դրսայ</i> – gjua	<i>դրսորդ</i> – gjuetar
<i>հետնիչ</i> – ndjek	<i>հետնորդ</i> – ndjekës, pasues

Ndonëse shumica e këtyre emrave të prejardhur nuk e specifikojnë gjininë, disa prej tyre mund të marrin prapashtesën – *ուհի*, për të treguar gjininë femërore:

<i>էրգիչ</i> – këngëtar	<i>էրգչուհի</i> – këngëtare
<i>նկարիչ</i> – piktor	<i>նկարչուհի</i> – piktore
<i>գերմանացի</i> – gjerman	<i>գերմանուհի</i> – gjermane

## 24. Përdorimi i emrave në mënyrë zvogëluese

Gjuha Armene ka tre prapashtesa që shërbejnë për të formuar formën zvogëluese të emrit: *իկ* (ik), *ակ* (ak), *ուկ* (uk). Ato i japin emrit kuptim zvogëluës (në madhësi ose në vlerë), afërsi, përkëdheli, por gjithashtu, edhe degradim ose përbuzje nga ana e folësit.

1. Të tre prapashtesat *իկ*, *ակ*, *ուկ* i shtohen emrit: sidoqoftë zgjedhja e tyre është e përcaktuar. Çdo emri i korrespondon një prapashtese e caktuar:

<i>ձուկ</i> – peshk	<i>ձկնիկ</i> – peshk i vogël
<i>լիճ</i> – liqen	<i>լճակ</i> – liqen i vogël
<i>արջ</i> – ari	<i>արջուկ</i> – ari i vogël

2. Numri më i madh i zvogëlimeve krijohet me prapashtesën – *իկ*:

<i>տեղան</i> – tryezë	<i>տեղանիկ</i> – tryezë e vogël
<i>զու՛</i> – qen	<i>զնիկ</i> – qen i vogël (qenush)
<i>պատան</i> – copë	<i>պատանիկ</i> – copë e vogël

- a) Emrat që tregojnë lidhje të ngushta marrin *-hly*, duke shprehur intimitet ose familjaritet:

<i>hայր</i> – baba	<i>հայրիկ</i> – babush
<i>քույրիկ</i> – motër	<i>քույրիկ</i> – motërzë
<i>յայ</i> – gjysh	<i>յայիկ</i> – gjyshi

- b) Kur prapashtesa *-hly* i shtohet emrave të përveçëm të personave, ai tregon qëndrim subjektiv apo emocional ndaj personit për të cilin bëhet fjalë:

<i>Տիգրան</i>	<i>Տիգրանիկ</i>
<i>Մարիամ</i>	<i>Մարիամիկ</i>
<i>Վարդան</i>	<i>Վարդանիկ</i>

- c) Emrat e gjatë e formojnë formën zvogëluese duke shtuar prapashtesën *-hly* pas rrokjes së parë të emrit:

<i>Լուսինե</i>	<i>Լուսիկ</i>
<i>Խաչատուր</i>	<i>Խաչիկ</i>
<i>Հովհաննես</i>	<i>Հովիկ</i>

- d) Prapashtesat *-hly* dhe *-nly* mund t’u shtohen edhe mbiemrave. Kur i referohen apo adresohen një personi apo sendi, ato tregojnë afekSION ose simpati:

<i>սիրուն</i> – tërhëqese	<i>սիրունիկ</i> – e dashur, e ëmbël
<i>անուշ</i> – e ëmbël	<i>անուշիկ</i> – sheqerkë
<i>տաք</i> – e ngrohtë	<i>տաքուկ</i> – e ngrohtë e këndshme
<i>գեղ</i> – i shëndoshë	<i>գիրուկ</i> – bol

## 25. Infinitivi i emëruar

Në gjuhën Armene Lindore, infinitivi i foljes është shumë i thjeshtë për t’u emëruar, dhe kjo gjë realizohet në dy forma:

- nëpërmjet mbaresës shquese të emrit *-ը / -ն*
- nëpërmjet nyjes pronore *-u, -ն*, dhe *-ը / -ն*

<i>երգել</i> – të këndosh	<i>երգելը</i> – të kënduarit	<i>երգելու</i> – të kënduarit tim
<i>խաղալ</i> – të luash	<i>խաղալը</i> – të luajturit	<i>խաղալու</i> – të luajtuarit tënd
<i>խոսել</i> – të flasësh	<i>խոսելը</i> – të folurit	<i>խոսելու</i> – të folurit e tij/saj

Infinitivi i emëruar lakohet njëjloj si emrat e rregullt të lakimit me – *ni*:

Më poshtë jepet tabela e lakimit të Infinitivit të emëruar me mbaresën shquese –*ը* / –*ւ*, në numrin njëjës:

	<b>Njëjës</b>		
<b>Emër./Kallz.</b>	<i>երգելը</i>	<i>խաղալը</i>	<i>խոսելը</i>
<b>Gjind./Dhan.</b>	<i>երգելու(ւ)</i>	<i>խաղալու(ւ)</i>	<i>խոսելու(ւ)</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>երգելուց</i>	<i>խաղալուց</i>	<i>խոսելուց</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>երգելով</i>	<i>խաղալով</i>	<i>խոսելով</i>

Më poshtë jepet tabela e lakimit të Infinitivit të emëruar nëpërmjet nyjes pronore –*u*, –*դ*, dhe –*ը* / –*ւ*, në numrin njëjës:

	<b>Njëjës</b>		
<b>Emër./Kallz.</b>	<i>երգելու</i>	<i>խաղալու</i>	<i>խոսելու</i>
<b>Gjind./Dhan.</b>	<i>երգելուս</i>	<i>խաղալուս</i>	<i>խոսելուս</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>երգելուցս</i>	<i>խաղալուցս</i>	<i>խոսելուցս</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>երգելովս</i>	<i>խաղալովս</i>	<i>խոսելովս</i>

**Shënim:** Përdorimi i Infinitivit të emëruar në numrin shumës është shumë i kufizuar në bashkëbisedime.

## 26. Përdorimi i Infinitivit të emëruar

Infinitivi i emëruar me mbaresën shquese –*ը* / –*ւ* përdoret si një emër abstrakt për të treguar një veprim ose gjendje. Në këtë rast ky ngjason me gjininë asnjansë të emrit në gjuhën shqipe.

*Ծխելը վստասկար է:* Të pirët e duhanit është i dëmshëm.

*Ասրելը արվեստ է:* Të jetuarit është art.

Infinitivi i emëruar lakohet dhe kryen funksione të ndryshme në fjali.

*Անցար առանց ինձ նկատելու:* Kalove pa më vënë re.

*Լսելով ոչինչ չես փոխի:* Me të qara nuk zgjidh gjë.

Në fjalinë e parë, folja *-նկատել* është emëruar në rasën dhanore, pasi kështu e kërkon parafjala *-անանց*, ndërsa në fjalinë e dytë folja *-լալ* është emëruar në rasën instrumentale.

Në rastet kur i atribuohet një personi, Infinitivi i emëruar shoqërohet me një emër në rasën gjinore ose mbiemrin pronor *-իւ, քո, նրա*, etj.

Më i zakonshëm, sidoqoftë, përdorimi i tij është me mbaresën pronore *-u, -ը*, dhe *-ը/-ն*. Ai funksionon si një emër foljor që në mënyrë të tërthortë (indirekte) i referohet veprimit apo gjendjes së një personi. Këta infinitivë të personalizuar mund të transformojnë fjali të tëra në fraza të emëruara që tregojnë fakte. Për krahasim:

*Երեխան արդեն քայլում է:*      *Երեխայի քայլերը մեզ ուրախացրեց:*  
Fëmija tashmë është duke ecur.      Të ecurit e fëmijës neve na lumturoi.

*Նրանք ուշանում են:*      *Նրանց ուշանալը ինձ մտահոգում է:*  
Ata janë me vonesë.      Të vonuarit e tyre po më shqetëson.

*Դու ծխո՞ւմ ես:*      *Ծխելը ինձ զարմացրեց:*  
Po pi duhan?      Të pirët duhan nga ana juaj, më çuditi.

Kur e kanë prejardhjen nga folje kalimtare, këto emërzime mund të jenë kundrinë e drejtë:

*Նոր տուն գնեցիր:*      Bleve një shtëpi të re.  
*Նոր տուն գնելը լավ լուր է:*      Të blerët e një shtëpie të re nga ana jote,  
është një lajm i mirë.

Infinitivët e emëruar mund të përdoren edhe me parashtesën mohore *- չ*:

*Անան չի պատասխանում:*  
Ana nuk përgjigjet.  
*Նրա չպատասխանելը տարօրինակ է:*  
Të mos-përgjigjurit e saj është i çuditshëm.

Kur diktohen nga folja, parafjala ose prapafjala, formacionet e personalizuara mund të shfaqen, gjithashtu, edhe me shenjë e rasës:

*Հիվանդանալուղ մասին ինձ չհայտնեցին:*

(*հիվանդանալ* – në rasën gjinore + *ղ*)

Nuk më informoi njeri rreth të sëmurit tënd. (rreth të qënit tënd sëmurë).

*Մեկնեցուցու հետո սասուն ինչ փոխվեց:*

(*մեկնեց* – në rasën rrjedhore + *ու*)

Pas të larguarit tim (largimit tim), gjithçka ndryshoi.

## 27. Emërzimi i Pjesoreve

Pjesoret me natyrë mbiemri, në gjuhën Armene, mund të emërzohen kollaj. Në këtë rast, ato marrin tiparet e një emri dhe shfaqen me nyjen shquese *-ը* ose *-ի* ose artikullin pronor *-ու*, *-ի*, *-ը*, *-ի*, etj., me mbaresën e shumësit *-ներ*, dhe shenja të tjera të rasave. Duke qenë se pjesoret me natyrë mbiemri kanë origjinë foljore, ato mund të shfaqen edhe me parashtesën *չ*-. Pjesoret e emërzuar ndjekin lakimin me *-ի* të emrave.

1. Pjesoret e emërzuar që mbarojnë me *-նը* i referohen personit të zënë me një veprimtari.

### **Shembuj:**

me nyjen shquese *-ը*: *խոսողը* – ai që flet (folësi)

me parashtesën mohore *չ* -: *չխոսողը* – ai që nuk flet

me prapashtesën e shumësit *-ներ* -: *խոսողները* – ata që flasin

Një emërzim i tillë shfaqet në çdo pozicion të fjalisë që ndodhet fjala:

- a) Në pozicion kryefjale:

*աշխատողը ավստ չի Էսու* – Kush punon, nuk mbetet i uritur.

Ai që punon, nuk mbetet i uritur.

- b) Pjesorja e emërzuar që mbaron me *-նը* shfaqet me shenjë e rasës:

*խոսողի հետ* – me dikë që flet; bashkë me folësin

c) Një shfaqje më komplekse do ishte ajo e shprehur më poshtë:

$\zeta - \text{hunn}\eta - \acute{\text{u}}\text{t}\rho - \rho$  – ata që nuk flasin

$\zeta - \text{hunn}\eta - \acute{\text{u}}\text{t}\rho - \text{h} \text{ úwuhú}$  – për ata që nuk flasin

d) Përdorimi i pjesores së emërzuar në rasën rrjedhore:

$\text{?hunn}\acute{\text{u}}\text{t}\rho\text{h}\rho \text{ úwuh}\rho\text{h}\rho$  – Ki frikë prej atyre që nuk flasin.

2. Kur emërzohen, pjesoret që mbarojnë me *-ud* përdoren për t’ju referuar objekteve, fakteve dhe ngjarjeve. Si të tilla, ato shfaqen:

a) me artikullin pronor *-u, -η, -ρ /-ú:*

*utuuðu* - ajo që shoh / që kam parë / që do të shoh

b) me artikullin e numrit shumës *-útrú:*

*útuuðuútrú* – ato që nuk shoh / që nuk kam parë / që nuk do të shoh

c) me të dyja (me artikullin e numrit shumës dhe artikullin pronor)

*utuuðuútrú úwuhú* – për ato që shoh / që pashë / që do të shoh

**Shënim 1:** Të kihet parasysh se pjesoret me *-ud* që e kanë prejardhjen nga foljet kalimtare mund ta formojnë këtë formë emërzimi.

**Shënim 2:** Trajta “*utuuðu*” mund të shprehë të tashmen, të shkuarën ose të ardhmen. Kuptimi i saj përcaktohet nga konteksti i fjalisë.

Duke qenë se nyja pronore shfaqet në të gjitha format që tregojnë vetën dhe numrin, formacionet me *-ud* përdoren me *-u, -η, -ρ /-ú*, dhe me mbaresat e shumësit *-útrú, -útrη, -útrρ*, sipas nevojës:

<i>utuuðu</i>	ajo që shoh/ pashë/ do të shoh
<i>utuuðuη</i>	ajo që sheh/ pe/ do të shohësh
<i>utuuðuρ</i>	ajo që sheh/ pa/ do të shohë
<i>utuuðuútrú (útr utuuðuη)</i>	ajo që shohim/ pamë/ do të shohim
<i>utuuðuútrη (útr utuuðuρ)</i>	ajo që shihni/ patë/ do të shihni
<i>utuuðuútrρ (úrúηg utuuðuρ)</i>	ajo që shohin/ panë/ do të shohin

Po kjo formë mund të shfaqet edhe me parashtesën mohore *չ*:

	<b>Njëjës</b>		<b>Shumës</b>	
<b>1<sup>ë</sup></b>	<i>տեսածու</i>	<i>չտեսածու</i>	<i>տեսածներու</i>	<i>չտեսածներու</i>
<b>2<sup>ë</sup></b>	<i>տեսածդ</i>	<i>չտեսածդ</i>	<i>տեսածներդ</i>	<i>չտեսածներդ</i>
<b>3<sup>ë</sup></b>	<i>տեսածը</i>	<i>չտեսածը</i>	<i>տեսածները</i>	<i>չտեսածները</i>

Kur folje neutrale (këto lloj foljesh, në gjuhën shqipe emërtohen – folje jokalimtare), që shprehin gjendje fizike apo shpirtërore (siç janë p.sh. *úստել, կանգնել, հոգնել, տխրել, գնել*, etj.), e formojnë emërzimin nëpërmjet prapashtesës *-ածը*, ato nuk tregojnë objekte, fakte, ose ngjarje siç ndodh zakonisht me emërzimet me *-ածը*, por personin që ndodhet në gjendjen e treguar.

Kështu:

*úստածը* - ai, që është duke ndenjgur

*հոգնածը* - ai, që është lodhur

*գնածը* - ai, që po flen

janë më afër kuptimit të vërtetë se sa ato që mbarojnë me *-ող*:

*խոսողը* – ai që flet

*աշխատողը* – ai që punon

Për krahasim, të shihet proverbi Armen:

*Քնածն ու սեռածը նույնն է:*

(ai, që po) flen dhe (ai që ka) vdekur janë e njëjta gjë.

Duke pasur parasysh që shkurtësia është një nga karakteristikat kryesore të proverbove (fjalëve të urta), pjesoret e emërzuarra gjejnë një përdorim të gjerë tek proverbat. Për krahasim shohim emrin që mbaron me *-ածը* në formën e saj të lakuar (rasa dhanore):

*Լեզվի ծաղածին դեղ չկա:* Nuk ka ilaç për plagët që krijon gjuha.

Një proverb, me përdorim më kompleks të emërzimeve të ndryshme, paraqitet më poshtë:

*Ուրածը ասողը, չուրածը կլտի:*

Ai që thotë atë që dëshiron, do të dëgjojë atë që nuk dëshiron.

- 3) Pjesoret që mbarojnë me *-hp*, gjithashtu, mund të shfaqen si emra, duke përdorur mbaresat *-u*, *-η*, *-ը/-ն*:

*Ասելիքս սումս եմ ու գնումս, բայց լինելիքը լինելու է:*

Unë po them atë që kisha për të thënë, por ajo që ka për të ndodhur do të ndodhë.

- 4) Gjuha Armene Lindore ka një grup formash pjesore të cilat mund të përdoren si format e lakueshme të Infinitivit në rasat e ndryshme:

- a) Rasa gjinore: *երգել*      *խաղալ*      *սլաղել*  
*երգելու*      *խաղալու*      *սլաղելու*

Pjesorja me prapashtesën *-ելու* dhe *-ալու* në këtë rast kanë funksion cilësor ose të kallzuesit emëror:

*խսելու ջուր* – ujë i pijshëm, ujë për të pirë

*գնալու տեղ* – vend për të shkuar

*սպրելու ցանկություն* – dëshirë për të jetuar

- b) Rasa instrumentale: *գրել – գրելով*, *կարդալ – կարդալով*, etj.

Pjesorja me prapashtesën *-ելով* dhe *-ալով* në këtë rast kanë funksionin e ndajfoljes së mënyrës:

*Կարդալով լեզու չես սովորի, խոսելով կսովորես:*

Nuk mund ta mësosh gjuhën duke lexuar, por e mëson duke folur.

## 28. Emërzimi në gjuhën Armene Lindore

Gjuha Armene është e prirur të emërzojë lehtësisht pothuajse të gjitha llojet e tjera të fjalëve që nuk i përkasin emrit. Në të gjithë këto raste, fjalët e emëruara marrin shenjë tipike të emrit, siç është nyja shquese *-ը/-ն*, nyja e pronorit *-u*, *-η*, *-ը/-ն*, mbaresa e shumësit *-ներ*, dhe shenjat e rasave.

1. **Mbiemrat:** *կարսիր* – i kuq, *կարսիրը* – i kuqi/e kuqja, *կարսիրու* – i kuqi im/e kuqja ime, *կարսիրից* – prej të kuqit tim/të kuqes time, *կարսիրները* – të kuqtë, *կարսիրներու* – të kuqtë e mi, *կարսիրներովու* – me të kuqtë e mi, etj.

2. **Infinitivët:** *կարդալ* – të lexosh, *կարդալը* – të lexuarit, *կարդալու* – të lexuarit tim, *կարդալի* – të lexuarit tënd, *կարդալուս* – të të lexuarit tim, etj.
3. **Pjesoret:** *ուշացող* – vonuar, *ուշացողը* – i vonuari, *ուշացողները* – të vonuarit, *ուշացողներից* – prej të vonuarve, etj.  
*սսսս* – thënë, *սսսսու* – e thëna ime, *սսսսներու* – të thënat e mia, *սսսսներիցու* – prej të thënave të mia, *սսսսներովու* – me të thënat e mia, etj.
4. **Përemrat:** *իմ* – im/ime, *իմը* – imi/imja, *իմնը* – të mitë, *իմնց* – të mive, *ւեր* – e jona, *ւերը* – jona, *ւերնը* – tonat, *ւերնցից* – prej të mijave/ tonave, *ք* – e jotja, *քնը* – jotja, *քնից* – prej tuajave, etj.
5. Përemrat dëftore dhe të papërcaktuar:  
*նյն* – i, e njëjtë, *նյնը* – i njëjti/e njëjta, *նյնից* – e të njëjtit/e të njëjtës, *նյնով* – me të njëjtin/me të njëjtën,  
*յուրաքանչյուր* – secili/secila, *յուրաքանչյուրը* – secili/secila, *յուրաքանչյուրի* – secilit/secilës, *յուրաքանչյուրից* – prej secilit/secilës, *ուրիշ* – tjetër, *ուրիշը* – tjetri/tjetra, *ուրիշները* – të tjerët/ tjerat, *բոլոր* – të gjithë/gjitha, *բոլորը* – të gjithë/gjitha/gjithçka, *բոլորի* – të gjithëve/gjithave/gjithçkaje, *բոլորից* – nga të gjithë/gjitha/gjithçka, *բոլորով* – me të gjithë/gjitha/gjithçka, *բոլորու* – të gjithë ne/të gjitha ne, *բոլորի* – të gjithë ju/të gjitha ju, etj.
6. Pasfjalët: *հետ* – me, *հետու* – me mua, *հետի* – me ty, *հետը* – me vete, me atë, *հետներու* – me ne, *հետների* – me ju, *հետները* – me vete, me ata, etj.  
*ւեջ* – brenda, në, *ւեջու* – në mua, brenda meje, *ւեջի* – në ty, brenda teje, *ւեջը* – në të, në atë, brenda tij, *ւեջներու* – brenda nesh, *ւեջների* – brenda jush, *ւեջները* – brenda tyre, etj.  
*մոտ* – pranë, *մոտու* – pranë meje, *մոտի* – pranë teje, *մոտը* – pranë tij, *մոտներու* – pranë nesh, *մոտների* – pranë jush, *մոտները* – pranë tyre, etj.
- a) Pasfjalët e emëruara me kuptim vendor përdoren gjerësisht si ndajfolje vendi:

**Pasfjalë***առջև* – përpara*դիմաց* – përballë**Ndajfolje***առջևի* – përpara teje*դիմացու* – përballë meje

<i>hëunl</i> – prapa, pas	<i>hëunl</i> – pas teje
<i>qru</i> – mbi, në	<i>qru</i> – mbi, në
<i>qul</i> – përkundër	<i>qul</i> – përkundër atyre

- b) Pasfjalët me kuptim vendor mund të emërzohen edhe duke u trajtuar nëpërmjet formës së rasës gjinore:

<b>Pasfjalët</b>	<b>Gjinore</b>	<b>Emërzuar</b>
<i>qru</i> – jashtë	<i>qru</i>	<i>qru</i> – ai që është jashtë
<i>qru</i> – brenda	<i>qru</i>	<i>qru</i> – ai që është brenda
<i>qru</i> – mbi, në	<i>qru</i>	<i>qru</i> – ai që është sipër
<i>qul</i> – poshtë, nën	<i>qul</i>	<i>qul</i> – ai që është poshtë
<i>qul</i> – në mes	<i>qul</i>	<i>qul</i> – ai që është në mes

7. Ndajfoljet e kohës ose të vendit mund të lakohen dhe pastaj të emërzohen duke u trajtuar nëpërmjet formës së rasës gjinore:

<b>Pasfjalët</b>	<b>Gjinore</b>	<b>Emërzuar</b>
<i>qru</i> – sot	<i>qru</i> – e sotme	<i>qru</i> – e sotmja
<i>qru</i> – tani	<i>qru</i> – aktuale	<i>qru</i> – e tashmja
<i>qru</i> – këtu	<i>qru</i> – e këtu	<i>qru</i> – e këtu
<i>qru</i> – nesër	<i>qru</i> – e nesërme	<i>qru</i> – e djeshmja
<i>qru</i> – atje	<i>qru</i> – e atje	<i>qru</i> – e atje

Nga sa më sipër, vihet re që të gjitha format e emërzimit nëpërmjet nyjes së pronorit *-u, -e, -i* mund të kenë konstruksione të ngjashme analitike me mbiemrat pronorë *qru, qru, qru, qru, qru, qru*. Në këtë rast, fjalët e emëruara marrin mbaresat *-i/-e*.

<i>qru</i>	ose	<i>qru</i> – përballë teje
<i>qru</i>	ose	<i>qru</i> – ardhja ime
<i>qru</i>	ose	<i>qru</i> – ajo që ti dëshiron
<i>qru</i>	ose	<i>qru</i> – pranë meje
<i>qru</i>	ose	<i>qru</i> – përpara teje

Disa nga këto emërzime e formojnë shumësin e tyre vetëm nëpërmjet konstruksioneve analitike: *qru qru* – pranë tyre, *qru qru* – përpara nesh, etj.

## 29. Format pronore të emrit

Për të shmangur përsëritjen e një emri të përmendur më parë, gjuha Armene Lindore përdor format pronore të emrit, pra emrat që përbëhen nga një fjalë e vetme dhe që kanë në vetvete cilësitë e emrit dhe cilësitë e pronorit:

*Մարիամի սարեղարձը մարտին է, Արամինը՝ մայիսին:*

Ditëlindja e Mariamit është në Mars, ndërsa e Aramit (ajo e Aramit) është në Maj.

Format pronore të emrit rrjedhin nga forma e rasës gjinore. Ato krijohen duke i shtuar formës gjinore të emrit mbaresën *-նը*. Kjo aplikohet po njëjloj si për emrat e përgjithshëm ashtu edhe për ata të përveçëm. Shumica e fjalëve të emëruara nga kategori të tjera fjalësh ndjekin po të njëjtin rregull. Për sa më sipër, ilustrohet me shembujt e mëposhtëm:

*Սոնայի տունը* – Shtëpia e Sonës

*Սոնայինը* – e Sonës

*նայրոցի ճամբան* – rruga e shkollës

*նայրոցինը* – (ajo) e shkollës

*վերնի հարևանը* – fqinji i sipërm

*վերնինը* – (ai) i sipërmi

## 30. Dallimet Armenisht – Shqip

**Emri në Gjuhën Armene Lindore** nuk ka gjini.

**Emri në Gjuhën Shqipe** ka **3** (tre) gjini: mashkullore, femërore, asnjane.

**Emri në Gjuhën Shqipe 3** (tre) lakime: lakimi i parë, lakimi i dytë, lakimi i tretë.

**Emri në Gjuhën Armene Lindore** emri ka disa lakime, të cilët përcaktohen në bazë të ndryshimit që pëson emri fillimisht në rasën gjinore.

**Gjuha Armene Lindore**

ka gjashtë (7) rasa

- |    |                   |               |
|----|-------------------|---------------|
| 1. | <i>նւղական</i>    | emërore       |
| 2. | <i>հայցական</i>   | kallzore      |
| 3. | <i>սեռական</i>    | gjinore       |
| 4. | <i>տրական</i>     | dhanore       |
| 5. | <i>բացատրական</i> | rrjedhore     |
| 6. | <i>գործիական</i>  | instrumentale |
| 7. | <i>սեղական</i>    | vendore       |

**Gjuha Shqipe**

ka pesë (5) rasa:

- |    |               |
|----|---------------|
| 1. | emërore       |
| 2. | kallzore      |
| 3. | gjinore       |
| 4. | dhanore       |
| 5. | rrjedhore     |
|    | <b>Nuk ka</b> |
|    | <b>Nuk ka</b> |



# KREU III

## MBIEMRI (ՄԾՄԿԱԼ)

### 1. Të Përgjithshme

Në gjuhën Armene, mbiemri vendoset përpara emrit dhe mbetet i pandryshueshëm, pavarësisht numrit, rasës dhe gjinisë së emrit, që ai cilëson.

Mbiemrat Armenë janë të panyjshëm. Nyje merr vetëm emri, të cilit ai i bashkëngjitet.

Mbiemrat mund të përdoren edhe si emra, dhe në këtë rast ata marrin nyjet që i takojnë emrit në numër dhe rasë; në këtë rast ata gëzojnë të gjithë vetitë e emrit dhe trajtohen si emra. Ky shndërrim, në gjuhën Armene, quhet “emërzim” dhe si i tillë trajtohet hollësisht në kapitullin ku flitet për emrin.

### 2. Llojet e mbiemrave

Nga vetë emërtimi “mbiemër”, kuptohet që funksioni kryesor i tij ka lidhje të ngushtë me emrin, pavarësisht se ai mund të kryejë edhe funksione të tjera në fjali, për të cilat do flitet në ndarjen “Funksionet e Mbiemrave”.

Në rastet kur bashkëngjitet me emrin, që është edhe rasti më i pranishëm në përdorimin e tij, ai mund të klasifikohet në pesë lloje:

a) **Mbiemër Pronor:** tregon pronësi; tregon se kujt i përket emri, të cilit ai i bashkëngjitet.

*իմ սուսնը*                      shtëpia ime

*ւեր փողոցը*                      rruga jonë

*ձեր դպրոցը*                      shkolla juaj

b) **Mbiemër Cilësor:** tregon cilësi të emrit, të cilit i bashkëngjitet.

*qetëligjly uηgjhly* vajzë e bukur  
*uηpwwn úwppη* njeri i varfër  
*uwpp gmp* ujë i ngrohtë

c) **Mbiemër Dëftor:** tregon dikë apo diçka, vendndodhje, etj

*wju* ky, kjo (këta, këto) – kur është pranë folësit  
*wjη* ai, ajo (ata, ato) – kur është më pranë dëgjuesit se folësit  
*wjú* ai, ajo (ata, ato) – kur është larg folësit dhe dëgjuesit

**Shënim:** Kur përdoret me emra në numrin shumës, marrin kuptimin siç është treguar në kllapa më sipër.

d) **Mbiemër i Pacaktuar:** i jep emrit një kuptim të pacaktuar sasior.

*wultú* të gjithë  
*gwwn* shumë  
*ppηpp* të gjithë, plot

**Shënim:** Në grupin e mbiembrave të pacaktuar futen edhe një grup fjalësh, të cilat normalisht konsiderohen “përemra”, por që kur bashkohen me emra, mund të trajtohen si mbiemra. Duke qenë se përdoren kryesisht në fjali pyetëse, ato mund të emërtohen edhe si “mbiemra pyetës”.

*n̂ p̂* kush?, që?, cili?, cila?  
*ĥ ú̂* çfarë?  
*pwúĥ* sa?

e) **Mbiemër Numëror:** i jep emrit një kuptim të caktuar sasior.

Për shkak të veçorive që ka nga ana funksionale, ky është trajtuar gjerësisht në një ndarje më vete, të emërtuar “**Numërorët**”.

### 3. Mbiemrat pronorë

Mbiemrat pronorë (të quajtur ndryshe edhe përcaktorë pronorë) janë:

*hul* – im / ime; mi / mia      *ultp* – ynë, jonë, tonë  
*pn* – yt / yte; tu /tua      *đkp* – juaj, Juaj, tuaj, Tuaj  
*hp* ose *hpw* – tij / saj      *hpklúg* ose *hpwúg* - tyre

**Shënim:**

1. Në gjuhën Armene, mbiemri nuk ka gjini.
2. Lidhur me mënyrën se si e dallon gjininë gjuha Armene lidhur me mbiemrat, të shihet trajtimi i bërë në kapitullin “Emri” në paragrafin “Gjinia e Emrit”, ku flitet për gjininë e emrit në gjuhën Armene.
3. Në gjuhën Shqipe, mbiemri pronor konsiderohet si “përemër pronor në bashkëvajtje me emra”. (“Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë”, Bahri Beci, Viti 2010).

Në dallim nga gjuha Shqipe, në gjuhën Armene, mbiemri pronor i paraprin emrit të cilit i përket:

<i>ւեր լեզու</i>	gjuha jonë
<i>նրանց երկիրը</i>	toka e tyre / vendi i tyre

Të vihet re se si pas emrit, në rastin kur ky shoqërohet i paraprirë nga mbiemri, vendoset nyja shquese *-ը* ose *-ի*.

#### 4. Mbaresa (nyja e prapme) pronore

Në gjuhën Armene, shpesh, rolin e mbiemrit pronor e luan mbaresa pronore (ose nyja e prapme pronore) e cila i shtohet emrit në fund duke zëvendësuar dhe duke luajtur rolin e mbiemrit pronor. Ashtu si edhe nyja shquese e emrit, ajo i shtohet pas emrit duke shprehur njëkohësisht pronësi dhe përcaktim. Mbaresat pronore janë:

<i>-u</i>	im / ime; mi / mia	<i>-ներու</i>	ynë, jonë, tonë
<i>-դ</i>	yt / yte; tu / tua	<i>-ներդ</i>	juaj, Juaj, tuaj, Tuaj
<i>-ը / -ի</i>	tij / saj	<i>-երը</i>	tyre

**Shembull:**

<i>ունիւ</i> – shtëpia ime	<i>ներու</i> – shtëpitë e mia / tona; shtëpia jonë
<i>նիւ</i> – shtëpia yte	<i>ներդ</i> – shtëpitë tuaja / shtëpia juaj
<i>նիւ</i> – shtëpia e tij / saj	<i>ները</i> – shtëpitë e tyre / shtëpitë e tij / e saj

Në gjuhën Armene Lindore, format shprehëse të pronësisë, të cilësuar “të tepërta” siç janë: *իւնիւ* – shtëpia ime, *քննիւ* – qeni yt, etj. të cilat e ngarkojnë fjalinë edhe me mbiemrin pronor edhe me mbaresën pronore, nuk konsiderohen korrekte.

Kështu që, në këto raste përdoret vetëm njeri nga elementet pronorë: *huf unml̥p̥* ose *unml̥u* – shtëpia ime; *pn̥ ʒnml̥p̥* ose *ʒnml̥p̥* – qeni yt, etj.

Mbaresa pronore e vetës së tretë dhe mbaresa shquese janë të njëjtë. Kështu fjala – *ʒnml̥p̥* mund të ketë dy kuptime në varësi të kontekstit të fjalisë:

1. *ʒnml̥p̥* – qeni (trajta e shquar e emrit – qen)
2. *ʒnml̥p̥* – qeni i tij / saj / i tyre

Në vazhdim të sqarimeve, duhet vënë në dukje se forma “e tepërt” (mbiemri pronor *hp̥* ose *hp̥w + p̥ / ũ*) është e pranueshme për vetën e tretë njëjës:

**Shembull:** *hp̥w ose hp̥ ʒnml̥p̥* - qeni i tij / saj

**Shënim:** Në gjuhën Armene Lindore, mbiemri pronor në numrin shumës shpreh dy kuptime. Kështu, fjala “*unl̥p̥ru*” nënkupton “**shtëpitë e mia**” ose “**shtëpia jonë**”, kjo në varësi të kontekstit të bisedës. Në rastin e përdorimit në formën “**shtëpia jonë**” në gjuhën Shqipe, përkthimi në gjuhën standarte Armene korrespondon me formën “*unl̥p̥ unml̥p̥*”. E njëjta gjë vlen të thuhet edhe për “*unl̥p̥rp̥*” – **shtëpitë tuaja / shtëpia juaj**. Kurse përsa i përket “*unl̥p̥rp̥*”, kjo nënkupton “shtëpitë e tyre” dhe shumë më pak ka kuptimin “**shtëpia e tij / saj**”, për të cilin gjuha standarte Armene ka formën “*hp̥w unl̥p̥rp̥*” – **shtëpia e tij / saj**.

## 5. Funksionet e Mbiemrave

Në gjuhën Armene, mbiemrat përdoren:

1. Si plotësues (cilësues) të emrave, p.sh. *unnn̥p̥* – i shëndetshëm, i përdorur në togfjalëshin *unnn̥p̥ t̥p̥t̥hp̥w* – fëmijë i shëndetshëm. (funksion cilësues).
2. Si plotësues të foljeve ndihmëse, p.sh. *huul̥t̥* – i shijshëm, i përdorur në togfjalëshin - *ɔw̥p̥ huul̥t̥ t̥* – dreka është e shijshme. Gjithashtu - *n̥d̥t̥* – i fortë, i përdorur në togfjalëshin - *n̥d̥t̥ t̥ p̥p̥n̥l̥* – duket i fortë (funksion kallzori).
3. Si plotësues (cilësues) të foljeve, duke treguar mënyrën e realizimit të një veprimi, p.sh. *lp̥l̥* – i mirë, i përdorur në togfjalëshin - *lp̥l̥ t̥ ũw̥p̥n̥l̥* – ata kërcejnë mirë. (funksion ndajfoljor).

Në gjuhën Armene, në të tre këta funksione, mbiemri nuk e ndryshon formën. Kur përdoren vetëm (të veçuar), duke ju referuar personave apo sendeve, mbiemrat Armenë funksionojnë si emra. Si të tillë ata mund të marrin mbaresën shquese të emrit  $-p / -\acute{u}$ , nyjen pronore  $-u, -\eta, -p / -\acute{u}$ , mbaresat dalluese të rasës në përputhje me lakimin  $-h$  të emrave, si edhe mbaresën e shumësit  $-(\acute{u})\acute{t}p\eta$ .

**Shembuj:**

$\acute{u}w\acute{p}$  – i miri,  $\acute{u}w\acute{p}hgu$  – prej të mirit,  $\acute{u}w\acute{u}$  ose  $h\acute{u} \acute{u}w\acute{p}$  – i miri im,  $\acute{u}w\acute{t}p\eta$  – të mirët,  $\acute{u}w\acute{t}p\eta\acute{u}$  – me të mirët, etj.

Siç ndodh edhe me emrat e rregullt, mbaresa shquese  $-\acute{u}$  shfaqet, krahasuar me mbaresën  $-p$ , më shpesh pas zanoreve fundore të një mbiemri ose pas një bashkëtingëlloreje fundore, n.q.s. fjala që vjen pas saj fillon me një zanore, si p.sh.  $\acute{u}w\acute{r}\acute{u} n\acute{u} p\acute{w}r\acute{h}\acute{u}$  – i keqi dhe i miri (djalli dhe ëngjëlli).

Kur mbiemrat përdoren duke ju referuar njerëzve në përgjithësi, gjuha Armene, në ngjashmëri me Shqipen, përdor numrin shumës, si p.sh.:

$h\acute{w}r\acute{m}\acute{u}w\acute{u}\acute{t}p\eta$  – të pasurit,  $w\acute{u}\acute{u}w\acute{u}\acute{h}\acute{u}\acute{t}p\eta$  – të famshmit,  
 $\acute{u}\acute{t}p\eta \acute{t}p\acute{h}\acute{u}w\acute{u}w\acute{u}w\acute{r}\acute{h}\acute{u}\acute{t}p\eta$  – të rinjtë tanë.

Lidhur me emërzimin e mbiemrave, gjuha Armene pothuajse nuk ka kufizim. Pothuajse të gjithë mbiemrat mund të emërzohen (pra, mund të luajnë rolin e emrit në fjali).

## 6. Krahasimi

Për të treguar madhësinë apo shkallën e cilësisë, që është pjesë e qenësishme e një diçkaje, mbiemrat në gjuhën Armene kanë tre shkallë krahasimi: pohore, krahasore dhe sipërore.

Shkalla pohore është shkalla bazë e mbiemrit. Në këtë mënyrë shfaqet ai edhe në fjalor.

$\acute{u}w\acute{p}$  – i mirë  
 $n\acute{u}p\acute{w}\acute{h}\acute{u}$  – i gëzuar  
 $h\acute{t}w\acute{u}w\acute{p}p\acute{p}p\acute{w}\acute{u}\acute{w}$  – interesant, kureshtar

1. Shkalla pohore përdoret në konstruksione gramatikore, ku dy sende, persona apo ngjarje që krahasohen, thuhet që janë njëjloj ose të ngjashëm në cilësi. Për këtë qëllim gjuha Armene përdor dy tipe konstruksionesh. I pari përfshin fjalët:

*այնքան..., որքան...;*  
*նույնքան..., որքան...;*  
*այչափ..., որչափ..., etj.*

*Նրա առաջին վեպը նույնքան հետաքրքրական է, որքան վերջինը:*  
 Novela e tij e parë është po aq interesante sa edhe e fundit.

Konstruksioni i dytë për shkallën pohore përdor prapafjalët *-պէս* ose *-չափ*, të cilët shoqërohen me rasën dhanore:

*Արամը Արսենի պէս աշխատուէր է:*  
 Arami është po aq puntor sa edhe Armeni.

2. Shkalla krahasore shërben për të krahasuar dy objekte me madhësi apo cilësi të ndryshme. Në gjuhën Armene, ky shfaqet gjithmonë në formën e një kombinimi të krahasores *-ավելի* – më tepër, më shumë (për vlera që qëndrojnë më lart), dhe *-նվազ* ose *պակաս* – më pak (për vlera që qëndrojnë më poshtë), me formën e thjeshtë të mbiemrit:

*զեղեցիկ* – i, e bukur      *ավելի զեղեցիկ* – më i, e bukur  
*հետաքրքրական* – interesant, kureshtar  
*նվազ* ose *պակաս հետաքրքրական* – më pak interesant

- a) Kur në fjali shfaqen të dy objektet që krahasohen, atëherë në konstruksion futet edhe fjala *-քան* – se:

*Առաջին կարքը ավելի թանկ է, քան երկրորդը:*  
 Rradha e parë është më e shtrenjtë se e dyta.

- b) Objekti i dytë i krahasimit mund të jetë në rasën rrjedhore:

*Առաջին կարքը երկրորդից (ավելի) թանկ է:*  
 Rradha e parë është më e shtrenjtë se e dyta.

- c) Kur mbiemri krahasohet me të ngjashmin e vet, por të përdorur në një fjali apo frazë të mëparshme, atëhere themi që kemi të bëjmë me fjali me strukturë eliptike. Shembulli i mëposhtëm e ilustron këtë:

*Մայրս միշտ հիվանդ էր, բայց հայրս ալլելի առողջ չէր:*

Mamaja ime ishte vazhdimisht e sëmurë, por edhe babai im nuk ishte më i shëndetshëm.

### 3. Shkalla sipërore tregon shkallën më të lartë ose më të ulët në cilësi.

Gjuha Armene ka tre konstruksione gramatikore për të shprehur shkallën sipërore:

**Shënim:** M.q.s në gjuhën Armene mbiemri nuk ka gjini, ndërsa në gjuhën Shqipe ka gjini, për lehtësi trajtimi, gjatë përkthimit në gjuhën Shqipe të formave të mëposhtëme të mbiemrit të gjuhës Armene, si formë korresponduese mund t'i vemë vetëm gjininë mashkullore të mbiemrit në gjuhën Shqipe. Po njëjloj mund t'i vinim gjininë femërore të Shqipes. Gjatë përkthimit nga gjuha Armene në gjuhën Shqipe të mbiemrit, përcaktimi mashkullor apo femëror do varej nga emri të cilit i përket mbiemri apo nga konteksti i fjalisë.

- a) Një konstruksion që përmban brenda fjalën *աւենից* – më i/e..., dhe trajtën bazë të mbiemrit:

*երիտասարդ* – i ri/e re    *աւենից երիտասարդ* – më i riu (e reja)

*դժվար* – i/e vështirë    *աւենից դժվար* – më i vështiri (e vështira)

- b) Një mbiemër të prejardhur nga trajta bazë e mbiemrit me parashtesën sipërore *աւենա* - më i/e:

*մեծ* – i madh (e madhe)    *աւենամեծ* – më i madhi (më e madhja)

*երջանիկ* – i, e lumtur    *աւենաերջանիկ* – më i lumturi

(më e lumtura)

- c) Një mbiemër të prejardhur nga trajta bazë e mbiemrit me prapashtesën sipërore *-ազույն* - më i/e:

*մեծ* – i madh (e madhe)    *մեծազույն* – më i madhi (më e madhja)

*ուժեղ* – i, e fortë    *ուժեղազույն* – më i forti (më e forta)

Disa mbiemra pranojnë të përdoren si me parashtesën ashtu edhe me prapashtesën:

*սևենալալ* = *լալազույն* – më i miri

*սևենաբարձր* = *բարձրազույն* – më i larti

*սևենահին* = *հնազույն* – më i vjetri, etj.

## 7. Formimi i mbiemrave

1. Në gjuhën Armene, parashtesat më të përdorura për të formuar mbiemra janë:

*ան-, չ-, դժ-, տ-, սպ-*.

Nga të gjitha këto, *ան* - ka përdorimin më të gjerë. Ajo i korrespondon parashtesës **pa** - në gjuhën Shqipe (pastër – i **pa**pastër, punë – i **pa**punë, etj) dhe shërben kryesisht për të formuar antonime të prejardhura nga:

a) mbiemra të thjeshtë ose të prejardhur:

*մաքուր* – i pastër

*անմաքուր* – i papastër

*կայուն* – i qëndrueshëm

*անկայուն* – i paqëndrueshëm

*հաջող* – i suksesshëm

*անհաջող* – i pasuksesshëm

*սպասարհանատու* – i përgjegjshëm

*անսպասարհանատու* – i papërgjegjshëm

b) emrat

*նշան* – shenjë

*աննշան* – i parëndësishëm

*սեղք* – faj

*անսեղք* – i pafaj

*հոտ* – aromë

*անհոտ* – i pa aromë

*հույ* – shpresë

*անհույ* – i pashpresë

**Shënim:** Shumë prej emrave abstraktë që mbarojnë me *-ություն* formohen prej mbiemrave me parashtesën *ան* -:

*անհոգ* – i pakujdesshëm

*անհոգություն* – pakujdesi

*անճաշակ* – i pashijshëm

*անճաշակություն* – pashije

*անսեղ* – i pafaj

*անսեղություն* – pafajësi

*անսպասիվ* – i pandershëm

*անսպասիվություն* – pandershmëri

Parashtesat *չ*-, *դժ*-, *ւո*-, *ւայ*- janë më pak të përdorshme. Të gjitha këto i japin fjalës kuptim negativ.

<i>չ</i> -	<i>կաւտէնալ</i> – të dëshërosh <i>խուտլ</i> – të flasësh	<i>չկաւ</i> – i ashpër, i pakëndshëm <i>չխուկաւ</i> – i pafjalë, fjalëpakë
<i>դժ</i> -	<i>զոհ</i> – kënaqësi <i>զույն</i> – ngjyrë	<i>դժզոհ</i> – i pakënaqur <i>դժզույն</i> – i pangjyrë, i zbehtë
<i>ւո</i> -	<i>զիւտէնալ</i> – të dish <i>հաւտլի</i> – i këndshëm	<i>ւոզիւտ</i> – i paditur, injorant <i>ւոհաւտ</i> – i pakëndshëm
<i>ւայ</i> -	<i>օրէնք</i> – ligj <i>շնորհք</i> – mirësi	<i>ւայօրհնի</i> – i paligjshëm, ilegal <i>ւայաշնորհ</i> – i paturp

Disa prej këtyre mbiemrave mund të formohen nga e njëjta fjalë, me të njëjtin kuptim, por me disa prej këtyre parashtesave:

*չկաւ* = *անկաւ*, *դժզույն* = *անզույն*, *ւայօրհնի* = *ւայօրէն*, etj.

2. Prapashtesat mbiemërore: *-ալի*, *-ելի*, *-ական*, *-եկան*, *-ակի*, *-յին*, *-ւո*, *-ալեւտ*, *-ալոոր*, *-ելոոր*, *-ալուն*, *-ե*, *-յա*, *-ելի*, *-եղ*, *-ենի*, *-իչ*, *-ոտ*, *-կոտ*, *-յալ*, *-յան*, *-ու*, *-ուն*, etj. janë shumë të përdorshme, duke u dhënë kuptime të ndryshme mbiemrave të prejardhur prej emrave, foljeve, numërorëve, etj.

### Shembuj:

<i>-ալի</i>	<i>սուկալ</i> - tmerrohem	<i>սուկալի</i> – i tmershëm
<i>-ելի</i>	<i>ստելի</i> - urrej	<i>ստելի</i> – i urryer
<i>-ական</i>	<i>օր</i> - ditë	<i>օրական</i> - ditor
<i>-եկան</i>	<i>շահ</i> - fitim	<i>շահեկան</i> - fitimprurës
<i>-ակի</i>	<i>բազում</i> - shumë	<i>բազմակի</i> - i shumëfishhtë
<i>-ային</i>	<i>օդ</i> - ajër	<i>օդային</i> - ajror
<i>-ւոտ</i>	<i>զույն</i> - ngjyrë	<i>զունւոտ</i> - i zbehtë

-ավելտ	բույր - aromë	բույրավելտ - aromatik
-ավոր	վերք - faj	վերավոր - fajtor
-ելոր	ունենալ - të kesh	ունելոր - i pasur
-ավուն	կարմիր - i kuq	կարմրավուն - i kuqërremtë
-ե	փայտ - dru	փայտե - i drunjtë
-յա	սպակի - xham	սպակյա - i xhamtë
-եղ	ուժ - fuqi	ուժեղ - i fuqishëm
-ենի	մայր - nënë	մայրենի - amëtar
-իչ	հուզել - emocionohem	հուզիչ - emocional
-ոտ	յուղ - yndyrë, vaj	յուղոտ - i yndyrshëm
-կոտ	վախ - frikë	վախկոտ - i frikshëm
-յալ	որակել - cilësoj	որակյալ - i kualifikuar
-յան	արեվելք - Lindje	արեվելյան - Lindor
-ու	հասել - pres, ndaj	հասու - i mprehtë
-ուն	հնչել - tingëlloj	հնչուն - tingëllues

## 8. Dallimet Armenisht – Shqip

Në gjuhën Armene, mbiemri vendoset përpara emrit dhe mbetet i pandryshueshëm, pavarësisht numrit, rasës dhe gjinisë së emrit që ai cilëson.

Në gjuhën Shqipe, mbiemri vendoset pas emrit dhe ndryshon në numër, rasë dhe gjini sëbashku me emrin që ai cilëson. Mbiemrat lakohen në bashkëvjajtje me emrat.

Mbiemrat Armenë janë të panyjshëm. Nyje merr vetëm emri, të cilit ai i bashkëngjitet.

Në gjuhën Shqipe mbiemrat ndahen në dy grupe: mbiemra të nyjshëm dhe mbiemra të panyjshëm. Mbiemrat e panyjshëm kur vendosen pas emrit nuk pësojnë ndonjë ndryshim në rasë, pra nuk lakohen.

# KREU IV

## NUMËRORËT (ԹԻՎԱԿԱՆ ԱՇՄԱԿԱՆՆԵՐԸ)

### 1. Të Përgjithshme

Në gjuhën Armene, Numërorët grupohen në kategorinë e mbiemrave dhe si të tillë gëzojnë vetitë e tyre. Ata vendosen përpara emrave dhe mbeten të pandryshuar pavarësisht numrit, rasës dhe gjinisë së emrit, të cilit ata i përkasin. Kur lakohen bashkë me emrin, vetëm emri lakohet në numrin njëjës dhe shumës, ndërsa ata mbeten të pandryshuar.

Kur emërzohen, ata trajtohen si emra, dhe si të tillë pësojnë ndryshimet e rasës dhe numrit.

Emri, që vjen pas Numërorit Themelor, vendoset në numrin njëjës, nëqoftëse ai përdoret në kuptimin e përgjithshëm (të pacaktuar); kur ai përdoret me kuptim të përcaktuar, atëhere vendoset në numrin shumës.

#### Shembull:

*հինգ մատիտ*                      pesë lapsa (pesë lapsa çfarëdo)

*հինգ մատիտները*            pesë lapsat (pesë lapsat, për të cilat folëm)

Siç shihet, në rastin e parë fjala “մատիտ” është në numrin njëjës, ndërsa në rastin e dytë fjala “մատիտները” është në numrin shumës.

### 2. Numërorët Themelorë dhe Rreshtorë

Numërorët Themelorë tregojnë sasinë e sendeve, njerëzve dhe fenomeneve të shprehur në formën e një numri ose me fjalë. Në rastin kur shprehet me fjalë, kjo fjalë hyn në kategorinë e mbiemrave.

Numërorët Rreshtorë tregojnë pozicionin relativ të sendeve, njerëzve dhe fenomeneve në një fjali, në një rradhë, klasë, vijë, etj. Në gjuhën Armene, Numërorët

Rreshtorë janë të prejdardhur prej Numërorëve Themelorë duke i shtuar rrënjës prapashtesën - *րորդ* ose - *երորդ*.

**Numërorët Themelorë**

**Numërorët Rreshtorë**

Katër numrat e parë bëjnë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm:

1	<i>մեկ</i>	<i>ստաջին</i>	i pari
2	<i>երկու</i>	<i>երկրորդ</i>	i dyti
3	<i>երեք</i>	<i>երրորդ</i>	i treti
4	<i>չորս</i>	<i>չորրորդ</i>	i katërti

Numrat e mëposhtëm ndjekin rregullin e përgjithshëm:

5	<i>հինգ</i>	<i>հինգերորդ</i>	i pesti
6	<i>վեց</i>	<i>վեցերորդ</i>	i gjashti
7	<i>յոթ</i>	<i>յոթերորդ</i>	i shtati
8	<i>ութ</i>	<i>ութերորդ</i>	i teti
9	<i>ինն</i> ose <i>ինը</i>	<i>իններորդ</i>	i nënti
10	<i>տասն</i> ose <i>տասը</i>	<i>տասներորդ</i>	i dhjeti
11	<i>տասնմեկ</i>	<i>տասնմեկերորդ</i>	i njëmbëdhjeti
12	<i>տասներկու</i>	<i>տասներկուերորդ</i>	i dymbëdhjeti
13	<i>տասներեք</i>	<i>տասներեքերորդ</i>	i trembëdhjeti
14	<i>տասնչորս</i>	<i>տասնչորսերորդ</i>	i katërmëdhjeti
15	<i>տասնհինգ</i>	<i>տասնհինգերորդ</i>	i pesëmbëdhjeti
20	<i>քսան</i>	<i>քսաներորդ</i>	i njëzeti
21	<i>քսանմեկ</i>	<i>քսանմեկերորդ</i>	i njëzetenjëti
30	<i>երեսուն</i>	<i>երեսուներորդ</i>	i tridhjeti
40	<i>քառասուն</i>	<i>քառասուներորդ</i>	i dyzeti
50	<i>հիսուն</i>	<i>հիսուներորդ</i>	i pesëdhjeti
60	<i>վաթսուն</i>	<i>վաթսուներորդ</i>	i gjashtëdhjeti
70	<i>յոթանասուն</i>	<i>յոթանասուներորդ</i>	i shtatëdhjeti
80	<i>ութսուն</i>	<i>ութսուներորդ</i>	i tetëdhjeti
85	<i>ութսունհինգ</i>	<i>ութսունհինգերորդ</i>	i tetëdhjet e pesti

90	<i>իննսուն</i>	<i>իննսուներորդ</i>	i nëntëdhjeti
100	<i>հարյուր</i>	<i>հարյուրերորդ</i>	i njëqindi
101	<i>հարյուր մեկ</i>	<i>հարյուրմեկերորդ</i>	i njëqind e njëti
500	<i>հինգ հարյուր</i>	<i>հինգհարյուրերորդ</i>	i pesëqindi
1000	<i>հազար</i>	<i>հազարերորդ</i>	i njëmijti

**Shënim:** Të kihet parasysh se Numërori Themelor në gjuhën Armene nuk ka gjini; ai përdoret njëlloj për të dy gjinitë, në ndryshim nga gjuha Shqipe:

**Shembull:**      **Armenisht**      **Shqip**  
                                  *սասներորդ*      i dhjeti, e dhjeta

Për Numërorët Themelorë bëhet pyetja: *քանի՞ - (sa?)*, ndërsa për Numërorët Rreshtorë: *քանի՞ Էրորդ:* - (i sati?, e sata?).

Për të treguar ditët e muajit, gjuha Armene përdor Numërorët Themelorë dhe jo ata Rreshtorë. Për këtë qëllim, Numërorët Themelorë emërzohen (duke i shtuar rrënjës, nyjen shquese –*ը*) dhe vendosen pas emrit të muajit të vendosur në rasën gjindore:

*Մայիսի մեկը:*                      1 Maj (fjalë për fjalë – Një e Majit)  
*Հունվարի վեցը:*                      6 Janar (fjalë për fjalë – Gjashtë e Janarit)

Numërorët themelorë të emërzuar lakohen njëlloj si emrat e rregullt të lakimit me –*ի*:

*Ապրիլի երեքին:*                      Në 3 Prill. (ose: më datë 3 të muajit Prill)  
*Մայիսի մեկից հետո:*                      Pas 1 Majit. (ose: pas datës 1 të muajit Maj)

### 3. Numërorët Shpërndarës (Distributivë)

Numërorët Shpërndarës tregojnë shpërndarjen apo përcaktimet numerike të materialeve. Për të realizuar këtë:

- a) Numërorëve Themelorë u shtohet prapashtesa – *ական*:
- |              |    |                  |                      |
|--------------|----|------------------|----------------------|
| <i>մեկ</i>   | 1  | <i>մեկական</i>   | nga një secili(t)    |
| <i>երկու</i> | 2  | <i>երկուական</i> | nga dy secili(t)     |
| <i>սասը</i>  | 10 | <i>սասական</i>   | nga dhjetë secili(t) |

<i>pus</i>	20	<i>pusu</i>	nga njëzetë secili(t)
<i>hարյուր</i>	100	<i>hարյուրու</i>	nga njëqind secili(t)

Mund të përdoret edhe forma e thjeshtuar:

5 - *u*, 20 - *u*, 35 - *u*, etj.

b) Numërorët Themelorë shkruhen të dyfishtë:

<i>u</i>	1	<i>u - u</i> (një nga një) ose (një nga secili)
<i>երկու</i>	2	<i>երկու - երկու</i> (dy nga dy) ose (dy nga secili)
<i>հարյուր</i>	100	<i>հարյուր - հարյուր</i> (njëqind nga njëqind) ose (njëqind nga secili)
<i>հազար</i>	1000	<i>հազար - հազար</i> (njëmijë nga njëmijë) ose (njëmijë nga secili)

Për Numërorët Shpërndarës bëhet pyetja: *քանիսկա՞ն: -* (nga sa?).

**Shembull:** *Քանիսկա՞ն տրամ ստացաք:* *Քսանսկան*  
 Nga sa lekë morët? Nga njëzetë.

*Երկու - երկու շարքի կանգնեցինք:* Ne u rreshtuam dy e nga dy.

#### 4. Numërorët Pjesorë (Thyesat)

Numërorët Pjesorë tregojnë një pjesë ose një pjesë të së tërës të shprehur numerikisht. Numëruesi tregohet prej një numri Themelor ndërsa emëruesi prej një numri Rreshtor (që mbaron me *-(ե)րորդ*), i cili shpesh formohet duke shtuar prapashtesën *- u*.

Shembuj formimi emëruesish:

5	<i>հինգ</i>	<i>հինգերորդ</i>	ose	<i>հինգերորդական</i>
7	<i>յոթ</i>	<i>յոթերորդ</i>	ose	<i>յոթերորդական</i>
9	<i>ինը</i>	<i>իններորդ</i>	ose	<i>իններորդական</i>
20	<i>քսան</i>	<i>քսաներորդ</i>	ose	<i>քսաներորդական</i>

Ka tre përfjashtime:

2	<i>երկու</i>	<i>կես</i>	i, e dytë (nje i/e dytë), (gjysmë)
3	<i>երեք</i>	<i>երրորդ</i>	i, e tretë (nje i/e tretë)
4	<i>չորս</i>	<i>քառորդ</i>	i, e katërt (nje i/e katërt)

Shembuj të Numërorëve Pjesorë:

2/3	<i>երկու երրորդ</i>	ose	<i>երկու երրորդական</i>
3/5	<i>երեք հինգերորդ</i>	ose	<i>երեք հինգերորդական</i>
3/4	<i>երեք քառորդ</i>	ose	<i>երեք քառորդական</i>
6/8	<i>վեց ութերորդ</i>	ose	<i>վեց ութերորդական</i>
12/20	<i>տասներկու քսաներորդ</i>	ose	<i>տասներկու քսաներորդական</i>

Ndonjëherë rrokja *-եր* në Numërorët Pjesorë bie:

7/10	<i>յոթ տասներորդ</i>	ose	<i>յոթ տասնորդական</i>
------	----------------------	-----	------------------------



# KREU V

## PËREMRI (ԴԵՐՄԱՆՈՒՆԷՆ)

### 1. Të Përgjithshme

Përemri është ajo fjalë (ajo pjesë e ligjëratës) që përdoret në ligjëratë zakonisht në vend të emrit ose mbiemrit, veçanërisht në rastet kur këta dy të fundit përsëriten shpesh brenda një ligjërate. Në këto raste, ai shmang përdorimin e përsëritur të emrit ose të mbiemrit brenda ligjëratës, ose të të dyve bashkë njëkohësisht.

Ashtu si edhe emri, përemri mund të jetë në rolin e kryefjalës, kundrinës, etj.

Ai ka numër, rasë dhe vetë.

### 2. Llojet e Përemrave

Përemrat grupohen në këto grupe kryesore:

- Përemrat Vetorë** (personalë) (Անձնական Դերանուններ)
- Përemrat Pronorë** (Ստացական Դերանուններ)
- Përemrat Reciproke** (Փոխադարձ Դերանուններ)
- Përemrat Pyetës dhe Lidhore** (Հարցական ու Հարաբերական Դերանուններ)
- Përemrat Përcaktorë** (Որոշ Դերանուններ)
- Përemrat Dëftorë** (Ցուցական Դերանուններ)

### 3. Përemrat Vetorë (Անձնական Դերանուններ)

Ashtu si edhe në giuhën Shqipe, Përemrat Vetore tregojnë tre personat që shfaqen në ligjërim:

- atë që flet (folësi), i cili vendoset në vetën e parë.
- atë me të cilin flasim (bashkëfolësi), i cili vendoset në vetën e dytë.
- atë për të cilin flasim (që mund të jetë frymor ose jofrymor), i cili vendoset në vetën tretë

#### 4. Lakimi i Përemrave Vetore

Në gjuhën Armene, Përemrat Vetorë kanë vetë (veta e parë, dytë dhe e tretë), numër (njëjës dhe shumës) dhe rasë (emërore, gjinore, dhanore, kallzore, rrjedhore dhe instrumentale). Lakimi i Përemrave Vetorë është më i zhvilluar se ai i emrave. Në gjuhën Armene, Përemrat Vetorë nuk bëjnë dallim në gjini në vetën e tretë njëjës si në Shqip (ai, ajo), megjithatë ata e bëjnë vetën e tretë me dy forma.

	<b>Njëjësi</b>		<b>Shumësi</b>	
Veta <b>1<sup>re</sup></b>	<i>tu</i>	unë	<i>utënp</i>	ne
Veta <b>2<sup>re</sup></b>	<i>ni</i>	ti	<i>nip</i>	ju, Ju
Veta <b>3<sup>re</sup></b>	a) <i>hnp (p)</i>	ai, ajo (vetë)	<i>hnp</i>	ata, ato (vetë)
	b) <i>uw</i>	ai, ajo	<i>urwup</i>	ata, ato

	<b>Veta I<sup>re</sup></b>	<b>Veta I<sup>re</sup></b>	<b>Veta II<sup>re</sup></b>	<b>Veta II<sup>re</sup></b>
	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>tu</i>	<i>utënp</i>	<i>ni</i>	<i>nip</i>
<b>Gjinore</b>	<i>hu</i>	<i>hnp</i>	<i>pu</i>	<i>hnp</i>
<b>Dhanore</b>	<i>hnd</i>	<i>utq</i>	<i>puq</i>	<i>utq</i>
<b>Kallzore</b>	<i>hnd</i>	<i>utq</i>	<i>puq</i>	<i>utq</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>hnd(w)nhg</i>	<i>utq(w)nhg</i>	<i>puq(w)nhg</i>	<i>utq(w)nhg</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>hnd(w)nuq</i>	<i>utq(w)nuq</i>	<i>puq(w)nuq</i>	<i>utq(w)nuq</i>

#### Veta III<sup>re</sup>

	<b>Forma (a)</b>		<b>Forma (b)</b>	
	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>	<b>Njëjës</b>	<b>Shumës</b>
<b>Emërore</b>	<i>hnp (p)</i>	<i>hnp</i>	<i>uw</i>	<i>urwup</i>
<b>Gjinore</b>	<i>hp</i>	<i>hnp</i>	<i>uru</i>	<i>urwup</i>
<b>Dhanore</b>	<i>hnt</i>	<i>hnt</i>	<i>uru</i>	<i>urwup</i>
<b>Kallzore</b>	<i>hnt</i>	<i>hnt</i>	<i>uru</i>	<i>urwup</i>
<b>Rrjedhore</b>	<i>hntnhg</i>	<i>hntnhg</i>	<i>urwnhg</i>	<i>urwupnhg</i>
<b>Instrumentale</b>	<i>hntnuq</i>	<i>hntnup</i>	<i>urwunup</i>	<i>urwupnup</i>

5. Përemrat Pronorë (*Սուսցական Դերանուններ*)

Në gjuhën Armene, Përemrat Pronorë konsiderohen si emërzim i Mbiemrave Pronorë (duke qenë se ata zëvendësojnë emrin së bashku me Mbiemrin Pronor që i përket këtij emri). Ashtu si edhe emrat, ata marrin nyjen shquese të emrit: *-ը / -ն*.

*իմը* – imi / imja; të mitë / të miat

*քոնը* – yti / ytja; të tutë / të tuat

*իրենը* ose *նրանը* – i tiji, e tija / i saj, e saja

*ուերը* – jona, tonët, tonat

*ձերը* – i juaji / e juaja; i Juaji / e Juaja; tuajat, Tuajat

*իրենցը* ose *նրանցը* – i, e tyre, të tyre, të atyre

Disa shembuj të përdorimit të Përemrit Pronor:

<b>Mbiemër</b>		<b>Emërzim</b>		<b>Përemër</b>
<i>իմ գիրքը</i>	ose	<i>գիրքս</i> – libri im		<i>իմը</i> - imi
<i>քո գիրքը</i>	ose	<i>գիրքդ</i> – libri yt		<i>քոնը</i> - yti
<i>իր գիրքը</i>	ose	<i>գիրքը</i> – libri i tij/saj		<i>իրենը</i> – i tij i/saji
<i>նրա գիրքը</i>	ose	<i>գիրքը</i> - libri i tij/saj		<i>նրանը</i> - i tij i/saji
<i>ուեր գիրքը</i>	ose	<i>գրքներս</i> – libri ynë		<i>ուերը</i> – i yni
<i>ձեր գիրքը</i>	ose	<i>գրքներդ</i> – libri juaj		<i>ձերը</i> – i juaji
<i>իրենց գիրքը</i>	ose	<i>գրքները</i> – libri i tyre		<i>իրենցը</i> - i tyre
<i>նրանց գիրքը</i>	ose	<i>գրքները</i> - libri i tyre		<i>նրանցը</i> – i tyre

**Shembull:**

*Ձեր տունն ավելի սեռ է, քան սերը: Բայց նրանցը փոքր է:*

Shtëpia juaj është më e madhe se e jona. Por e tyrja është e vogël.

Në biseda, shpesh përdoren dy forma të tjera mjaft të zakonshme, që shprehin atë që shpreh mbiemri apo përemri pronor:

*Մերնը* – të mitë, tonët, tonat

*Ձերնը* – të tutë

**Shembull:**

*Qëtrnûp nrrunt<sup>o</sup> ñ kû:*

Ku janë të tutë? / Ku janë njerëzit e tu?

*Utrnûp ulhzon unûn kû:*

Të mitë janë gjithnjë në shtëpi. / Njerëzit e mi janë gjithnjë në shtëpi.

6. Formimi i Përemrave Pronorë

Përemrat Pronorë rrjedhin prej Mbiemrave Pronorë që funksionojnë si Përcaktorë.

**Shembull:**

*hul unûnûr* – shtëpia ime

*pn hnujup* – shpresa jote

Në ndryshim nga Mbiemrat Pronorë që qëndrojnë bashkë me emrin, Përemrat Pronorë zëvendësojnë emrin, duke marrë nyjen shquese *-r* pas bashkëtingëlloreve dhe *-ûr* pas zanoreve. Të kihet parasysh që pas *-r* dhe *-ûr*, si variant i dytë qëndron përdorimi i *-û* ose *-ûû* kur ndiqet nga një fjalë që fillon me zanore.

	Njëjës			Shumës		
<b>1<sup>te</sup></b>	<i>ku</i>	<i>hul</i>	<i>hûr</i> ose <i>hûu</i>	<i>ulûp</i>	<i>ulr</i>	<i>ulrrr</i>
<b>2<sup>te</sup></b>	<i>ñni</i>	<i>pn</i>	<i>pnûr</i>	<i>ñnûp</i>	<i>ðr</i>	<i>ðrrr</i>
<b>3<sup>te</sup></b>	a) <i>hûppr</i>	<i>hr</i>	<i>hrkûr</i>	<i>hrkûp</i>	<i>hrkûg</i>	<i>hrkûgrr</i>
	b) <i>ûu</i>	<i>ûru</i>	<i>ûrûnûr</i>	<i>ûrûnûp</i>	<i>ûrûnûg</i>	<i>ûrûnûgrr</i>

**Shembuj:**

*Uu hul qhrppr ðt:*

Ky nuk është libri im.

*Fûð hul unûr:*

Mua më jep timin.

*Uu h<sup>o</sup> ðu t:*

Ky është i imi.

*Uu ûu ûuunhûn t:*

Ky është lapsi i tij.

*Eu ûrûnûr ðkûl nûqnûl:*

Unë nuk e dua të tijin.

*Þnûn kûl nûqnûl:*

Unë dua tëndin.

*Uhw' áter ílyarpr, íulq úterpr zlyw: Uw áterín t, zt'?*

Këtu ndodhet piktura juaj, ndërsa jona mungon. Kjo është juaja, apo jo?

**Shënim:** Siç shihet, veta e parë njëjës ka dy variante: *húp* dhe *húu*

## 7. Format pronore të emrit

Për të shmangur përsëritjen e një emri të përmendur më parë, gjuha Armene përdor format pronore të emrit, pra emrat që përbëhen nga një fjalë e vetme dhe që kanë në vetvete cilësitë e emrit dhe cilësitë e pronorit:

*Uwaríhwalí uwaréwarádr úwaríhín t, Urawíhín' úwájhíhín:*

Ditëlindja e Mariamit është në Mars, ndërsa e Aramit (ajo e Aramit) është në Maj.

Format pronore të emrit rrjedhin nga forma e rasës Gjimore. Ato krijohen duke i shtuar formës Gjimore të emrit mbaresën *-úp*. Kjo aplikohet po njëjloj si për emrat e përgjithshëm ashtu edhe për ata të përveçëm. Shumica e fjalëve të emëruara nga kategori të tjera fjalësh ndjekin po të njëjtin rregull. Për sa më sipër, ilustrohet me shembujt e mëposhtëm:

*Unúwájh unúúp* – Shtëpia e Sonës

*Unúwájhín* – e Sonës

*qúwprnggh dásúwáw* – rruga e shkollës

*qúwprngghín* – (ajo) e shkollës

*úteríníh hwaréwáw* – fqinji i sipërm

*úteríníhín* – (ai) i sipërmi

## 8. Veçoritë e Përemrave të vetës së tretë

Gjuha Armene ka një veçori dalluese për përemrin në vetën e tretë. Ajo ka dy grupe gjimore për përemrin e vetës së tretë: *húp(ը)* dhe *úu* për numrin njëjës si edhe *hpréúp* dhe *úwáw* për numrin shumë. Të dy këto grupe të përemrit të vetës së tretë shmangin keqkuptimet kur bëhet fjalë për dy persona në të njëjtin kontekst. Përemri *húp(ը)* me format e tij të lakueshme *hpr* – ai / ajo dhe *hpréú* – atë, i referohet subjektit të fjalisë ose një fjale të cilës i kushtohet rëndësi në kontekst. Sidoqoftë, përemri *úu* dhe forma e tij e lakueshme *úwáw* përdoren për personin, që për nga rëndësia vjen pas personit të cilësuar me *húp(ը)* / *hpr* / *hpréú*.

*Urawúr uíhprúw t hpr rúnqterngzr t úwáw zúwúr:*

Arami e do shumë mikun e tij dhe qenin e tij.

Në këtë shembull, *hpr* – i referohet Aramit, ndërsa *úwáw* – mikut të Aramit.

E njëjta gjë vlen edhe për shumësin. Këtu, *hrrkënp* dhe *hrrawënp* alternohen me format e tyre të lakueshme *hrrkëng* dhe *hrrawëng*. Përemri *hrrkënp* – ata/ato i referohet një numri personash përmendur fillimisht, dhe *hrrawënp* – ata/ato i referohet atyre që përmenden pas atyre të cilëve u referohet përemri *hrrkënp*:

*Ujrrawëntërrp hwarqnuđ kēn hrrkëng hrrawëntërrhēn kē uqawntqnuđ hrrawëng:*

Shqiptarët i respektojnë miqtë e tyre dhe i nderojnë ata.

Në këtë shembull, *hrrkëng* i referohet Shqiptarëve, ndërsa *hrrawëng* i referohet miqve të tyre.

### 9. Përemrat Reciproke (*Φνησσησρηδ Γερωνιίνιτερ*)

Përemrat Reciprokë tregojnë objekte të lidhur me njëri tjetrin nëpërmjet veprimeve apo gjendjeve. Këto ndërveprime reciproke shprehen nëpërmjet përemrave: *hrrawp*, *hrrawëng*, *uđkēuđkēn* (*uđkēuđkēh*) – njëri tjetrin.

#### **Shembull:**

*Uđkēn nē Uđkēn hrrawëng rēkēter kēn:*

Seni dhe Ana janë miq me njëri tjetrin

*hrrawënp hrrawp uđrrnuđ kēn:*

Ata e duan njëri tjetrin. (Ata duhen me njëri tjetrin)

Përemrat Reciprokë janë të lakueshëm dhe marrin shenjën e rasës në varësi të foljes apo mbiemrit. Për krahasim:

#### **Shembull:**

*hrrawënp hrrawëngnqđ* (rrjedhore) *kēn hrrawpawawawnuđ:*

Ata krenohen me njëri tjetrin.

*Γnqđ hrrawprrhēg* (rrjedhore) *gaww hēkēnē kēp:*

Ju jeni shumë larg prej njëri tjetrit.

## 10. Përemrat Pyetës dhe Lidhore (Հարցական ու Հարաբերական Դերանուններ)

Përemrat Pyetës janë fjalë me anë të të cilave organizohen pyetjet e realizuara nëpërmjet fjalive pyetëse: *n* <sup>o</sup>*վ* – kush?, *h* <sup>o</sup>*ւյ* – çfarë? *n* <sup>o</sup>*ր* – që, cili?, cila?, *n* <sup>o</sup>*ր* – ku? (në çfarë drejtimi lëviz?), *n* <sup>o</sup>*ր* *նե* <sup>o</sup>*ր* – ku? (në ç'vend ndodhet?), etj.

### Shënim:

*n* <sup>o</sup>*ր* – ku? përdoret në rastet kur kërkohet të dihet drejtimi i lëvizjes.  
*n* <sup>o</sup>*ր* *նե* <sup>o</sup>*ր* – ku? përdoret në rastet kur kërkohet të dihet vendndodhja.

Pa shenjën e pikëpyetjes, këta Përemra Pyetës përdoren si Përemra Lidhorë. Përemrat Lidhorë lidhin fjalitë e varura me fjalinë kryesore ose plotësojnë elementë të caktuar të fjalisë. Më poshtë jepen disa nga Përemrat Pyetës më të përdorshëm dhe Përemrat Lidhorë korrespondues:

*n* <sup>o</sup>*ր* – cili?, cila?, kë?, që:

*Ո՞ր նկարն էս սիրում:*

Cilën (kë) pikturë pëlqen?

*Սա այն նկարն է, որ սիրում էս:*

Kjo është ajo piktura, që ti pëlqen.

*n* <sup>o</sup>*վ* – kush?, cili?, cila?, që

*Ո՞վ էր ինձ փնտրում:*

Kush më kërkonte mua?

*Ով որ քեզ փնտրում էր, գտավ:*

Kushdo, që po të kërkonte ty, të gjeti.

*h* <sup>o</sup>*ւյ* – çfarë?

*Ի՞նչ էս կորցրել:*

Çfarë ke humbur?

*Այն, ինչ կորցրել էս, այստեղ չէ:*

Ajo, çfarë ke humbur, nuk është këtu.

*h* <sup>o</sup>*ւյա* <sup>o</sup>*ւ* – sa?

*Ինչա՞ն էս վճարել:*

Sa ke paguar?

*Ինչան որ վճարել էս, էս կստանաս:* Ti do të marrësh aq, sa ke paguar.

*որտե՞ղ – ku?*

*Որտե՞ղ ես թողել ընտանիքդ:* Ku e ke vendosur familjen?

*Սա այն քաղաքն է, որտեղ եմ թողել ընտանիքս:*

Ky është qyteti ku e kam vendosur familjen time.

*ու՞ր – ku?*

*Ու՞ր պիտի գնայիր:* Ku do të shkojë?

*Ես նրանց ցույց տվեցի այն տեղը, ուր պիտի գնայի:*

Unë ua tregova atyre vendin ku do të shkoja.

*ե՞րբ – kur?*

*Ե՞րբ մահացավ հայրդ:* Kur të vdiq babai?

*Չեմ մոռանա այն օրը, երբ հայրս մահացավ:*

Nuk do ta harroj atë ditë kur më vdiq babai.

*ինչպե՞ս – si?*

*Ինչպե՞ս բացատրեմ ամեն ինչ:* Si mund të shpjegoj gjithçka?

*Չգիտեմ, ինչպես բացատրեմ ամեն ինչ:*

Nuk e di si mund të shpjegoj gjithçka.

*ինչն՞ է – përse?*

*Ինչն՞ է չեկար:* Përse nuk erdhe?

*Չեմ հասկանում, ինչու չեկար:* Nuk e kuptoj përse nuk erdhe.

## 11. Përemri Lidhor -*որ(ը)*- në gjuhën Armene

Përemri Lidhor *որ (ը)* i gjuhës Armene, në numrin njëjës, korrespondon në Shqip me tre të tillë: *i cili*, *e cila*, *që*. Ndër to, *i cili* dhe *e cila* përdoren për njerëzit, respektivisht gjinia mashkullore dhe gjinia femërore, ndërsa *që* përdoret për frymorët dhe jo frymorët, pa dallim gjinie. Në gjuhën Armene, shumësi bën *-որոնք*, ndërsa korresponduesi i tij në Shqip është: *të cilët*, *të cilat*, respektivisht gjinia mashkullore dhe femërore, si edhe *që*, *që* përsëri përdoret për frymorët dhe jo frymorët, pa dallim gjinie.

Siç shihet, Përemri Lidhor - *që* i gjuhës Shqipe mund të përdoret gjerësisht në përkthimin e përemrave Armene -*np(p)* dhe -*npnúp*, pa pasur shqetësim kontekstin e fjalisë apo gjininë dhe numrin e objekteve paraardhës të fjalisë kryesore.

*Բժիշկը, np եկաւ...*

Mjeku, që (i cili) erdhi...

*Ују зкнупкнрр, npnúp упркгһн...*

Ndërtesat, që (të cilat) u dogjën...

